

Shkurt 2020
Numri: 143
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro



TRASHËGIMTARËT E PROFETËVE




revistaetika



progresibotime

E çfarë mund të jetë tjetër
qëndrimi indiferent,
pandjenja dhe injorant përballë
mrekullive të pafundme
madhështore, që prej
grimcës më të vogël, e deri tek
trupi më i madh, prej botës
mikro, e deri në atë makro,
të cilat ndriçojnë më së miri
mendjen dhe zemrën,
përveçse një çoroditje
dhe falimentim i mendjes!?



Profeti (a.s.), thotë:

“Ditën e Kiametit asnjë rob
nuk do të bëjë goftë edhe një hap
pa u pyetur se ku e ka kaluar jetën
e tij, se çfarë ka bërë me dijen e
tij, se ku e ka (tuar dhe shpenzuar
pasurinë e tij dhe se ku e ka
konsumuar trupin e tij.” (Tirmidhi,

Kiamet, 1/2417)

“Allahu i Madhëruar e do të riun e
pjekur, që nuk sillet si fëmijë, që
është drejtuar kah e mira dhe ka
braktisur dëshirat e kënaqësitë (e
ulëta të egos).” (Ahmed, IV, 151.)



Njeriu është një krijesë që ia transmeton brezit pasardhës përvojat që i ka fituar. Thënë me një shprehje tjetër, brezat pasardhësë përfitojnë nga përvojat dhe veprimet e paraardhësve të tyre dhe përpiqen të bëhen si ata.

Nisur nga ky kontekst, brezi pasardhës duhet të marrë për shembull aspektet pozitive të brezit paraardhës. Kjo gjë siç është e vlefshme për njerëzit, është e vlefshme edhe për pejgamberët. Allahu Teala në Kuranin Fisnik duke folur për pejgamberët dhe popujt e mëparshëm kërkon nga i Dërguari i Tij dhe myslimanët që të mos bien në të njëjtat gabime. Kur Allahu i Lartësuar e ka këshilluar Pejgamberin (a.s.), duke i thënë që të merrte për shembull Davudin (a.s.) dhe pejgamberët e tjerë të durueshëm kundrejt vështirësive (shik. Ahkaf, 35), gjithashtu edhe e ka paralajmëruar duke u shprehur: **“Mos u bëj si Njeriu i Peshkut (Junusi)!”** (Kalem, 48) Në këtë mënyrë janë paralajmëruar edhe myslimanët që të mos bëjnë gabime kundrejt të Dërguarit të Allahut (a.s.), siç kanë bërë popujt e mëparshëm kundrejt pejgamberëve të tyre. (Shik. Bakara, 108; Ahzab, 69.)

Sahabët të cilët ishin shokët e Resulullahut (a.s.), u dhanë si shembull për njerëzimin nga Allahu Teala për shkak se ata dhanë për Islamin jetën dhe pasurinë e tyre, ishin të lidhur me gjithë zemër ndaj Pejgamberit (a.s.) dhe dhanë përpjekje të mëdha për ta zbatuar e përçuar edhe te të tjerët Kuranin dhe Sunetin. Për sa i përket kësaj në disa ajete fisnike thuhet:

Ata iu përgjigjën Allahut dhe të Dërguarit të Tij edhe në momente të vështira:

“Për ata që morën plagë të rënda, pasi iu përgjigjën thirrjes së Allahut dhe të të Dërguarit dhe për ata që kanë bërë të mira e që i frikësohen Allahut, ka shpërblim të madh. (Shpërblim kanë edhe ata) të cilëve njerëzit (hipokritët) u thanë: “Shumë njerëz po mblidhen kundër jush, prandaj frikësohuni!” e kjo gjë ua shtoi atyre besimin dhe thanë: “Neve na mjafton Allahu, Ai është mbrojtës i mrekullueshëm!” (Al Imran, 172-173)

Për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira ka falje dhe shpërblim të madh: **“Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Ata që janë me të, janë të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis tyre. I sheh ata si përkulen dhe bien në sexhde, duke kërkuar dhuntinë dhe kënaqësinë e Allahut. Në fytyrat e tyre shihen shenjat e sexhdes. Ky është përshkrimi i tyre në Teurat. Ndërsa në Ungjill, shembulli i tyre përshkruhet si një farë e mbjellë që lëshon filiza e forcohet e pastaj ngrihet e fortë me kërcellin e vet, duke i gëzuar mbjellësit. (Kështu përshkruhen ata) me qëllim që, nëpërmjet tyre, Ai t'i zemërojë mohuesit. Për ata midis tyre që besojnë dhe kryejnë vepra të mira, Allahu ka premtuar falje dhe shpërblim të madh.”** (Fet'h, 29)

Ata u japin përparësi vëllezërve të tyre para vetes edhe nëse janë në nevojë: **“Ndërsa ata që banojnë në Medinë dhe që e kanë pranuar besimin qysh më parë, i duan mërgimtarët që vijnë në Medinë dhe në zemrat e tyre nuk ndjejnë kurrfarë rëndimi, për atë, që u është dhënë atyre, por duan t'u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtarë. Kushdo që ruhet nga lakmia e vetvetes, me siguri që do të jetë fitues.”** (Hashr, 9)

Shkurt 2020

VITI: XIV

NUMRI: 143

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardan Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Maqedonija

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Përmbajtja



8

Çelësi i shpëtimit shpirtëror
Prof. dr. Sulejman Derin



Ma'n ibn Adij el-Axhlani
Mustafa Erish

18




12



34

Udhëtimi i përjetësisë
Osman Nuri Topbash

- 5 Trashëgimtarët e profetëve
Mustafa Karabaxhak
- 10 Daru'l Islam në Dynja
Daru's Selam në Ahiret
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan
- 12 Beso dhe shpëtp
Ahmet Zijlan
- 21 Largimi nga përgojimi dhe paragjykimi
M. Sami Ramazanollu
- 22 Ruaj gjuhën
As. prof. dr. Mustafa Xhanllë
- 25 Myslimani midis traditës dhe modernes
Doç. dr. Harun Emysh
- 27 Misteri në të fshehtat e kohës
Ali Byjykçapar
- 28 Sulmi i pabesë
Adem Saraç



44

Një Ajet 30

Një Hadith 32

Historia e larvës së fluturës 43

Ferudun Ozdemir

Islami është dashur, paqe dhe qetësi 44

Dr. Halis Demirxhan

Lufta midis udhëzimit dhe injorancës 46

M. Ali Eshmeli

Gjërat që kapi majmuni 51

Urtësi

Veçoritë e grave besimtare 54

Fatma Nur Xhihan

40



Shqyrtojeni mirë lajmin para se të jetë vonë
H. Kyrba Ergin

Vlera e xhumasë
Ferit Piku

52





TRASHËGIMTARËT E PROFETËVE

— Mustafa Karabaxhak —

Njeriu është një krijesë që ia transmeton brezit pasardhës përvojat që i ka fituar. Thënë me një shprehje tjetër, brezat pasardhës përfitojnë nga përvojat dhe veprimet e paraardhësve të tyre dhe përpiqen të bëhen si ata.

Nisur nga ky kontekst, brezi pasardhës duhet të marrë për shembull aspektet pozitive të brezit paraardhës. Kjo gjë siç është e vlefshme për njerëzit, është e vlefshme edhe për pejgamberët. Allahu Teala në Kuranin Fisnik duke folur për pejgamberët dhe popujt e mëparshëm kërkon nga i Dërguari i Tij dhe myslimanët që të mos bien në të njëjtat gabime. Kur Allahu i Lartësuar e ka këshilluar Pejgamberin (a.s.), duke i thënë që të merrte për shembull Davudin (a.s.) dhe pejgamberët e tjerë të durueshëm kundrejt vështirësive (shik. Ahkaf, 35), gjithashtu

edhe e ka paralajmëruar duke u shprehur: **“Mos u bëj si Njeriu i Peshkut** (Junusi)!” (Kalem, 48) Në këtë mënyrë janë paralajmëruar edhe myslimanët që të mos bëjnë gabime kundrejt të Dërguarit të Allahut (a.s.), siç kanë bërë popujt e mëparshëm kundrejt pejgamberëve të tyre. (Shik. Bakara, 108; Ahzab, 69.)

I DËRGUARI I ALLAHUT (A.S.), I CILI ISHTE KURAN I GJALLË

Në këtë kontekst shembulli ynë i parë është i Dërguari i Allahut, (a.s.) dhe sahabët e tij të nderuar. I Dërguari i Allahut (a.s.), nuk është një njeri i zakonshëm. Allahu Teala thotë për të në Kuran: **“Muhamedi nuk është babai i askujt prej burrave tuaj, por është i Dërguari i Allahut dhe vula e profetëve; Allahu është i Gjithë-dijshëm për çdo gjë.”**

(Ahzab, 40) Zoti (xh.sh.), na njofton se i Dërguari i Tij (a.s.), ka një moral të lartë: “Ti (o i Dërguar) me të vërtete ke një moral të lartë.” (Kalem, 4). Përsëri Zoti (xh.sh.), e lavdëron moralin e të Dërguarit të Tij duke u shprehur: **“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.”** (Ahzab, 21) Kur Sa’d ibn Hishami i cili ishte prej sahabëve, e pyeti nënën tonë, Aishen se si ishte morali i lartë i të Dërguarit të Allahut (a.s.). Ajo iu përgjigj: “Ti e lexon Kuranin, apo jo? Morali i tij ishte Kurani.” (Muslim, Salatu’l-Musafirin, 139; Ebu Davud, Tatavvu, 26.) Edhe një pejgamber tjetër për shembullin e të cilit flitet shpesh në ajetet dhe hadithet fisnike është Davudi (a.s.).

DAVUDI (A.S.): NJË NJERI SHEMBULLOR

Davudit (a.s.), krahas profecisë i ishte dhënë edhe mbretëria. Ai për ta çuar në vend drejtësinë nuk ua kishte lënë të tjerëve shqyrtimin e çështjeve të drejtësisë, por në përgjithësi i kishte pas shqyrtuar vetë. (Shik. Enbija, 78-79; Sad, 21-25.) Ai nuk kishte pranuar ta ushqente familjen me të ardhurat nga shteti, por e kishte bërë këtë duke punuar në profesionin e tij. Edhe Allahu Teala ia kishte mundësuar atij përdorimin e hekurit dhe e kishte mësuar të bënte parzmore. Në Kuranin Fisnik thuhet: **“... Ne ia zbutëm atij hekurin** (dhe i thamë): **“Puno parzmore të gjera! Thuri ato me maja të barazpeshuara dhe bëj vepra të mira! Pa dyshim, Unë shoh çfarë punoni ju.”** (Sebe, 10-11; Veçanërisht shik. Enbija, 80.)

Edhe i Dërguari i Allahut (a.s.), e ka vlerësuar këtë cilësi të Davudit (a.s.). Për këtë arsye, i ka këshilluar ata që ta marrin si shembull duke u dhënë emrin e tij: **“Gjëja më e mirë që ha njeriu është ajo që e fiton vetë. Pejgamberi i Allahut, Davudi nuk hante gjë tjetër përveç asaj që e fitonte me punën e dorës së vet.”** (Buhari, Buju’, 15, Enbija, 37.)

Ai i bënte shumë dhikër Allahut me zërin e bukur të tij. Davudit (a.s.), i ishte dhënë aftësia për të folur bukur (Sad, 20) dhe zëri i këndshëm. Një ditë i Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha Ebu Musa el-Esh’ariut (r.a.): **“O Ebu Musa! Ty të është dhënë një pjesë nga bukuria e zërit të Davudit.”** (Buhari, Fedailu’l-Kur’an, 31; Muslim, Misafirin, 235, 236.) Davudi (a.s.), nuk mjaftohej me zërin e bukur që i ishte dhënë. Në të njëjtën kohë e lexonte shumë shpejt Zeburin. Kjo e vërtetë është shprehur në hadithin që transmetohet nga Ebu Hurejra (r.a.): **“Davudit i ishte lehtësuar leximi. Ai urdhëronte përgatitjen e kafshës (së transportit) dhe e lexonte Zeburin para**

se kafsha të përgatitej...” (Buhari, Enbija, 37.)

Në Kuranin Fisnik thuhet se Davudi (a.s.), i ka pas qenë drejtuar gjithmonë Allahut (Sad, 20) dhe se e madhëronte Allahun mëngjes e mbrëmje (Sebe, 10; Sad, 18). Edhe në hadithet fisnike thuhet se Davudi (a.s.), ka qenë njeriu që i bënte më shumë ibadet Zotit (xh.sh.). (Muslim, Sijam, 182; Tirmidhi, Devavat, 72.) I Dërguari i Allahut (a.s.), i ka këshilluar edhe shokët e tij për këtë cilësi të Davudit (a.s.). Abdullah ibn Amri (r.a.), tregon se Resulullahu (a.s.), e ka këshilluar kështu: **“Agjërimi më i dashur për Allahun është agjërimi i Pejgamberit Davud. Davudi një ditë mbante agjërim dhe një ditë nuk mbante. Namazi më i dashur për Allahun përsëri është namazi i Pejgamberit Davud. Ai flinte gjysmën e natës, në një të tretën falte namaz dhe në një të gjashtën përsëri flinte.”** (Buhari, Enbija, 37, Tehexhahud, 7; Muslim, Sijam, 188.)

Pas shembullit të të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe profetëve të tjerë për myslimanët vjen shembulli i sahabëve të nderuar.


SHOKËT E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT

Sahabët të cilët ishin shokët e Resulullahut (a.s.), u dhanë si shembull për njerëzimin nga Allahu Teala për shkak se ata dhanë për Islamin jetën dhe pasurinë e tyre, ishin të lidhur me gjithë zemër ndaj Pejgamberit (a.s.) dhe dhanë përpjekje të mëdha për ta zbatuar e përçarur edhe te të tjerët Kuranin dhe Sunetin. Për sa i përket kësaj në disa ajete fisnike thuhet:

Ata iu përgjigjën Allahut dhe të Dërguarit të Tij edhe në momente të vështira:

“Për ata që morën plagë të rënda, pasi iu përgjigjën thirrjes së Allahut dhe të të Dërguarit dhe për ata që kanë bërë të mira e që i frikësohen Allahut, ka shpërblim të madh. (Shpërblim kanë edhe ata) **të cilëve njerëzit (hipokritë) u thanë: “Shumë njerëz po mblidhen kundër jush, prandaj frikësohuni!” e kjo gjë ua shtoi atyre besimin dhe thanë: “Neve na mjafton Allahu, Ai është mbrojtës i mrekullueshëm!”** (Al Imran, 172-173)

Për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira ka falje dhe shpërblim të madh: **“Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Ata që janë me të, janë të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis tyre. I sheh ata si përkulen dhe bien në sexhde, duke kërkuar dhuntinë dhe kënaqësinë e Allahut. Në fytyrat e tyre shihen shenjat e sexhdes. Ky është përshkrimi i tyre në Teurat. Ndërsa në Ungjill, shembulli i tyre përshkruhet si një farë e mbjellë që**



lëshon filiza e forcohet e pastaj ngrihet e fortë me kërcellin e vet, duke i gëzuar mbjellësit. (Kështu përshkruhen ata) me qëllim që, nëpërmjet tyre, Ai t'i zemërojë mohuesit. Për ata midis tyre që besojnë dhe kryejnë vepra të mira, Allahu ka premtuar falje dhe shpërblim të madh.” (Fet’h, 29)

Ata u japin përparësi vëllezërve të tyre para vetes edhe nëse janë në nevojë: ***“Ndërsa ata që banojnë në Medinë dhe që e kanë pranuar besimin qysh më parë, i duan mërgimtarët që vijnë në Medinë dhe në zemrat e tyre nuk ndejnë kurrfarë rëndimi, për atë, që u është dhënë atyre, por duan t’u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtarë. Kushdo që ruhet nga lakmia e vetvetes, me siguri që do të jetë fitues.***” (Hashr, 9)

NJERËZ TË ZGJEDHUR

Ebu Musa el-Esh’ariu (r.a.), tregon: Bashkë me të Dërguarin e Allahut (a.s.), patëm falur namazin e akshamit. Ne thamë: “Të qëndrojmë këtu dhe ta falim edhe namazin e jacisë bashkë me të.” Kështu që u ulëm. Ndërkohë që po qëndronim ulur, Pejgamberi (a.s.), erdhi te ne dhe na tha: “A akoma jeni këtu?” Edhe ne iu përgjigjëm: “Po.” Resulullahu (a.s.), na tha: “Paskeni bërë mirë.” Pastaj e ngriti kokën drejt qiellit siç bënte shpesh herë dhe tha: “Yjet janë siguria e qiejve. Kur të ikin yjet, gjëja e premtuar vjen në qiell. Edhe unë për shokët e mi jam një burim sigurie. (Përderisa të jem gjallë, sistemi, rregull, dhe siguria do të gjendet ndërmjet shokëve të mi.) Kur të ik unë

(kur të ndërroj jetë), kërcënimet që u kanë ardhur sahabëve të mi do t’u vijnë njerëzve. Edhe sahabët janë burim sigurie për umetin. Kur të shkojnë edhe sahabët e mi, umetit do t’i ndodhë gjëja që i është premtuar.” (Muslim, Fedailu’s-Sahabe, 207; Ahmed ibn Hanbel, el-Musned, IV, 399.)

Çdo sahab ka cilësi specifike të tij, por që janë shembuj për ne. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: “Njeriu më i mëshirshëm i umetit tim është Ebu Bekri. Njeriu më i përpiktë në çështjen e (zbatimit) të urdhrit të Allahut është Omeri. Ndërsa njeriu më i turpshëm është Osmani. Njeriu që jep vendimet më të sakta është Aliu. Njeriu që e njeh më mirë hallallin dhe haramin është Muadh ibn Xhebeli. Njeriu që i njeh më mirë farzet është Zejd ibn Thabiti. Njeriu që di të lexojë më mirë Kuran është Ubej ibn Ka’bi. Çdo umet ka besnikun e tij. Besniku i këtij umeti është Ebu Ubejde ibn Xherrahu.” (Tirmidhi, Menakib, 32; Ibn Maxhe, Mukaddime, 17.) “Më fjalëdrejtë se Ebu Dherrin as toka nuk e ka pasur, as qielli nuk i ka bërë hije.” (Tirmidhi, Menakib, 35; Ibn Maxhe, Mukaddime, 18.) Ndonëse shprehen edhe disa cilësi të tjera të sahabëve të tjerë në shumë hadithe fisnike, në fakt të gjithë ata janë prijës për ne. “Sahabët e mi janë si yjet. Cilindo që ta pasoni, do të gjeni rrugën e drejtë.” (Ibn Batta el-Ukberi, el-Ibanetu’l-Kubra, II, 569.)

Miqte e Allahut me në krye sahabët shpresohet se do të kenë dobi edhe në ditën e gjykimit siç kanë pasur dobi në këtë botë. “Nëse ndonjëri prej sahabëve të mi vdes në një vend, patjetër ai do të ringjallet si dritë dhe udhërrëfyes për njerëzit (e atij vendi).” (Tirmidhi, Menakib, 58.) Ata e kanë arritur këtë gradë në sajë të përpjekjeve për ta zbatuar fenë dhe lidhjes së fortë me të megjithëse e kanë parë Pejgamberin tonë të nderuar.

Ajo që na takon neve për të bërë është që t’i kujtojmë me respekt këta shokë të zgjedhur të të Dërguarit të Allahut, (a.s.) dhe të përfitojmë sa më shumë të jetë e mundur nga sjelljet e tyre shembullore. Këtë në fakt e kërkon edhe Zoti (xh.sh.), i Cili shprehet: ***“Edhe ata që erdhën pas tyre, thonë: “O Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë asnjë të keqe ndaj besimtarëve! O Zoti ynë, Ti je vërtet i Butë dhe Mëshirëplotë!”*** (Hashr, 10)



Çelësi i shpëtimit shpirtëror

— Prof. dr. Sulejman Derin —

Allahu i Lartësuar në Kuranin Fisnik shprehet se e ka krijuar njeriun në “ahseni takvim”, domethënë në formën më të bukur. (Shik. Tin, 3.) Zoti (xh.sh.), ka vendosur potencialet më të përkryera në natyrshmërinë e njeriut, por për ta arritur gradën e lartë njeriu duhet të përpiqet, sepse Ai e ka këshilluar që t’u bëjë tezkije (t’i pastrojë) disa ndjenja negative që i janë dhënë për t’u sprovuar. Kjo përkryerje që i është dhuruar njeriut, i është dhënë më shumë në anën shpirtërore sesa në atë fizike. Edhe qëllimi i mistikëve është që ta lartësojnë njeriun në gradën e përsosmërisë dhe ta bëjnë atë një rob të mirëfilltë ndaj Zotit (xh.xh.), duke i dhënë përparësi zhvillimit dhe edukimit shpirtëror.

Njeriu besimtar vepron sipas mënyrës shpirtërore në marrëdhëniet me Zotin dhe njerëzit. Ndërsa qendra kryesore në këto marrëdhënie të njeriut që nuk e ka marrë këtë edukim, nuk është mënyra shpirtërore, por stomaku, domethënë interesi. Ky njeri i tillë i harron Zotin dhe miqtë qoftë edhe për një interes të vogël të kësaj bote. Konceptet si sakrifica, shërbimi dhe dashuria që janë virtyte të shpirtit nuk kanë asnjë kuptim për njeriun e ditëve të sotme të cilit i është mbushur koka, por i është lënë zemra e zbrazur. Ky njeri është shndërruar në materialist dhe si rrjedhojë çdo gjë e bën për interes. Ndërkohe njeriu besimtar e ka zemrën të mbushur jo me dëshirat vetjake, por me Zotin ndërsa preokupohet me punët e kësaj bote. Imam Rabbani e shpjegon si më poshtë këtë gjendje:

“Në aparençë duken sikur i kushtojnë vëmendje kësaj bote, por në të vërtetë ata nuk e kanë të lidhur zemrën aspak me këtë botë. Ata janë të lirë prej çdo gjëje të dynjasë. **“Ata janë njerëz, të cilët shpëlblerja nuk i pengon për të përmendur Allahun...”** (Nur, 37) Pra, tregtia dhe allishverishi nuk i pengon dot për t’i bërë dhikër Allahut. Haxhe Nakshibendi (k.s.), ka thënë: “Në pazarin e Mina-së pash një tregtar të ri. Ai bëri allishverish rreth pesëdhjetë mijë dinarë. Por prapë se prapë zemra e tij nuk ishte e shkujdesur nga Zoti qoftë edhe një moment.” (Mektubat, vëll. 1, Letra e 33-të.)

Nakshibendinjtë e shprehin këtë situatë me konceptin: “Dora të fitojë, zemra Zotin të mos e harrojë.” Por ne në këtë shkrim do të shtjellojmë lidhjen e njeriut besimtar jo me Zotin, por me njerëzit e tjerë. Një besimtar që e ndërton marrëdhënien me Zotin mbi një adhurim të singertë, edhe marrëdhëniet me njerëzit do t’i formojë mbi një finesë të jashtëzakonshme si reflektim i marrëdhënies së ndërtuar me Krijuesin. Dashurinë që e ka për njerëzit, nuk e ka në emër të vetes, por në emër për të ndarë me ata thesarin e përshtatshmërisë që e ka arritur.

“Të mëdhenjtë e këtij tarikati i kanë dhënë lamtumirën robërisë ndaj të tjerëve që në hapin e parë të tarikatit. Në vend të këtyre, ata e kanë lidhur zemrën me Zotin dhe Krijuesin e njerëzve. Këto janë marrëdhëniet e të mëdhenjve me njerëzit që ishin shkak për udhëzimin dhe orientimin e këtyre të fundit. Shkaku që ata kanë formuar marrëdhënie

me njerëzit është për t'i orientuar ata drejt Krijuesit dhe për t'i lajmëruar në lidhje me gjërat prej të cilave është i kënaqur Zoti (xh.sh.). Padyshim se ata që u drejtohen njerëzve për t'i shpëtuar nga adhurimi i çdo gjëje përveç Zotit, janë shumë më të lartë se ata që e adhurojnë Allahun Teala vetëm për të shpëtuar veten e tyre. (Muktebat, vëll. I, Letra e 46-të.)

Ata që përpiqen të shpëtojnë vetëm veten e tyre dhe që nuk mundohen që edhe të tjerët të shpëtojnë, nuk konsiderohen njerëz të zemrës. Njeriu i zemrës, siç shikohet edhe nga vetë emërtimi, është një njeri që e ka gjallëruar zemrën dhe që i do krijesat për hir të Krijuesit. Njeriu i zemrës është i gatshëm t'i ndajë me të tjerët mirësitë që i ka vetë. Njerëzit që i kanë dhënë rëndësi zhvillimit shpirtëror si Imam Rabbani, Mevlana Xhaleleddin Rumi, Haxhe Bahaiddin Nakshibendi dhe Aziz Mahmud Hydaji, gjithmonë kanë qenë të preokupuar me ndërtimin/gjallërimin e zemrave të të tjerëve. Ata i kanë dhënë vlerë të madhe njeriut dhe dinjitetit të njeriut. Ata na kanë këshilluar që të sillemi mirë kundrejt njerëzve dhe të mos ia thyejmë zemrën askujt pa bërë dallim ndërmjet tyre nëse janë besimtarë apo jo. Gjithashtu na kanë këshilluar që në këtë mënyrë të mos shkëputet lidhja ndërmjet Islamit dhe njerëzve.

“Dijeni mirë se zemra është fqinji i Allahut Teala. Për Atë nuk ka gjë më të afër se zemra. Atëherë kini kujdes dhe mos thyeni apo lëndoni ndonjë zemër qoftë besimtare apo qoftë mëkatore, sepse fqinji i saj e mbron atë edhe nëse është mëkatore. Aman qëndroni larg kësaj, sepse pas kufrit (mohimit) nuk ka asnjë mëkat më të madh se sa thyerja dhe lëndimi i zemrës që e hidhëron Allahun Teala. Kjo për faktin se prej krijesave zemra gjendet më afër Allahut (xh.sh.).” (Mektubat, vëll. 3, Letra e 45-të.)

Zemrat e njerëzve të devotshëm janë të gjera. Ata i durojnë mundimet dhe vuajtjet që ua shkaktojnë njerëzit, sepse zemrat e atyre janë aq të thella sa që mund të zënë brenda të gjithë universin. Dhikri dhe ibadetet që ata i bëjnë janë shkak për zgjerimin e zemrave të tyre. **“A është njëlloj si ai që Allahu ia ka hapur kraharonin për të pranuar Islamin, duke qenë kështu në dritën e Zotit të vet,** (ashtu edhe ai që e ka zemrën të mbyllur ndaj besimit?!.)” (Zumer, 22)

Bazuar në këto që shpjeguan deri këtu, mos vallë njeriu i devotshëm duhet t'i pranojë të gjitha veprimet e njerëzve dhe nuk duhet të kundërshtojë në asnjë çështje për hir të faktit që të ndërtojë qoftë edhe një zemër tjetër? Mos duhet t'i neglizhojë dispozitat e qarta të fesë për hir të njerëzve? Imam Rabbani na bën paralajmërim të dobishme në lidhje me këtë çështje. Sipas tij gabimet e njerëzve mund t'i kundërshtojmë vetëm aq sa ka dhënë leje Zoti (xh.sh.). Këtu kërkohet që çështjen të mos e diskutojmë

sipas interesave vetjake dhe ndëshkimi të jepet pa kaluar në ekstremizëm dhe në përputhje të plotë me urdhrin e Allahut Teala. Në të kundërt, thjeshtë bëjmë padrejtësi në emër të Islamit.

Të gjithë njerëzit janë robërit e Allahut (xh.sh.). Nëse dikujt ia rrahim apo ofendojmë robin, kjo mund të bëhet shkak që ta zemërojmë zotërinë e tij. Atëherë, duke u bazuar në madhështinë e Allahut Teala i Cili është poseduesi absolut, me krijesat mund të veprojmë vetëm sikur ka urdhëruar Ai. Të vepruarit në këtë mënyrë nuk është i ndaluar, por përkundrazi është zbatim i urdhrin të Allahut (xh.sh.). Për shembull, ndëshkimi që i jepet një personi që bën imoralitet kur është beqar është njëqind goditje me shkop. Nëse dikush del dhe e shton këtë masë, atëherë bën padrejtësi. Ky veprim i tij konsiderohet zullum ndaj krijesave.

Njerëzit që nuk e kanë arritur këtë edukatë në marrëdhëniet me të tjerët dhe që nuk janë lidhur plotësisht me Zotin e tyre ngaqë nuk kanë shpëtuar totalisht nga egoizmi dhe ashpërsia, sado që të pohojnë se janë njerëz të devotshëm, kjo është një gënjeshtëri sipas sufive (mistikëve). Sipas Mevlanës ky pohim i atyre i ngjan pohimit të ujit në llucë i cili thotë se është i pastër:

“Ti thua se ke zemër. Thua, por zemra është mbi Arsh. Ndërsa ti je shumë poshtë.”

Të gjithë e dinë se në llucë gjendet ujë, por ja që me atë ujë nuk merret abdest. Në llucë gjendet ujë, por ai është i thithur nga lluca. Për këtë arsye, ka humbur në llucë. Andaj, ti nuk mund të thuash: “Edhe kjo është zemër.”, sepse zemra jote është mposhtur nga shpresat e pista, epshet, zemërimi, pasioni për pozitë dhe dëshirat në lidhje me këtë botë. (Mesnevi, III, 2245-47.)

Për fat të keq në ditët e sotme njerëzit e devotshëm ndërmjet myslimanëve janë pakësuar. Si rrjedhojë kanë filluar të dalin në pah sjellje dhe veprime larg edukatës në marrëdhëniet e ndërsjella. Për shkak të komentimit të gabuar të Islamit, myslimani ka arritur deri në atë gjendje sa që të përdorë armën kundrejt myslimanit. Ndërsa këto lloj komentimesh të gabuara të Islamit kanë shkaktuar të perceptuarit e Islamit në botë si të ishte një fe asociale. Për këtë arsye, në ditët e sotme ka rëndësi të veçantë që secili prej nesh të përpiqet seriozisht për t'u bërë besimtar i devotshëm. Sjelljet e mrekullueshme që kanë shfaqur për zbatimin e Islamit mistikët që ua përmendëm emrat më sipër, duhet të jenë shembull edhe për ne. Trashëgimtarët e këtyre mistikëve të mëdhenj edhe në ditët e sotme vazhdojnë ta zbatojnë Islamin në mënyrën më të shkëlqyer dhe të bëhen burim mëshire për njerëzimin. I përgjërohemi Zotit (xh.sh.), që të na i mbushë zemrat me dashurinë e Tij dhe të na e mundësojë që me këtë dashuri të përhapim mëshirë për njerëzimin.



DARU'L-ISLAM NË DYNJA DARU'S-SELAM NË AHIRET

— Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan —

Drama e tmerrshme e emigrantëve myslimanë që po përjetohet prej një kohe të gjatë në disa vende të largëta apo të afërta të botës, shtypjet e vrasjet barbare që i kanë nxjerrë njerëzit nga vendet e tyre dhe tentativat e udhëheqjeve për t'ua kufizuar myslimanëve mundësitë për të zbatuar fenë e tyre në vendet dhe shtetet e veta, na bëjnë të mendojmë përsëri në lidhje me disa gjëra. Shtjellimi i konceptit “Vend” dhe i të vërtetave që përmban ai është njëra prej këtyre pikave.

Së pari le të themi këtë: Vendi i vërtetë për myslimanët është Daru'l-Islam në këtë botë dhe Daru's-Selam në botën e përtejme.

Në kulturën tonë fetare kemi disa terma dhe përkufizime si daru'l-Islam, daru'l-emn, daru'l-kufr, daru'sh-shirk, daru'l-fisk... Këto shprehin llojet e vendeve në botë. Kur flitet për vendin në botën tjetër, përpara na dalin konceptet si daru's-selam (xheneti) dhe daru'l-adhab (xhehenemi). Edhe definicionet daru'l-ahire dhe daru'l-beka përdoren për të shprehur edhe xhenetin, edhe xhehenemin.

Shihet qartazi se këto koncepte dhe definicione

në lidhje me vendin janë bërë duke u mbështetur në bazën e besimit dhe mosbesimit. Këto do të ishte me vend që t'i shpjegonim qoftë edhe në mënyrë të shkurtër.

Daru'l-Islam: Vend nën udhëheqjen e Islamit, vend në të cilin janë të vlefshme dispozitat islame

Daru'l-Emn: Vend i përshtatshëm për të jetuar i sigurt dhe i lirë

Daru'l-Kufr: Vend nën udhëheqjen e atyre që e mohojnë Zotin (xh.xh.).

Daru'sh-Shirk: Vend në të cilin udhëheqin ata që i bëjnë shirk Zotit (xh.xh.)

Daru'l-Fisk: Vend në të cilin mëkatet bëhen hap-tazi dhe fshehurazi, vend ku dominojnë mëkatet dhe është nën udhëheqjen e mëkatarëve

Daru's-Selam: Vendi i lumturisë, xheneti

Daru'l-Adhab: Vendi i ndëshkimit, xhehenemi

Ky shpjegim i shkurtër apo kjo tablo na e tregon qartë se me çfarë kemi të bëjmë kur thuhet “vend”.

THIRRJA

I Dërguari i Allahut (a.s.), i cili është udhërrëfyesi ynë për në udhëzim, na thërret për te Allahu (xh. xh.). Argumenti për këtë të vërtetë është ajeti fisnik: ***“Kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë: “Unë, me të vërtetë jam mysliman.”***¹

Allahu fton për te daru's-salam: ***“Allahu i thërret njerëzit për në Vendin e paqes dhe shpëtimit (Xhenet)...”***²

Daru's-salam është xheneti. Këtë e vërteton ajeti në të cilin thuhet: ***“...Allahu, me mirësinë e Tij, ju thërret në Xhenet...”***³

Kjo do të thotë se Allahu Teala dhe Resulullahu (a.s.), me këto thirrje ua shpjegojnë myslimanëve se çfarë dijeje dhe qëllimi duhet të kenë për vendin. Për ta poseduar një vend si ai për të cilin bëhet thirrje, është e nevojshme përgjigjja ndaj kësaj thirrjeje.

“O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë!...”⁴

Përgjigjja ndaj thirrjeve të Allahut dhe të Dërguarit të Tij sigurisht se do të thotë një jetë e re për besimtarët, sepse të gjitha thirrjet e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij si dije dhe praktikë posedojnë cilësinë për t'u dhënë jetë besimtarëve në veçanti dhe njerëzve në përgjithësi. Bazuar në këto që thamë deri këtu, mund të arrijmë në këtë rezultat: Pranimi dhe përgjigjja ndaj thirrjes së të Dërguarit të Allahut (a.s.), kur ai ishte gjallë, domethënë, lënia e atyre që ka ndaluar dhe zbatimi i atyre që ka urdhëruar sipas mundësisë, do të thotë pranimi i asaj thirrjeje. Gjithashtu përgjigje ndaj kësaj thirrje, pra thirrjes së Allahut dhe të Dërguarit të Tij, do të thotë që edhe brezat që do të vijnë pas Pejgamberit të jetojnë duke i zbatuar urdhrat që gjenden në Kuranin Fisnik dhe Sunet. Kjo tregon se vendi Islam i cili do të thotë daru'l-Islam në këtë botë dhe daru's-salam në botën e përtejme, mund të themelohet duke iu përgjigjur thirrjeve në Kuran dhe Sunet.

Cilësia themelore e vendit që dëshiron të themelojë Islami, domethënë e daru'l-Islamit është: Vend larg “shirkut, i cili është padrejtësia më e madhe” dhe vend i Tevhidit në të cilin sundon drejtësia dhe ligjet. Kjo tregon se sa kuptimplota dhe të rëndësishme janë këto qëndrime dhe veprime të besim-

tarëve që do të vrapojnë drejt “thirrjes së Islamit” që u jep jetë dhe që do të jetë e vlefshme deri në kiamet.

PARALAJMËRIM

Nga ana tjetër, edhe ky paralajmërim hyjnor në këtë pikë shtrihet para syve një dimension tjetër të kësaj çështjeje. Ajeti i mëposhtëm na njofton për një rrezik serioz në lidhje me këtë çështje:

“Me të vërtetë, djalli është armik për ju, andaj vështrojeni si armik! Ai vetëm i josh ithtarët e vet, që të bëhen shokë të zjarrit të përflakur.”⁵

Këtu vihet në pah se ka një thirrës që fton për në daru'l-adhab që përfshihet brenda kornizës së konceptit “vend” dhe se duhet të jemi të zgjuar e të vetëdijshëm për këtë pikë të kësaj çështjeje.

I Dërguari i Allahut i cili fton për te Allahu Teala dhe shejtani (mallkuar qoftë) i cili fton për ta kundërshtuar Allahun, posedojnë dy thirrje të kundërta që do të përbëjnë llojin e vendit në këtë botë dhe në botën tjetër sipas preferencave të atyre që thirren.

“Atë Ditë keqbërësi do të hajë gishtat e duarve të veta, duke thënë: “Ah, sikur ta kisha marrë rrugën (e drejtë) me të Dërguarin! Ah, sikur të mos e kisha bërë filanin mik! Ai më ka larguar nga Këshilla (Kurani) që më kishte ardhur!” Në të vërtetë, djalli e braktis gjithmonë njeriun në çastin e nevojës.”⁶

Gjëja që duhet të bëjmë për të mos rënë në një pendim të tillë dhe për të mos mbetur të detyruar për ta pohuar këtë dhimbje të tmerrshme është e qartë: Ndjekja e rrugës së të Dërguarit të Allahut (a.s.), domethënë, pasimi i Sunetit sa të kemi mundësi.

Kuptimi i një pasimi të tillë nga aspekti i besimtarit që e realizon atë do të thotë themelimi i një vendi i cili do të jetë daru'l-Islam në këtë botë dhe daru's-salam në botën e përtejme. Për ta arritur këtë duhet t'u përgjigjemi pa hezitim dhe dyshim thirrjeve të Allahut dhe të të Dërguarit të Tij të cilat na japin jetë. Arritja e këtij përfundimi të bukur, pra shfaqja e ajetit: ***“...Kjo është për të devotshmit...”***⁷, do të thotë arritja e një fundi të lumtur.

Vendi pikërisht tani ka kuptim dhe është i bukur. Ja pra, edhe garuesit le të futen në garë për këtë.

■ **REFERENCAT:** 1) Fussilet, 33. Ky ajet fisnik para së gjithash përkufizon të Dërguarin e Allahut, (a.s.). Natyrisht se çdokush prej njerëzve që jeton sipas Islamit dhe përpiket të bëhet një rob i devotshëm përfshihet nga shprehja “që i fton njerëzit drejt Allahut”. Të njëjtën gjë mund ta themi edhe për myezinët që i ftojnë njerëzit për t'i bërë ibadet Allahut Teala. Pejgamberi ynë i nderuar i ka përgëzuar ata duke u shprehur: “Ata që do ta kenë qafën më të gjatë ditën e gjykimit do të jenë myezinët.” (Muslim, Salat, 14; Ibn Maxhe, Ezan, 5.) 2) Junus, 25. 3) Bakara, 221. 4) Enfal, 24. 5) Fatir, 6. 6) Furkan, 27-29. 7) Zuhruf, 35.



BESO DHE SHPËTË

— Ahmet Zijlan —

Besimi është koka e çdo gjëje. Kështu është edhe në adhurim, edhe në biznes, edhe në arsim, edhe në gjërat e tjera të ngjashme me këto. Nëse njeriu ka ndonjë problem në besim, veprat që bën as që shikohen... Sepse ato nuk shprehin ndonjë kuptim dhe nuk kanë ndonjë dobi. Ai që nuk beson, në fakt edhe nuk mund të veprojë. Edhe nëse vepron, vepron duke hezituar dhe shkatërrohet që në problemin më të vogël me të cilin përballet. Prandaj, njeriu në fillim duhet të besojë vetë. Në fillim duhet të besojë vetë se do t'ia dalë mbanë, se do ta bëjë dhe se do ta arrijë qëllimin.

Në Kuranin Fisnik ka dy ajete që i lexojmë çdo ditë pas namazit të jasisë. Ato janë dhurata e Miraxhit... Pra, janë dy ajetet e fundit të sures Bekare. Si fillojnë ato: "Amene'rr-Rrasulu... Pejgamberi besoi." Në fillim beson i Dërguari i Allahut (a.s.). Pra, i beson mesazhit të tij, detyrës së tij dhe se do t'u sjellë njerëzve e shoqërive lumturinë... Beson se do t'i

japë fund xhahilijetit, do t'i shkatërrojë idhujt dhe se do të ndërtojë civilizimin e virtyteve...

Këtu ka një mësim të mirë për të gjithë ata që fillojnë ndonjë punë të dobishme në këtë botë. Askush nuk duhet të thotë: "Të më besojë dikush dhe të më mbështesë, në mënyrë që edhe unë t'ia dal mbanë." Jo, jo, së pari duhet të besosh ti.

I Dërguari i Allahut (a.s.), nga njëra anë ishte një sipërmarrës. Ai hodhi hapin për ta ndërruar gjendjen e një shoqërie e cila kishte vite që jetonte në xhahilijet/injorancë. Ai e kishte të plotë edhe mbështetjen te Allahu, edhe besimin ndaj vetes. Me lejen e Allahut Teala e arriti suksesin për 23 vjet. Siç e pranoi thirrjen e tij i gjithë gadishulli arabik, edhe krahinat e gjera u njoftuan për mesazhin e Islamit. Prandaj është shumë e rëndësishme që njeriu t'i besojë pikërisht vetes së tij, por edhe liderët e kauzave të mëdha dhe sipërmarrësve të mëdhenj kanë nevojë për një kuadër që i mbështesin dhe u

besojnë. Ata janë ndihmësit më të mëdhenj dhe burimet e moralit.

Kur i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, mori shpalljen e parë, shkoi në shtëpinë e tij duke u dridhur nga madhështia e asaj që kishte përjetuar. Ai një herë digjej nga temperatura dhe një herë kishte të ftohtë sikur ta kishte kapur sëmundja e malaries. Kur Hatixhja e pyeti: “Çfarë të ka ndodhur?” – i Dërguari i Allahut (a.s.), ia tregoi të gjitha ato që kishte përjetuar. Pastaj i tregoi rreth madhësisë dhe vështirësisë së detyrës për të cilën ishte zgjedhur. Ajo, nëna jonë e madhe, i tha: “Përse shqetësohesh?” Ai ia ktheu: “Kush do të më besojë mua?” Hatixhja i tha: “Të besoj unë, o i Dërguari i Allahut!”

Ja, mbështetja më e madhe është mbështetja që të vjen nga shtëpia. Mbështetja që të vjen nga bashkëshortja. Mbështetja që të vjen nga njeriu më i afërt. Pa mendoni një herë për një bashkëshorte që i thotë burrit të saj: “Mos vallë je i çmendur? Përse merresh ti me këto gjëra? Mos do të na hapësh telashe?” Ky do të ishte një shkatërrim morali shumë i madh që në hapin e parë. Për këtë arsye, kanë thënë: “Pas çdo burri të suksesshëm ka një grua.”

Të besosh është shumë e rëndësishme. Besimi dhe besnikëria e njerëzve, të cilët ecin drejt një ideali, ndaj liderëve të tyre janë shumë të rëndësishëm. I Dërguari i Allahut, (a.s.), e formoi këtë kuadër në periudhën e Mekës. Allahu i Madhëruar atë kohë i dhuroi atij kuadri edhe ngjarjen e miraxhit, në mënyrë që t’i forcohej besimi. Domethënë, miraxhi ishte një nderim për të Dërguarin e Allahut (a.s.), por ishte edhe një sprovë e madhe për myslimanët e parë. Politeistët filluan të talleshin duke thënë:

“A e keni dëgjuar se çfarë ka thënë ai profeti juaj?!. Ai paska shkuar deri në xhaminë Aksa. Sikur të mos mjaftonte kjo, paska shkuar deri në qiell. A edhe këtë do ta besoni? Mos na thoni se edhe kjo është e vërtetë!” Këto fjalë ia thanë edhe Ebu Bekrit (r.a.). Përgjigja e vetme e Ebu Bekrit (r.a.), ishte kjo: “Nëse e ka thënë ai, është e vërtetë.” Në këtë mënyrë, ai vuri në pah logjikën dhe arsyetimin e zgjuar të tij duke u shprehur: “Unë besoj se ai merr shpallje nga Allahu Teala dhe se takohet me Xhebrailin, (a.s.). Nëse u besoj këtyre, sigurisht se do t’i besoj çdo gjëje që thotë ai. Prandaj, çfarëdo që thotë ai është e vërtetë.”

Ja, kështu u bë Siddik Ebu Bekri (r.a.). Përgjatë jetës 23 vjeçare të profecisë së të Dërguarit të Allahut (a.s.), Ebu Bekri (r.a.), ishte mbështetësi më i madh materialo-financiar dhe shpirtëror i tij në Mekë, në hixhret, në Medinë, në luftërat dhe në çdo vend.

Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), u shtroi një gosti të afërmeve të tij, asnjëri prej tyre nuk bëri zë. Ndërsa ata që mendonin si Ebu Lehebi filluan të ofendonin. Aliu, edhe pse ishte një fëmijë i vogël, u hodh përpara dhe tha: “Ty të besoj unë, o i Dërguari i Allahut!” Nderimi më i madh që Allahu Teala i dha Pejgamberit (a.s.), ishin këta besimtarë. Për këtë arsye, patjetër duhet të keni ndihmëtarë që i besojnë idealit tuaj dhe që besojnë se ju do ta arriini synimin që i keni vënë vetes. Nisur nga kjo, ju duhet të formoni pikë së pari një kuadër të sinqertë dhe besnik.

Disa prej pashallarëve që e kundërshtonin që në fillim rrethimin e Stambollit, përgjatë ditëve të rrethimit që kalonin, i propozonin Fatihut që ta hiqte rrethimin. Ndërsa Akshemseddini u bë mbështetësi më i madh i Fatihut dhe fuqia shpirtërore e tij duke insistuar për çlirimin. Më në fund, çlirimi u realizua me sukses. Prandaj, konsultimi është kusht, por patjetër duhet të bëhet me njerëz trima, të ditur dhe optimistë...

Ne kemi nevojë për njerëz që na këshillojnë në lidhje me dispozitat e fesë së Allahut të Lartësuar dhe na japin kurajë për të bërë atë që është më e drejta e për të vepruar me ndershmëri. Gjithmonë duhet t’ua vëmë veshin njerëzve që na këshillojnë me fjalë të urta, me histori mësimdhënëse dhe me shembuj domethënës. Sado që ne të dimë, prapë se prapë kemi nevojë të pashmangshme për të dëgjuar dhe mësuar. Përse i përsërisin me qindra herë reklamat në radio dhe televizion? Sepse kështu gdhenden në mendje dhe zënë vend në memorie. Prandaj edhe ne kemi nevojë ta dëgjojmë me qindra herë të vërtetën.

Babai im ka qenë një njeri që kishte biseda të ëmbla, orator, elokuent dhe një njeri me shpirt prej poeti. Ai bënte kuvende fetare duke treguar shembuj plot urtësi. Unë kam dëshmuar disa herë kur njerëzit e dëgjonin bisedën fetare të babait tim deri në orën dy apo tre të natës pa u mërziur dhe bezdisur aspak. Gjithashtu ka pasur raste edhe kur thoshin: “Mahmut aga, u bë vonë, por sidoqoftë na trego edhe më shumë!”

Më sipër thamë se edhe njëra prej urtësive të miraxhit ishte të provuarit e fuqisë së besimit të besimtarëve. Kjo sprovë nuk ishte e vlefshme vetëm për atë periudhë, por do të jetë e vlefshme deri në Kiamet. Edhe dje ka pasur prej atyre që nuk kanë besuar, edhe sot ka prej tyre.

Një herë, kur babai im ishte gjallë, një ditë para natës së miraxhit, një i pafe kishte mbledhur dy-tre veta në një tavolinë para lokalit dhe po i helmonte duke u thënë: “Si mund të dalë një njeri në qiell? Kjo

na u quaka miraxh! Kë po mashtrojnë këta?” Ata tre burrat ishin trembur dhe i kishin thënë: “Si mund ta thuash këtë?” Ai ua kishte kthyer: “Vëllezër, a mund t’ua pranojë logjika juaj këtë? Si paska shkuar dhe paska ardhur pa iu ftohur ende vendi në shtratin e tij? A mund të ndodhë diçka e tillë?” Ata të tre i kishin thënë për shkak të padijes së tyre: “Ai ka dalë në qiell, por ka dalë me syrin e zemrës.” Burri dukej qartë se ishte prej ateistëve materialistë që i ka helmuar ideologjia komuniste. Çfarë të kuptojë ai nga zemra dhe shpirti? Atyre u kishte thënë: “Mos u bëni kaq injorantë! Njeriu ka katër sy në zemër. Në dy prej tyre qarkullon gjak i pastër dhe në dy të tjerët qarkullon gjak i papastër. Njëri qarkullon në trup, ndërsa tjetri shkon në mëlçi dhe pastrohet. Mos ka edhe ndonjë sy tjetër zemra që thoni se ka dalë në qiell me syrin e zemrës?”

Ndërkohë i Dërguari i Allahut (a.s.), nuk është ngjitur në qiell ashtu si në botën e ëndrrave. Veçanërisht për Isranë, domethënë, për shkuarjen nga Mesxhidu’l-Haram në Mekë deri në Mesxhidu’l-Aksa në Kuds ka konsensus ndërmjet dijetarëve se ka shkuar me shpirt dhe me trup. Kjo vërtetohet me ajetin fisnik. Shumica dërmuese e dijetarëve janë në konsensus se ky udhëtim ka vazhduar në të njëjtën mënyrë, domethënë, me trup dhe me shpirt. A nuk është Allahu i plotfuqishëm? A nuk është Ai që i ka krijuar këto ligje të fizikës? A mund të jetë i varur Ai nga këto ligje? Asnjëherë... Nëse Ai dëshiron ta çojë në qiell robin e Tij, i krijon shkaqet dhe e çon. Por ja që burri nuk besonte. Çfarë mund t’i thoni atij në këtë situatë? Prandaj ai le të mohojë derisa t’i vijë vdekja, të ngrihen perdet, të vijë Dita e Kiametit dhe ta shohë atë botë me sytë e tij!

Këta tre burrat nuk i jepnin dot përgjigje atij. Për shkak se nuk ia mbyllnin dot gojën, filluan të shqetësoheshin prej tij. Nuk e di si ta quajmë, rastësi apo mirësi, por ja që në ato momente babai im po kalonte aty. Ata menjëherë i thirrën babait, ngaqë e dinin se ai ishte orator, elokuent, mjeshtër në të folur dhe i aftë për t’i bindur të tjerët:

-Mahmut aga! Mahmut aga! A mund të vish pak?

-Çfarë ka ndodhur?

-Këtu ndodhet një i pafe dhe jobesimtar. Ai e mohan ngjarjen e Miraxhit. Thuaja ndonjë fjalë këtij!”

Babai im mori frymë thellë. Çështja ishte serioze... Burri i pafe ishte ulur dhe po devijonte njerëzit. Atij duhej t’ia tregonte cakun. Babai ishte ulur dhe i kishte pyetur: “Cili është problemi?” Ata i treguan për çdo gjë. Babai im u kishte thënë:

-Domethënë kështu ë? Shumë mirë. Atëherë, para

“Unë besoj. Ti po deshe beso, po deshe mos beso! Nëse nuk beson, ti do të humbasësh. Nëse beson, ti do të fitosh. Prandaj mos u mundo për t’i hedhur njerëzit në dyshim!”

se të fillojmë debatin, le ta nxjerrim në pah veten tonë. Kush je ti dhe kush jam unë? Çfarë je ti dhe çfarë jam unë? Që nga dita e parë e deri më sot njeriu ka gjetur dhe ka zgjedhur një të adhurar për vete. Qoftë ky i adhurar i vërtetë apo i gabuar. Dikush ka adhurar zjarrin, dikush ka adhurar idhujt, dikush ka adhurar lopët dhe dikush tjetër i ka besuar Allahut. Dikush është bërë i krishterë, dikush është bërë çifut, dikush është bërë kështu, dikush është bërë ashtu, ndërsa dikush tjetër është bërë mysliman. Kjo është një e vërtetë historike, apo jo?

-E vërtetë!

-Atëherë, cili prej këtyre je ti? Ta dimë këtë, në mënyrë që të debatojmë sipas kësaj.

Burri kishte thënë:

“Unë nuk pranoj asnjërin prej këtyre.”

“Unë t’i thashë njëri pas tjetrit. Njerëzit kanë kërkuar dhe kanë gjetur një të adhurar për veten e tyre. Meqë ti nuk i pranuar asnjërin prej këtyre, do të thotë se nuk je njeri. Ndërsa unë nuk di të flas gjuhën e kafshëve. Për të folur me ty, duhet të jesh kafshë. Andaj, unë nuk kam asgjë për të folur me ty!” Në këtë mënyrë ia kishte treguar vendin. Pra, kjo ishte një formë tjetër e shprehjes se Ebu Bekrit. “Unë besoj. Ti po deshe beso, po deshe mos beso! Nëse nuk beson, ti do të humbasësh. Nëse beson, ti do të fitosh. Prandaj mos u mundo për t’i hedhur njerëzit në dyshim!” Njeriu beson. Ai beson sikur sheh me sy. Nuk i heton dhe nuk i sheh me dyshim gjërat që beson. Njerëzit e tillë janë myslimanët. Ata besojnë se Allahu ka dërguar pejgamberë, se ka dërguar libra dhe se engjëjt që janë rreth nesh i shkruajnë veprat tona. Domethënë, u besojnë shumë gjërave që nuk mund t’i perceptojë mendja jote



e ngushtë. Prandaj përse të mos i besojnë miraxhit? Ti e paske humbur besimin tënd. Gjithashtu e paske humbur edhe humanizmin.

Nëse dyshon për miraxhin, do të dyshosh për çdo gjë. Pastaj thua: “Nuk ka engjëj, nuk ka libër dhe nuk ka shpallje.” Kjo nuk ka fund. Pastaj e mohon edhe Allahun, Zoti na faltë.

Unë kam besuar dhe e kam kuptuar çështjen. E kam hapur syrin e zemrës dhe e kam kuptuar çështjen, edhe nëse nuk e sheh dot syri i kokës. Edhe ti do ta kuptosh një ditë, siç thuhet edhe në Kuranin Fisnik: **“Për çfarë e pyesin ata njëri-tjetrin? Për Lajmin e madh, rreth të cilit ata kanë kundërshtime. Anë, shpejt do ta marrin vesh! Sigurisht që shpejt do ta marrin vesh!”** (Nebe’, 1-5) Por atë ditë të kuptuarit nuk do të ketë dobi: **“Dhe, kur të sillet Xhehenemi, atë Ditë njeriu do të kujtohet - por ç’i duhet se u kujtua!”** (Fexhr, 23) Për këtë arsye, së pari duhet të besojmë. Në çdo moment duhet t’i besojmë ekzistencës e njësimi të Allahut Teala dhe nuk duhet të kemi qoftë edhe dyshimin më të vogël. Si kush? Si nëna jonë Hatixhja. Si sahabi i nderuar, Ebu Bekr es-Siddiku. Si sahabi i nderuar, Aliu (r.a.).

Përse kemi ardhur në këtë botë?

Junus përse ke ardhur në këtë botë?

Që gjuha ta përmendë Zotin natë e ditë.

Poeti i njohur, Junus Emre e shpjegon çdo gjë me dy vargje. Allahu i Lartësuar na ka dërguar në këtë botë për t’ju nënshtruar, për ta adhuruar dhe për ta përmendur Atë natë e ditë. Allahu na bëftë prej robërve të Tij që e përmendin pa reshtur dhe mos na bëftë prej atyre që e humbin besimin dhe dyshojnë në çdo gjë!

Që nga fillimi po e shtjellojmë temën duke nxjerrë

në pah se edhe në jetën e biznesit duhet t’i besosh synimit që ke. Ti e ke vendosur synimin dhe beson se do t’ia dalësh mbanë me sukses. Nëse ke vepruar kështu, atëherë mos u preokupo me ata që e shohin të palogjikshme këtë dhe që nuk e pranojnë. Disa njerëz çdo gjë e shohin me dyshim. Nëse bota do të kishte ngelur gjithmonë në dorë të këtyre kundërshtuesve, shumë gjëra nuk do të shpikeshin. A do të prodhoheshin avionët e sotëm sikur të merreshin parasysh fjalët e atyre që thoshin: “A mund të fluturojë një gjë e rëndë me tonelata?” Mendoni për operacionet. Mendoni për shumë teknika nga mikro deri te makro. Të gjitha këto janë sukseset e atyre njerëzve që besuan se ia dilnin mbanë. Po ashtu janë edhe sukseti i atyre që u besuan dhe i mbështetën ata.

Të besosh do të thotë të shikosh para se të shohësh me sy dhe ta integrosh atë në zemër apo në kokë. Kur Fatihu ishte fëmijë, shikonte ëndrrat e çlirimit. Ai e besonte këtë gjë. Atëherë, si t’ua shpjegonte atyre që nuk e besonin? Këtë mund t’ua shpjegonte vetëm duke e çliruar Stambollin. Ai e çliroi Stambollin dhe e nxori në pah suksesin e tij. Edhe njeriu që shpik, e kryen projektin dhe e nxjerr në pah. Këtu sigurisht se duhet ta shtjellojmë në veçanti edhe çështjen e të vepruarit vetës sipas imagjinatës.

Asnjëherë nuk duhet të harrojmë se Allahu është i Plotfuqishëm, ndërsa ne nuk jemi. Gjërat që njeriu mund t’i imagjinojë pa futur në llogari të vërtetat e tregut, ligjet e fizikës, shpenzimet e prodhimit dhe gjendjen e vendit e të botës, nuk janë plane apo projekte, por imagjinata të pavlera. Sikundër njerëzve që e ekzagjerojnë në dyshime dhe në vesvese, ka prej atyre që i besojnë vetes më tepër seç duhet dhe janë tepër optimistë. Domethënë janë robër të imagjinatës dhe aventurës. Nëse njerëzit e tillë i bëjnë edhe të tjerët që t’u besojnë imagjinatave të tyre, në pah dalin falimentime dhe dështime të mëdha. Në lidhje me këta njerëz gjithmonë duhet të pyesim: “Çfarë suksesesh kanë arritur deri më sot? Ai i kanë borxhe kujt? A gënjejnë? Si i kanë llogaritë personale? A mund t’i administrojnë si duhet paratë e tyre? A e njohin vetë punën që duan të bëjnë? Vallë, flasin për para që fitohen shpejt dhe lehtë apo për një fitim të ngadaltë dhe të vazhdueshëm që arrihet me punë serioze?”

Allahu i Lartësuar na bëftë prej atyre që e arrijnë të vërtetën, që i besojnë më të mirës dhe që e arrijnë më të mirën në të dy botët! Gjithashtu na dhëntë partnerë, shokë, ortakë, punëtorë dhe fëmijë që na besojnë në idealet tona të larta dhe të frytshme!

Amin!..



A luteni dot për grushtet **QË JANË DREJTUAR KUNDREJT JUSH?**

— Xhafer Durmush —

Kurdo që ulem para fjalës së Allahut Teala (Kuranit Fisnik) për të lexuar suren Jasin, emocionohem kur arrij të shembulli i “As’habu’l-Karje” që gjendet në faqen e dytë.¹ Pastaj rënkoj duke thënë: “Ah ne myslimanët! Ne duhet ta kontrollojmë zemrën.” Qëllimi prej këtyre shembujve nuk mund të jetë për të na lajmëruar në lidhje me ato ngjarje që kanë ndodhur dhe kanë kaluar. Andaj mendoj se duhet ta lexojmë saktë mesazhin që jepet nëpërmjet tyre.

Shembulli i As’habu’l-Karje”² fillon me një fjali interesante. Allahu i Lartësuar thotë: “I Dashuri im!) Tregoj atyre për popullin e këtij qyteti.” Në këtë mënyrë, e njofton umetin e Muhamedit (a.s.), për gjendjen shumë të dhimbshme në të cilën ranë ata për shkak se i kundërshtuan pa argumente të dërguarit e Zotit (xh.sh.). Meqë ka ndodhur kështu, atëherë duhet të marrin mësim jo vetëm ata që mbartin detyrën e predikimit, por të gjithë pa përjashtim.

Në Ruhul-Bejan thuhet se Allahu Teala me këto ajete tregon mirësinë e Tij kundrejt njerëzve të devotshëm dhe ndëshkimin e Tij kundrejt atyre që e kundërshtojnë. Ndërsa i ndjeri Omer Nasuhi Bilmeni thotë se këto shembuj janë dhënë për të paralajmëruar femohuesit. Po, kjo është e vërtetë, por a thua vallë janë dhënë për të paralajmëruar vetëm ata? Nëse një njeri kundërshton dhe bëhet si As’habu’l-Karje kundrejt atyre që i kujtojnë të vërtetën kur bëhet fjalë për dëshirat vetjake, atëherë përse këto shembuj të jenë vetëm për femohuesit?

Këtu shohim këtë: Njerëzit e qytetit për të cilin po flasim nuk menduan aspak ta kuptonin qëllimin e dy të dërguarve që iu dërguan atyre. Përkundrazi ata i kërcënuan dhe i kundërshtuan me ashpërsi. Gjithashtu, edhe përforcimi i dy të dërguarve me një person të tretë nuk i shtyu ata që të bënin kuj-

des. Për këtë arsye, e praktikuan kërcënimin që e shprehën në fillim. Prej këtu kuptojmë se justifikimet dhe kundërshtimet e femohuesve gjithmonë u kanë ngjarë njëra-tjetrës. Sepse, edhe ata për të cilët flitet në këtë shembull, edhe ata që kanë ardhur pas atyre nuk i kanë menduar dhe nuk i kanë vlerësuar asnjëherë këshillat e këshilluesve që mund të përmbliidhen në këtë mënyrë: “Besojini Allahut i Cili është një! Mos i bëni shirk Atij! Ai është që e jep jetën dhe e merr atë. Një ditë absolutisht do të dilni para tij për të dhënë llogari për ato që keni bërë.” Përkundrazi, ata u përpoqën t’i frikësonin të dërguarit duke i kërcënuar dhe duke i akuzuar për mashtrim dhe sjellje të ogurit të keq. Kur i ndjeri Omer Nasuhi Bilmeni i shtjellon këto qëndrime të pavenda të jobesimtarëve, bën një shpjegim të tillë duke transmetuar nga Alusi: “Injorantët gjithmonë e kanë pasur traditë të thoshin se ata që ftojnë te Zoti sjellin fatkeqësi. Kjo sepse ata çdo gjë që u përshatatet dëshirave të tyre e konsiderojnë si të mirë edhe nëse ajo u sjell të gjitha të këqijat. Ndërsa gjërat që nuk u përshtaten dëshirave të tyre i konsiderojnë si ogur i zi edhe pse ato mund të sjellin të gjitha të mirat.”

Ndërkohë të dërguarit duke mbajtur për dëshmitar Allahun në lidhje me vërtetësinë e atyre që do t’u thoshin, u shprehën: “Ne nuk kemi detyrë tjetër përveçse t’ju predikojmë në mënyrë të qartë urdhrat e Allahut.” Ndërsa për t’u dhënë përgjigje akuzave të atyre, thanë: “A është ogur i zi fakti që po këshilloheni?” Me këtë pyetje u munduan t’i ftonin ata për të bërë kujdes.

Ndërsa njeriu besimtar i cili i dëgjoi këto që po ndodhnin dhe që erdhi nga skaji tjetër i qytetit, i paralajmëroi njerëzit e nxehur duke u thënë (brenda kornizës së predikimit): “Pasojin këta njerëz


që nuk po kërkojnë pagesë prej jush!” Domethënë se sakrifica është argument për sinqeritetin dhe besnikërinë. Kjo gjithmonë kështu ka qenë dhe kështu do të mbetet deri në kiamet. Për she-mbull, në suren Shuara flitet për përpjekjet e mëdha që kanë dhënë pejgamberët në lidhje me tev-hidin. Aty shprehet në mënyrë të veçantë se ata pejgamberë nuk kanë kërkuar asnjë lloj pagese për predikimin.³ Edhe i Dërguari i Allahut, pagja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, u ka thënë politeistëve që i propozuan pozitë dhe pasuri, në mënyrë që të hiqte dorë nga kauza e tij: “Nuk do të heq dorë edhe nëse më jepni në njërën dorë diellin dhe në dorën tjetër hënën.”⁴

Në ajetet fisnike që vijnë shohim se njerëzit e qytetit në fjalë e kanë vrarë pa gjykim burrin besimtar që i mbështeti të dërguarit. Në frymën e fundit të asaj zemre të dëlirë dëgjojmë fjalët gjithëpërfshirëse që i tha. Me të vërtetë, mendimet dhe shpresa e burrit besimtar që erdhi nga skaji tjetër i qytetit janë të rëndësishme. Ai së pari grupit të njerëzve të zemëruar i dha një rregull të artë duke thënë: “Shikoni! Këta nuk po kërkojnë asgjë prej jush. Ata kanë ardhur t’ju kapin për dore në mënyrë miqësore. Po ju thërrasin t’i besoni Allahut i Cili është një. Merrini seriozisht ato që thonë këta!” Ai ua tha këto fjalë duke iu përgjyruar atyre. Gjithashtu ky burrë besimtar u lut për ata që i kishin zgjatur duart për t’i marrë jetën duke u shprehur: “Ah sikur ta dinte populli im këtë gjendjen time! Sikur ta dinte se Zoti më fali dhe më ka pritur me nderime.” Prej syve të atyre shpërthente zemërim, ndërsa prej zemrës së atij shpërthente mëshirë. Ai e dorëzoi shpirtin duke thënë: “Ah sikur ta dinte! Ah sikur ta dinte!..”

Besojmë se historia e banorëve

të këtij qyteti synon të na tregojë horizontin e atij burrit besimtar. Këtë gjë na e kërkojnë edhe ajetet fisnike në të cilat thuhet: “Këshillojini ata në mënyrën më të bukur.”⁵ Këtë na e mëson edhe i Dërguari i Allahut (a.s.), i cili bëri dua për pasardhësit e atyre që i gjuajtën me gurë në Taif.⁶ Pyetja në ditët e sotme duhet të jetë kjo: A mund të lutemi me sinqeritet për grushtet që janë drejtuar kundrejt nesh, në mënyrë që ata të bëhen duar që mund t’i kapim miqësisht?

■ **REFERENCAT:** 1) Shik. Surja Jasin, ajetet 13-26. 2) Në disa libra gjenden transmetime të ndryshme në lidhje me qytetin se ku ka qenë, se cili ka qenë populli i tij dhe në lidhje me të dërguarit. Shik. Komentimi i Ruhul-Bejan, Ismail Haki Bursevi, Botim Erkam, vëll. 16, fq. 288-289; Enciklopedia e Kryesisë së Entit Fetar për Çështjet Islame të Republikës së Turqisë, Tema As’habu’l-Karje, Abdullah Ajdemir, vëll. 3, fq. 468-469. 3) Shik. Surja Shuara, 26/109, 127, 145, 164, 180. 4) Taberi, 2/218-220; Ibn Kethir, Siretu’n-Nebevije, 1/474. 5) Shik. Surja Ankebut, 29/26. 6) Buhari, Bed’u’l-Halk, 7.



ATA QË JANË PASTRUAR NUK MASHTROHEN

Në suren A’la thuhet: *“I shpëtuar është ai që pastrohet, që e përmend emrin e Zotit të vet dhe që fal namaz! Por ju, përkundrazi, më shumë po e parapëlqeni jetën e kësaj bote, ndonëse jeta tjetër është më e mirë dhe e amshuar.”* (A’la, 14-17)

Këto ajete na tregojnë rrugën e lumturisë së përhershme dhe na kujtojnë shkakun themelor të mashtrimit që na privon nga lumturia në fjalë. Bazuar në këtë, besimtari së pari duhet të marrë nën kontroll dëshirat vetjake, duhet të pastrohet nga gjurmët që mbetin prej shtypjes së pasioneve dhe duhet të ndërtojë atmosferën që ia ushqen shpirtin. Pastaj duhet ta stolisë zemrën me ibadete dhe dhikër. Ai duhet t’i zbatojë detyrat e nënshtrimit ndaj Zotit (xh. sh.) duke i respektuar urdhrat dhe ndalesat hyjnore.

Ja pra, këto që u thanë janë korniza kryesore e nënshtrimit ndaj Zotit (xh.sh.). Allahu i Lartësuar i përgëzon me lumturinë e përhershme ata që jetojnë brenda kornizës së nënshtrimit ndaj Tij. atyre u premton mirësitë e xhenetit që sytë nuk i kanë parë e mendjet nuk i kanë imagjinuar, bukurinë e Vet dhe më së fundi kënaqësinë e Tij.

Por ja që njeriu ka një pikë të dobët. Kur ai e shikon interesin e menjëhershëm, i harron nganjëherë ato që i janë premtuar edhe pse Ai që ka dhënë fjalën është Allahu Teala i Cili asnjëherë nuk e thyen premtimin.

Ndërkohë esenca e fesë është besimi ndaj gajbit (të padukshmes). Pra, të veprosh sipas besimit duke i besuar asaj që nuk e shikon sikur po e shikon. Si përmbledhje mund të themi: Ata që e pastrojnë nefsin nga dëshirat e saj dhe që e stolisin zemrën me dëshirën për adhurim e ibadet, nuk mashtrohen nga kënaqësitë e kësaj bote provizore dhe nuk e harrojnë botën e përtejme.

Ma'n ibn Adij el-Axhlani

- RADIJALL-LLAHU ANHU -

sahabi që shkatërroi xhaminë Dirar

— Mustafa Erish —

Ma'n ibn Adij el-Axhlani (r.a.), ishte prej shkruesve të shpalljes hyjnore të të Dërguarit të Allahut (a.s.)... Ai ishte një besimtar prej fisit Evs që u takua në Akabenë e dytë me Resulullahun, (a.s.)... Ishte një fatlum që pas hixhretit u shpall vëlla me Zejd ibn Hattabin (r.a.), i cili ishte vëllai i madh i Omerit (r.a.)... Ishte një hero prej sahabëve që u ngarkuan nga Pejgamberi ynë i nderuar me detyrën për të shkatërruar xhaminë Dirar...

Ma'n ibn Adij el-Axhlani el-Ensari (r.a.), ishte medinas që i përkiste krahut Amr ibn Auf ibn Malikut të fisit Evs. Ai njihej si mëkëmbësi i Auf ibn Malikut. Gjithashtu njihet edhe si "Halifu'l-Ensar". Domethënë, transmetohet se ai ka ardhur në Medine duke bërë marrëveshje me këtë fis dhe se ka hyrë nën mbrojtjen e tyre. (Isabe, VI, 151.)

Për fat të keq, ne nuk kemi informacion të gjerë në lidhje me hyrjen në Islam dhe jetën e Ma'n ibn Adij el-Axhlanit (r.a.). Në literaturën islame thuhet se ai është takuar me të Dërguarin e Allahut (a.s.), në besatimin e dytë të Akabesë. Përveç të tjerash thuhet edhe se pas hixhretit të Resulullahut (a.s.), në Medine është shpallur vëlla me Zejd ibn Hattabin i cili ishte vëllai i madh i Omerit (r.a.). (Istiab, IV, 1442; Hakim, III, 352.) Transmetohet se ai ka marrë pjesë në të gjitha luftërat bashkë me të Dërguarin e Allahut, (a.s.), ndër të cilat mund të përmendim Bedrin, Uhudin dhe Hendekun. (Isabe, VI, 151; Istiab, IV, 1442.)

Ai nuk deshi ta merrte pjesën që i takonte kur po shpërndaheshin plaçkat e luftës që u morën në luftën e Bedrit. Por pastaj pranoi pasi e urdhëroi për ta marrë i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të. Resulullahu (a.s.), e ngarkoi atë



edhe me detyrën e një shërbimi. Atij i dha detyrën e shërbimit për t'ia çuar pjesën e plaçkës së luftës familjes së Mubeshir ibn Abdulmundhirit i cili ra dëshmor në luftë.

Ma'n ibn Adij el-Axhlani (r.a.), ishte njëri prej shumë pak njerëzve që dinin shkrim e këndim para ardhjes së Islamit. Për këtë arsye, ai ishte prej shkruesve të shpalljes hyjnore të të Dërguarit të Allahut (a.s.). (Dhehebi, Tarihu'l-Islam, II, 44.) Pejgamberi ynë i nderuar i dha atij një detyrë të rëndësishme. Kjo detyrë ishte që ta digjte dhe shkatërronte xhaminë Dirar e cila ishte ndërtuar nga hipokritët.

Përse dhe kur u ndërtua xhamia Dirar? Përse dhe kur u dogj dhe u shkatërrua? Informacioni në lidhje me këtë çështje jepet si më poshtë në librin "Historia e Islamit" të autorit M. Asim Këksallit:

Kur Profeti i Zotit (a.s.), bëri hixhret në Medine, aty gjendej një prift i krishterë që njihej me emrin Ebu Amir ibn Sajfi i cili u përkiste Beni Dubaj'asë. Kryehipokriti Abdullah ibn Ubej ibn Seluli ishte djali i hallës së tij. (Ibn Is'hak, Sire, vëll. 3, fq. 7.)

Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), u dërgua si Pejgamber nga Allahu Teala, Ebu Amir ibn Sajfiu u kaplue nga xhelozia dhe smira. Kur Pejgamberi bëri hixhret dhe shkoi në Medine, Ebu Amir ibn Sajfiu shkoi në Mekë së bashku me pesëdhjetë vetë. (Ibn Hisham, Sire, vëll. 3, fq. 71.) Në luftën e Bedrit luftoi përkrah politeistëve. (Ibn Sa'd, Tabakat, vëll. 3, fq. 541.) I Dërguari i Allahut, (a.s.), e quajti "Fasik/i devijuar" atë. Ky njeri i devijuar gjendej ndërmjet atyre që i nxisnin politeistët për luftën e Uhudit dhe Hendekut. (Vakidi, Megazi, vëll. 2, fq. 441.)

Kur u çlirua Meka, ky njeri i devijuar shkoi në Taif. Kur banorët e Taifit u bënë myslimanë, shkoi në Sham. Ai i nxiti edhe hipokritët që gjendeshin në fshatin Kuba. Atyre u tha: "Unë nuk mund të hyj në xhaminë e Kubës. Nëse më shohin shokët e Muhamedit, më thonë gjëra që nuk më pëlqejnë." Hipokritët i thanë: "Ne mund të ndërtojmë një xhami tjetër. Pastaj ti mund të qëndrosh pranë nesh dhe të na flasësh." Ebu Amir ibn Sajfiu u tha: "Atëherë ndërtoni xhaminë tuaj! Aq sa të keni mundësi, mbliidhni fuqi dhe armë! Edhe unë do të shkoj te Kajseri (mbreti) bizantin. Prej bizantëve do të sjell ushtarë dhe do ta nxjerr Muhamedin së bashku me shokët e tij nga Medina."

Ebu Amir ibn Sajfiu shkoi te Kajseri i bizantëve së bashku me Ibn Balin prej Thakifit dhe Alkame ibn Ulasen prej Kajsi dhe qëndroi aty. Alkame dhe Ibn Balini u kthyen pas në Medine dhe u bënë myslimanë duke i dhënë besën të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Ndërkohë që hipokritët e Kubës më para falnin namaz së bashku me besimtarët në xhaminë e Kubës,

deshën t'i përçanin myslimanët dhe besimtarët me xhematin e tyre duke ndërtuar xhaminë Dirar.

Resulullahu (a.s.), e pyeti Behzexhin: "*Çfarë dëshiron të bësh me këtë gjë që po shikoj?*" Ai u përgjigj: "O i Dërguari i Allahut! Për Zotin nuk dua të bëj gjë tjetër përveçse mirësi."

Ebu Lubabe ibn Abdulmundhiri edhe pse nuk ishte hipokrit i ndihmoi ata me lëndë drusore për gjatë ndërtimit të xhamisë Dirar ngaqë nuk e dinte se po ndërtohej me qëllim të keq.

Kur Pejgamberi ynë i nderuar po përgatitej për të shkuar në Tebuk, erdhi një delegacion përfaqësues prej pesë vetash nga themeluesit e xhamisë Dirar. Ata i parashtruan këtë kërkesë të Dërguarit të Allahut (a.s.):

"O i Dërguari i Allahut! Ne kemi ndërtuar një xhami në mënyrë që të falim namaz në të të sëmuret dhe nevojtarët përgjatë netëve me shi. Kur vjen ndonjë rrëke, neve na ndërpritet rruga me luginën. Ajo na pengon për të shkuar te xhamia Kuba. Namazin duam ta falim në xhaminë tonë. Ndërsa kur të mbarojë rrëkeja do ta falim bashkë me ata. Ne dëshirojmë që të vish në xhaminë tonë dhe të na e falësh namazin."

Resulullahu (a.s.), u tha atyre: "*Unë tani jam i preokupuar ngaqë po dal për luftë. Nëse do të kthehem nga lufta, nëse do Allahu, do të vij te ju dhe do t'ua fal namazin në të.*"

Asim ibn Adiji thotë: "Bashkë me të Dërguarin e Allahut (a.s.), ishim përgatitur për të shkuar në Tebuk. Abdullah ibn Nebtelin dhe Tha'lebe ibn Hatibin i pata parë ndërsa po rregullonin ullukun e xhamisë Dirar. Ata më thanë: "O Asim! I Dërguari i Allahut (a.s.), na ka premtuar se do të falë namaz këtu kur të kthehet nga lufta."

Unë thashë me vete: "Për Zotin, këtë xhami nuk e bën dikush tjetër përveç atij që është i njohur për hipokrizi." Sepse xhamia që ishte bërë me dorën e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), gjendej aty. Edhe Xhebraili (a.s.), i pati treguar Pejgamberit drejtimin e Bejtull-lahut (Qabesë), në mënyrë që ta ndërtonte në atë anë. Pastaj mendova: "Për Zotin, derisa të kthehem do të zbresin ajetet e Kuranit që do ta përçmojnë xhaminë Dirar dhe do t'i përçmojnë ata që kanë bashkëpunuar dhe kontribuar në ndërtimin e saj."

Kur i Dërguari i Allahut, pagja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, po kthehej nga Tebuku, u ndalua për të bujtur në Dhi-Evan. Në ato momente Profetit të Zotit (a.s.), i erdhi shpallja. Në ajetet që zbritën thuhej:

107 "(Hipokritë) **janë edhe ata që ndërtuan një xhami për t'u shkaktuar dëm** (besimtarëve), **për ta forcuar mohimin dhe për të krijuar përçarje në mesin e besimtarëve, duke iu shërbyer ajo si pusi**

atyre që qysh më parë luftonin kundër Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Dhe, vërtet ata betohen: “Ne kishim për qëllim që të bënim vetëm një vepër të mirë!” Por Allahu dëshmon se në të vërtetë ata janë gënjeshtarë.”

108. *“Ti në atë xhami kurrë mos fal namaz. Ndërsa xhamia e themeluar në përkushtim (ndaj Allahut) që në ditën e parë, pa dyshim që është më e denjë për të falur namaz në të. Aty ka njerëz që duan të pastrohen. Allahu i do ata që pastrohen shpesh.”*

109 *“Cili është më i mirë, ai që themelet e godinës së vet i vë në përkushtimin ndaj Allahut dhe në kënaqësinë e Tij apo ai që themelet e godinës së tij i vë në bregun e gjërryer dhe që rrokulliset me të në zjarrin e Xhehenemit?! Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë popullin keqbërës.”*

110 *“Godina që ata ndërtoan, mbjell gjithnjë dyshim në zemrat e tyre, derisa zemrat e tyre t’u copëtohen. Allahu është i Gjithëdijshtëm, i Urtë.”* (Teube, 107-110)

Kur erdhi shpallja dhe zbritën ajetet fisnike në një mënyrë kaq të qartë dhe të kuptueshme, i Dërguari i Allahut (a.s.), thirri Malik ibn Duhshumin dhe Ma’n ibn Adijin. Atyre u tha: *“Shkoni te ajo xhamia njerëzit e së cilës janë zullumqar dhe digjeni e shkatërrojeni atë!”*

Këta dy heronj prej sahabëve të nderuar menjëherë morën rrugën pa humbur aspak kohë. Ata shkuan te vendi (xhamia) e Beni Salim ibn Aufit. Beni Salim ibn Aufi ishte fisi i Malik ibn Duhshumit. Malik ibn Duhshumi i tha Ma’n ibn Adijit (r.a.):

“Më prit këtu derisa të vij pranë teje me zjarrin që do të marr nga njerëzit e shtëpisë!” Kështu që shkoi te njerëzit e shtëpisë së tij. Ai mori një degë hurme prej degëve me gjethe dhe e ndezi. Pastaj bashkë me Ma’n ibn Adijin (r.a.), nxituan dhe shkuan te xhamia Dirar. Ishte koha ndërmjet akshamit dhe jacisë. Ata e dogjën dhe e shkatërruan me zjarrin që kishin në dorë.

Ma’n ibn Adij el-Axhlani (r.a.), na tregon për gjendjen e hipokritëve në ato momente duke u shprehur: *“Akoma nuk i harroj se si na shikonin nga lart ndërkohë që veshët i kishin ngritur lart si veshët e ujkut.”* Pasi u dogj dhe u shkatërrua xhamia Dirar, e shpërnda edhe xhemati i hipokritëve. (Ibn Is’hak, vëll. 4, fq. 174; Taberi, vëll. 3, fq. 147; M. Asim Këksall, Historia Islame, vëll. 7, fq. 365-367.)

Ma’n ibn Adij el-Axhlani, radijall-llahu anih, jetoi si një besimtar i devotshëm dhe i singertë që i ishte dorëzuar plotësisht të Dërguarit të Allahut (a.s.). Ai u përpoq në çdo kohë dhe çdo vend për ta shfaqur nënshtrimin, besnikërinë dhe dashurinë që ndjente ndaj Resulullahut (a.s.). Besnikërinë që kishte ndaj

Pejgamberit tonë të nderuar e shprehu si më poshtë me fjalët dhe veprimet e tij:

“Kur ndërroi jetë dhe u shpërngul për në botën e përherëshme i Dërguari i Allahut (a.s.), sahabët e nderuar qanin duke thënë: “Ah sikur të kishim vdekur para Resulullahut (a.s.).”, për shkak se kishin frikë të përballeshin me përçarjet e mëdha që do të ndodhnin në jetën e mëvonshme të tyre. Kur Ma’n ibn Adiji (r.a.), e pa këtë gjendje të sahabëve, tha:

“Për Zotin, unë nuk do desha të vdisja para të Dërguarit të Allahut. Besnikërinë, nënshtrimin dhe dashurinë që kam pasur për Resulullahun (a.s.), më pëlqen dhe dua që ta shfaq edhe më shumë pas vdekjes së tij siç e kam pas bërë kur ai ishte gjallë. Për këtë arsye, kurrë nuk do desha të vdisja para tij.” Në këtë mënyrë u përpoq t’i qetësonte dhe ngushëllonte njerëzit. (Ibn Sa’d, III, 465; Dhehebi, Tarihu’l-Islam, II, 44; Isabe, VI, 151; Istiab, IV, 1442.)

Ma’n ibn Adij el-Axhlani (r.a.), kreu shërbime të rëndësishme edhe në zgjedhjen e kalifit. Në lidhje me këtë temë transmetohen këto të dhëna në Sahihun e Buharit:

“Sapo kishte ndërruar jetë i Dërguari i Allahut (a.s.). Omeri (r.a.), u njoftua se ensarët ishin mbledhur te Beni Thakifi. Pa humbur kohë i tha Ebu Bekrit (r.a.), për të shkuar atje duke u shprehur: “Eja të shkojmë te vëllezërit tanë ensarë.” Kur arritën atje, aty i pritën dy njerëz të mirë. Njëri prej këtyre ishte Uvejm ibn Saide dhe tjetri ishte Ma’n ibn Adiji (r.a.). (Buhari, Kitabu’l-Megazi, 12.)

Përgjatë zgjedhjes së kalifit ndodhi një debat ndërmjet muhaxhirëve dhe ensarëve. Ma’n ibn Adiji (r.a.), mori fjalën, u ngrit në këmbë dhe bëri një fjalim influencues. Me fjalimin që bëri ai, njerëzit u qetësuan.

Ai mori pjesë në luftën e Jemames që u bë kundër Musejlimetu’l-kedhhabit në periudhën e kalifatit të Ebu Bekrit (r.a.). Komandanti Halid ibn Velidi e bëri atë komandant të një njësie përparuese që përbëhej nga njëqind kalorës. Ma’ni (r.a.), shfaqti heroizma të mëdha në luftën e Jemames. Në një moment kur myslimanët po arratiseshin, ai u hodh përpara dhe u tha:

“O ensarë!.. Kthehuni pas për të luftuar me armikun për hir të Allahut!..” Ai vetë u hodh në mënyrë heroike mbi armikun dhe filloi të luftonte. Disa prej ushtarëve të njësisë së tij i shpëtoi përgjatë këtij sulmi që bëri vetë, por ai vetë së bashku me Zejd ibn Hattabin (r.a.), që i Dërguari i Allahut i pati shpallur vëllezër, ranë dëshmorë. (633 e.s.).

Allahu qoftë i kënaqur prej tij!

Allahu (xh.xh.), na dhëntë të gjithëve prej besnikërisë, nënshtrimit dhe heroizmit të Ma’n ibn Adijit (r.a.)! Zoti na bashkoftë me të në xhenet! Amin!

LARGIMI NGA PËRGOJIMI DHE PARAGJYKIMI

— M. Sami Ramazanollu —

Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik: ***“O ju që keni besuar! Mënjaroni shumë dyshime, se, vërtet, disa dyshime janë gjynah. Mos e spiunoni dhe mos e përgojoni njëri-tjetrin! Mos vallë dëshiron ndokush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur?! Sigurisht që ju do ta urrenit këtë! Kijeni frikë Allahun! Me të vërtetë, Allahu është Pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë. O ju që keni besuar! Mos kërkon për mangësitë e të tjerëve dhe mos flisni për gabimet e tyre. Veçanërisht, mos tentoni absolutisht të kontrolloni në gjëra që u dhunohen të drejtat të tjerëve duke u bazuar te ndonjë shpifje e pabazë dhe duke ndjekur paragjykimin (dhyshimin) tuaj.”*** (Huxhurat, 12)

Shkaku i zbritjes së këtij ajeti fisnik është përgojimi që i bënë dy vetë prej sahabëve Selman el-Farisiut (r.a.). Ngjarja ndodhi si më poshtë:

I Dërguari i Allahut, (a.s.), në disa luftëra ua dha Selman el-Farisiun (r.a.), si shërbëtor dy vetave prej sahabëve të nderuar, në mënyrë që t’u gatuante ushqimin. Një ditë Selman el-Farisiu (r.a.), nuk e kishte përgatitur dot ushqimin për shkak se e kishte zënë gjumi. Ata dy sahabët e dërguan Selmanin për të marrë pak ushqim te Resulullahu (a.s.), nëse atij i kishte mbetur ndopak. Selman el-Farisiu, radijall-llahu anih, shkoi te Usame ibn Zejdi (r.a.), i cili ishte i ngarkuar me detyrën për t’i përgatitur ushqimin të Dërguarit të Allahut (a.s.). Kur Usame (r.a.), i tha se nuk kishte mbetur aspak ushqim, Selman el-Farisiu u kthye prapa, shkoi te ata dy sahabët dhe i lajmëroi se nuk kishte ushqim.

Ata dy personat thanë për Selamin (r.a.), duke e përgojuar: “Ky do të vinte pa ujë edhe nëse do të shkonte te ndonjë pus me ujë.” Ndërsa Usamen (r.a.),

e paragjykuan duke thënë: “I Dërguari i Allahut (a.s.), ka pasur ushqim, por Usame nuk e ka dhënë.”

Më vonë kur këta dy sahabë shkuan te i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, Pejgamberi (a.s.), u tha: “Çfarë ka ndodhur që po shikoj mish të gjelbër në gojën tuaj?” Ata u përgjigjën: “O i Dërguari i Allahut! Ne nuk kemi ngrënë mish.” Resulullahu (a.s.), ua ktheu: “Ju keni përgojuar Selmanin. Nëse dikush e përgojon vëllain e tij besimtar, është sikur ka ngrënë mishin e tij.”

Ja pra, në tefsirin e Hazinit dhe Bejzaviut thuhet se ky ajet fisnik ka zbritur në lidhje me këtë shprehje të të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Shkaqet që e detyrojnë një njeri për të përgojuar:

1- Të qetësuarit e urrejtjes që ka brenda duke shprehur gjendjet jo të mira të personit që përgojon.

2- Të shoqëruarit e shokëve që po përgojnë.

3- Të nënçmuarit e atij që e përgojon në sytë e të tjerëve.

4- Të shfajësuarit e vetes nga ajo vepër për të cilën e përgojon tjetrin.


5- Të shprehurit e virtyeteve duke treguar mangësitë e të tjerëve.

6- Zilia për shkak se njerëzit e duan dhe e nderojnë atë që e përgojon.

7- Synimi për t’i bërë njerëzit të qeshin duke lozur me të.

8- Të folurit me qëllim për t’u tallur dhe nënçmuar.

9- Të pëlqyerit e vetes duke shprehur një vepër të keqe që bën ai që përgojon. (Ky person shprehet se e shqetëson veprimi që e bën ai që përgojohet. Ndërkohë ai duke vepruar kështu nuk bën gjë tjetër vetëm se e përgojon atë.)





Ruaj gjuhën

— As. Prof. dr. Mustafa Xhanllë —

***“Kur biri i Ademit të
zgjohet në mëngjes,
të gjitha organet i
nënshtrohen gjuhës dhe i
përgjërohen duke i thënë:
Ki frikë nga Allahu në
lidhje me mbrojtjen e të
drejtave tona, sepse ne
jemi të lidhura me ty. Ne
mund të ndëshkohemi
prej atyre që thua ti. Nëse
ti qëndron në rrugën e
drejtë, edhe ne qëndrojmë
në rrugë të drejtë. Nëse ti
devijon nga rruga e drejtë,
edhe ne të pasojmë ty dhe
bëhemi si ti.”***

(Tirmidhi, Zuhd, 61.)

Sufjan bin Abdullah eth-Thekafiu, (r.a.), tregon: I thashë të Dërguarit të Allahut (a.s.):

“O i Dërguari i Allahut! Më trego për një vepër pas së cilës të kapem fort!”

I Dërguari i Allahut, (a.s.), më tha:

“*Thuaj: Zoti im është Allahu dhe ji i drejtë!*” Unë i thashë:

“O i Dërguari i Allahut! Prej cilës gjë frikësohesh më shumë për mua?”

Ai e kapi gjuhën e tij të bekuar me dorë dhe më tha:

“*Ja, kjo është.*” (Tirmidhi, Zuhd, 60)

Në këtë botë të përkohshme, në të cilën kemi ardhur për t’u sprovuar, po sprovohemi me shumë gjëra. Pa dyshim se njëra prej këtyre sprovave, ndoshta edhe më e vështira, është sprovimi me gjuhën, sepse, për të bërë shumë prej mëkateve të tjera duhet koha, vendi dhe paraja, ndërsa mëkatet që bëhen me gjuhë nuk kanë nevojë për këto. Nisur nga këto që thamë, mëkati që bëhet më shpejt dhe i cili nuk ka nevojë për një kohë të caktuar, vend dhe para është mëkati që bëhet me gjuhë. Në të njëjtën kohë, mëkati që bëhet me gjuhë është mëkati më kryesor dhe më i përhapur i cili bëhet në lidhje me të drejtat e njeriut. Hadithi fisnik i mësipërm që transmetohet nga Sufjani, është mjaft i rëndësishëm për ta theksuar se sa i vështirë është sprovimi me gjuhën.

Nisur nga ky aspekt, besimtari është i detyruar t’i dalë për zot gjuhës së tij sa më shumë të jetë e mundur. Megjithatë kjo është një punë e vështirë, shpërblimi për të është xheneti. Prandaj, i Dërguari

i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Atij që më premton mbrojtjen e gjuhës që ka ndër-mjet dy nofullave dhe mbrojtjen e nderit, edhe unë i premtoj xhenetin.” (Buhari, Rikak, 23)

Për këtë arsye, mbrojtja e gjuhës është njëri prej çelësave të shpëtimit. Një herë, Ukbe bin Amiri, (r.a.), e pyeti të Dërguarin e Allahut, (a.s.):

“O i Dërguari i Allahut! Cili është çelësi i shpëtimit?” Ai iu përgjigj në këtë mënyrë:

“Dili për zot gjuhës tënde, mos dil nga shtëpia (në kohë përçarjesh) dhe qaj me lot për mëkatet e tua!” (Tirmidhi, Zuhd, 60.)

Edhe në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë se të folurit pa u menduar mjaftueshëm mund të bëhet shkak për të hyrë në xhehenem.” (Buhari, Rikak, 23.) Përsëri ka theksuar se nuk duhet të flasim para se të mendohemi, duke thënë: *“Mos e thuaj një fjalë për të cilën do detyrohesh të kërkosht ndjesë!”* (Ibn Maxhe, Zuhd, 15.)

Të gjitha organet pasojnë gjuhën. Ebu Said el-Hudriu, (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Kur biri i Ademit të zgjohet në mëngjes, të gjitha organet i nënshtrohen gjuhës dhe i përgjeronen duke i thënë:

Ki frikë nga Allahu në lidhje me mbrojtjen e të drejtave tona, sepse ne jemi të lidhura me ty. Ne mund të ndëshkohemi prej atyre që thua ti. Nëse ti qëndron në rrugën e drejtë, edhe ne qëndrojmë në rrugë të drejtë. Nëse ti devijon nga rruga e drejtë, edhe ne të pasojmë ty dhe bëhemi si ti.” (Tirmidhi, Zuhd, 61.)

Një ditë Muadh ibn Xhebeli i tha të Dërguarit të Allahut (a.s.):

“O i Dërguari i Allahut! Me trego një vepër që të më fusë në xhenet dhe të më largojë nga xhehenemi, në mënyrë që ta bëj atë.”

I Dërguari i Allahut, (a.s.), pasi i foli për veprat e virtytshme si namazi, agjërimi, lëmosha dhe xhihadi, i tha:

“A të të tregoj një gjë me të cilën është i lidhur realizimi i të gjitha këtyre?”

Muadhi i tha:

“Po, o i Dërguari i Allahut!”

Nisur nga kjo, i Dërguari i Allahut, (a.s.), e kapi gjuhën e tij dhe i tha:

“Mos lejo që kjo të të dëmtojë!” (Tirmidhi, Iman, 8.)

Sepse fjala është përgjegjësi. Për këtë arsye, siç theksohet edhe në fjalën e urtë: “Mendo dy herë dhe fol një herë!”, duhet ta llogarisim mirë se ku shkojnë fjalët që dalin nga goja jonë. Imam Shafiu, rahmetullahi alejh, thotë:

“Fjala është si shigjeta. Kur të dalë prej teje, atë-

herë të sundon ajo ty, jo ti atë.” Andaj, çdo fjalë që del nga goja jonë është si një shigjetë që del nga harku. Ajo shkon patjetër në destinacionin e saj qoftë e drejtë apo qoftë e gabuar. Kështu që asnjëherë nuk kthehet pas.

Fjala regjistrohet. Allahu Teala ka ngarkuar me detyrë një engjëll që të regjistrojë çdo fjalë që del nga goja jonë. Allahu i Lartësuar thotë në ajetin fisnik të tetëmbëdhjetë të sures Kaf:

“Për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbi-këqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë).” Për këtë arsye, nëse fjala që do të themi është e mirë dhe e bukur, e regjistrojnë engjëjt që shkruajnë të mirat. Nëse është fjalë e keqe, regjistrohet nga engjëjt që shkruajnë të këqijat.

Fjala është dëshmitare. Ditën e mahsherit çdo fjalë që ka dalë nga goja jonë do të dëshmojë pro ose kundër nesh. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Çdo fjalë që thotë biri i Ademit është në dëm të tij, përveç atyre që i ka thënë për të urdhëruar të mirën, për të ndaluar nga e keqja dhe për të përmendur Allahun.” (Tirmidhi, Zuhd, 62.)

Fjala është amanet. I Dërguari i Allahut, (a.s.), duke u shprehur se fjala është amanet (Ebu Davud, Edeb, 37.), e ka ndaluar përhapjen e fjalëve që thuhën nëpër biseda.

Njëra prej rrugëve të mbrojtjes nga fatkeqësitë e gjuhës është heshtja. Kur t'i hedhim një sy jetës së të Dërguarit të Allahut, (a.s.), do të shohim se ai ka heshtur më shumë se sa ka folur. Andaj ai thotë:

“Kushdo që i beson Allahut dhe ditës së gjykimit, le të thotë fjalë të mira ose të heshtë!” (Muslim, Iman, 74.) Sepse, ka prej fjalëve që janë gënjeshtra. Ndërsa gënjeshtra është fatkeqësia më e madhe e gjuhës. Siç shprehet edhe i Dërguari i Allahut (a.s.):

“Ai që gënjen kur flet, nuk i ka besuar (me kup-timin e plotë) Allahut dhe ditës së gjykimit.” (Tirmidhi, Sifetu'l-kijame, 60.) Meqë gënjeshtra nuk mund të qëndrojë pranë besimit, ai që beson nuk gënjen kurrë.

Ka prej fjalëve që janë përgojim. Ndërsa përgojimi është haram. Përgojimi e turbullon ujin e pastër. I Dërguari i Allahut, (a.s.), e ka qortuar kështu dikë që e përgojoi vëllain e tij në fe pas shpine:

“Ti ke thënë një fjalë që po të binte në det, do ta prishte ujin e detit.” (Ebu Davud, Edeb, 35.)

Ka prej fjalëve që janë shpifje, lavdërim i ekzagjeruar ose nënçmim i tepërt.

Ka prej fjalëve që janë tallje, spiunim dhe përhapje e të fshehtave private.

Ka prej fjalëve që janë thashetheme. Kur një ditë i Dërguari i Allahut, (a.s.), po kalonte nga varrezat, e shpjegoi në këtë mënyrë shkakun që po ndëshkoheshin dy vetë të cilët preheshin aty:

“Ata nuk po ndëshkohen për ndonjë gjë të madhe. Njëri prej tyre nuk bënte kujdes ndaj (pikave të) urinës. Ndërsa tjetri merrej me thashetheme.” (Buhari, Vudu’, 55.)

Edhe në një hadith tjetër ka thënë:

“Nuk mund të hyjë në xhenet ai njeri që i mbart fjalët (ndërmjet njerëzve).” (Buhari, Edeb, 50.)

Ka prej fjalëve që janë tallje. Allahu i Lartësuar thotë:

“Mjerë për çdo përqeshës-shpifës!” (Humeze, 1) Aishja, (r.a.), tregon:

“Një ditë po tregoja një histori duke imituar gjendjen e dikujt. Nisur nga kjo, i Dërguari i Allahut, (a.s.), më tha:

“Mua nuk më pëlqen kurrë ta përmend një njeri duke e imituar në një formë që nuk i pëlqen edhe nëse më japin të gjithë botën.” (Ebu Davud, Edeb, 35.)

Ka prej fjalëve që janë paragjykiye. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Largohuni nga paragjykimi, sepse paragjykimi është gënjeshtër më e madhe. Mos u përpigni t’i shikoni dhe dëgjoni mangësitë njëri-tjetrit! Gjithashtu, mos u përpigni që të mësoni të fshehtat e njëri-tjetrit në jetën private! Mos e lakmoni njëri-tjetrin! Mos e urreni dhe mos shfaqni armiqësi ndaj njëri-tjetrit! O robërit e Allahut! Bëhuni vëllezër me njëri-tjetrin!” (Buhari, Edeb, 57.)

Ka prej fjalëve që shkaktojnë debat. Edhe debati është njëra prej fatkeqësive të gjuhës. Nisur nga kjo, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Mos debato me vëllain (deri në atë gradë sa mund të shndërrohet në armiqësi)! Mos bëj shaka (lënduese) me të dhe mos i jep fjalën për diçka që nuk mund ta bësh!” (Tirmidhi, Birr, 58.)

Gjithashtu, të flasësh për çdo gjë që dëgjon, është prej fatkeqësive të gjuhës. Në lidhje me këtë çështje, i Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë:

“Njeriut i mjafton për mëkat që të thotë çdo gjë që dëgjon!” (Ebu Davud, Edeb, 80.)

Ka prej fjalëve që janë boshe dhe të pavlera. Edhe fjalët e pavlera zënë vend ndërmjet fatkeqësive të gjuhës. Kur Allahu i Lartësuar flet për cilësitë e besimtarëve prej të cilëve është i kënaqur, thotë:

“Të cilët shmangen nga fjalët e kota.” (Mu’minun, 3) Gjithashtu ka urdhëruar që besimtari të qëndrojë larg fjalëve të këqija dhe të shëmtuara duke thënë: **“Thuaju, robërve të Mi, që të flasin atë që është më e mira!..”** (Isra, 53) I Dërguari i Allahut, (a.s.), shprehet kështu për atë që flet fjalë të pavërteta, në mënyrë që t’i bërë njerëzit të qeshin: **“Mjerë për atë!”** (Tirmidhi, Zuhd, 10.)

Ka prej fjalëve që e largojnë njeriun nga Allahu i Madhëruar dhe që ia nxijnë zemrën. Të folurit e tepërt është një fatkeqësi e gjuhës. Në të njëjtën kohë, kjo është cilësi që e largon robin nga Zoti (xh.

sh.) dhe që e nxin dhe ngurtëson zemrën. I Dërguari i Allahut, (a.s.), na bën këtë thirrje:

“Mos e zgjatni fjalën përveçse kur të përmendi Allahun, sepse të flasësh shumë përveçse kur përkujton Allahun, e ngurtëson zemrën. Ndërsa njerëzit që janë më larg Allahut, janë ata që kanë zemrën të ngurtësuar.” (Tirmidhi, Zuhd, 62.)

Ka prej fjalëve që janë lënduese. Poeti i famshëm, Junusi shprehet:

“Nëse ke thyer një herë ndonjë zemër, Atëherë, ky që fal nuk është namaz.”

Ka edhe prej fjalëve që të çojnë në xhenet, por ka edhe prej fjalëve që e tërheqin zemërimin hyjnor dhe të çojnë në xhehenem. I Dërguari i Allahut, (a.s.), i shpjegon kështu këto dy anë të fjalës:

“Një fjalë që rob mund ta thotë pa i dhënë rëndësi, mund të përputhet me pëlqimin e Allahut. Për shkak të saj, Allahu ia lartëson gradat. Edhe një rob tjetër bie në fund të xhehenemit për shkak të një fjale që e thotë pa i dhënë rëndësi, por që e zemëron Allahun.” (Buhari, Rikak, 23.)

Një herë sahabët e pyetën të Dërguarin e Allahut (a.s.):

“O i Dërguari i Allahut! A do të merremi në llogari edhe për ato që flasim?” I Dërguari i Allahut, (a.s.), iu përgjigj:

“...A ka gjë tjetër që i rrokullis njerëzit me fytyrë në xhehenem përveç atyre që thonë me gjuhë e tyre?” (Tirmidhi, Iman, 8.)

Në ditët e sotshme po vëmë re se mëkatet që bëhen me gjuhë si gënjeshtër, shpifja, përgojimi, paragjykimi, spiunimi dhe ekspozimi i privatësisë, po bëhen edhe në botën virtuale. Për shembull, gënjeshtër e cila është fatkeqësia më e madhe e gjuhës, me anë të tweeterit mund të influencojë në moment grupe të gjera në shoqëri. Gjithashtu, me një fjali që shpreh provokacion dhe nxitje, menjëherë i zvarrit njerëzit në rrugë dhe në anarki. Madje, kjo gënjeshtër shndërrohet në shpifje dhe provokim me anë të retweet dhe share. Pa dyshim se këto do ta gjejnë vendin e tyre ndërmjet gjynaheve që i kemi bërë me gjuhë ditën e llogarisë së madhe. Madje, këto do të kenë një ndëshkim më të rreptë se mëkatet që bëhen me gjuhë, sepse mëkatet që bëhen në botën virtuale kanë mundësi të influencojnë me miliona njerëz. Sa gjendje e tmerrshme është kjo nga aspekti i të drejtave të njeriut!

Përfundimisht, ne si besimtarë gjendemi në një sprovë mjaft të vështirë me gjuhën, epshin dhe të gjitha organet tona. Për këtë arsye, le t’i kërkojmë mbrojtje Allahut Teala si individë ashtu siç i ka kërkuar mbrojtje i Dërguari i Allahut (a.s.):

“O Zot! Të kërkoj mbrojtje nga e keqja e veshit tim, nga e keqja e syrit tim, nga e keqja e gjuhës sime, nga e keqja e zemrës sime dhe nga e keqja e imoralitetit!” (Tirmidhi, Deavat, 74.)



MYSLIMANI MIDIS traditës dhe modernes

— Doç. dr. Harun Əmysh —

Kur njëri prej politikanëve të vjetër po kritikonte shkëputjen e demokracisë me anë të grushtit të shtetit, pati thënë:

“Një herë në dhjetë vjet mbylleni Haxhi Bekirin dhe të shohim nëse do të prodhojë edhe një herë tjetër sheqer. Kjo fjalë ishte një reagim shumë me vend që tregonte se sa gabim i madh ishte dhënia e eksperiencave të të kaluarës dikujt që nuk i kup-ton ato.

Këtë reagim të bërë kundrejt shkëputjes së tra-ditës së demokracisë, mund ta praktikojmë po në të njëjtën mënyrë edhe ndaj disa qëndrimeve që mbahen ndaj jetës sonë fetare.

Nuk e di, ndoshta e bëjnë prej dëshirës së madhe për të nxjerr në pah mendime të reja, por ka disa prej hoxhallarëve tanë që nxjerrin në pah mendime të reja dhe bëjnë komente të atilla që me thënë të drejtën, njeriu habitet. Për shembull, njëri prej mendimeve dhe komenteve që ka dalë më së fundi në qarkullim ka të bëjë me namazin. Sipas këtij mendimi, ne nuk e paskemi mësuar namazin nga i Dërguari i Allahut (a.s.), ashtu siç shprehet edhe në traditën e tij. (Fjalën traditë në këtë artikull, krahas traditës profetike, e përdor edhe në kuptimin e men-dimit Islam si jurisprudenca islame dhe kelami.) Politeistët e injorancës në fakt paskan falur namaz!

Ata paskan qenë nipat e Ibrahimit dhe Ismailit. Si mund të mos e dinë namazin nipat e profetit? Edhe ajeti fisnik na e thoshka qartazi se politeistët paskan falur namaz!

“Lutja e tyre në Shtëpinë e Shenjtë ishte vetëm me fërshtëllima dhe rrahje duarsh...” (Enfal, 35) Gjithashtu, na paska edhe një grup prej çifutëve që e falkan namazin me të njëjtat rukne / shtylla dhe në të njëjtat kohë! Edhe Kurani Fisnik na e pa-ska treguar mënyrën e mësimit të faljes së namazit duke thënë: **“Bëni ruku bashkë me ata që bëjnë ruku!”** (Bakara, 43) Namazi, kur na paska zbritur, na qenka mësuar duke parë ata që paskan falur namaz, domethënë, duke parë mënyrë e faljes së mushrikëve. A nuk mësojmë edhe ne duke parë te prindërit apo te të mëdhenjtë tanë? Etj, etj...

A e shikoni çfarë mendimi? Nuk e pranojnë dot se namazin na e ka mësuar i Dërguari i Allahut, (a.s.) dhe thonë se e kemi mësuar nga politeistët mekas! Ata që e mbrojnë këtë mendim, nuk e thonë dot haptazi problemin që kanë, por japin një detaj duke u shprehur se ajeti: **“Bëni ruku bashkë me ata që bëjnë ruku!”**, na tregon mënyrën se si mund të mësohet falja e namazit. Prandaj, problemin e këtyre, apo më saktë, maninë e këtyre le ta themi ne më qartë:

NXJERRJA E ÇDO GJËJE NGA KURANI

Krahas se Kurani Fisnik i përmend fjalët kijam, ruku, suxhuk e kuud dhe përmban disa shenja në lidhje me kohët e namazit, nuk na tregon se si duhet të kryhen këto rukne. Atëherë çfarë mund të bëjnë këta persona të cilët nuk shpëtojnë dot nga mania e lartpërmendur?

Ata pohojnë se ajeti: **“Bëni ruku bashkë me ata që bëjnë ruku!”**, na tregon mënyrën se si mund të mësohet falja e namazit! Në këtë mënyrë, e kanë nxjerrë nga Kurani mënyrën e faljes së namazit ose e kanë lidhur në ndonjë formë me të! Ata nuk mund të thonë dot se i Dërguari i Allahut (a.s.), na i ka mësuar detajet e namazit, sepse Kuranin Fisnik dhe sunetin / traditën profetike i konsiderojnë si dy burime alternativë dhe rivalë ndaj njëri-tjetrit. (Ndërkohë suneti është shpjeguesi i Kuranit Fisnik. Ixhmaja / konsensusi i dijetarëve myslimanë e ka bazën te Kurani dhe suneti. Ndërsa kijasi / analogjia është një lloj shpjegimi i dispozitave që gjenden në Kuran dhe sunet duke i krahasuar dhe duke mos nxjerrë diçka të re në pah. Domethënë, sipas këndvështrimit klasik, të gjitha argumentet e tjera mbështeten te Kurani Fisnik.)

Le të themi se arabët e xhahilijetit / periudhës së injorancës e kanë mësuar faljen e namazit nga brezi në brez duke filluar që nga Ibrahim (a.s.). Mirë, po Ibrahim nga e mësoi? Apo mos pati hoxhën e namazit me foto në suhufet / broshurat që iu dhanë? Apo edhe popujt që Ibrahim i ftoi në teuhid / njësimin e Zotit e patën mësuar faljen e namazit nga gjyshërit e tyre, kështu që edhe Ibrahim (a.s.), e mësoi duke parë ata? Le të themi se pretendimi i dytë është i mundshëm dhe në këtë mënyrë shkuam deri te babai i njerëzimit, Ademi (a.s.). Po babai ynë, Ademi (a.s.), mos e mësoi faljen e namazit nga fotot që kishte në fletushkat që iu dhanë apo Zoti ia mësoi duke i dërguar Xhebrailin (a.s.) apo duke i dhënë frymëzim në zemër? Pretendimin e parë nuk mund ta dimë se sa i vërtetë mund të jetë. Ne mendojmë se ai nuk ka ndryshim nga i dyti. Sepse ne i shohim si shpallje të dy edhe nëse kanë natyra të ndryshme. Por nëse pretendimi i dytë pranohet si i vërtetë, atëherë, përse të mos e marrim për shembull Pejgamberin i cili është më afër nesh, por dalim deri te babai ynë, Ademi (a.s.). Nëse edhe ai e ka mësuar nga Xhebraili (a.s.), atëherë, edhe i Dërguari i Allahut, (a.s.), i cili është më afër nesh, le ta mësojë nga Xhebraili (a.s.), dhe pastaj të na e mësojë edhe neve! A nuk është më mirë dhe saktë? Por jo, kjo mania që njerëzit kanë në kokë, nuk i lë ata të bëjnë rehat.

Kurani Fisnik thotë se **“Lutja e tyre në Shtëpinë**

e Shenjtë ishte vetëm me fërshëllima dhe rrahje duarsh...” (Enfal, 35) Ndërsa këta e nxjerrin namazin e Islamit nga ky ajet dhe i emërojnë politeistët si hoxhallarë të myslimanëve!

Po, është e vërtetë. Në disa literatura thuhet se edhe politeistët kanë falur namaz. Madje bëhen edhe disa përkufizime të atij namazi. Por a mund të jemi të sigurt se namazi në atë kohë ishte aq shumë i përhapur sa që të njëjët nga e gjithë shoqëria nëse e pranojmë se këto përkufizime përputhen një për një me namazin që ne falim tani? Nëse do të ishte i përhapur, a nuk do ta përmendte këtë i Dërguari i Allahut (a.s.)? A nuk është i Dërguari i Allahut (a.s.), ai që i ka ardhur shpallja dhe mukteda bih / personi që njerëzit duhet ta pasojnë dhe ta marrin për shembull?

Edhe te ithtarët e feve të tjera mund të ketë prej ibadeteve të tyre që përputhen një për një me namazin që falin myslimanët. Së fundi, edhe ata kanë pas qenë mbështetur te shpallja hyjnore. Edhe feja e tyre ka të njëjtin burim me Islam. Në të vërtetë, nuk e refuzojmë çdo gjë që pranojnë çifutët dhe të krishterët. Madje, ne kemi edhe respekt për librat e tyre ngaqë edhe ata kanë të njëjtin burim dhe përfshijnë shumë të vërteta të pa shtrembëruara, por kjo nuk do të thotë se namazin do ta marrim nga ata. Kështu, sipas deklaramit të atyre të cilëve e kanë dhënë këtë mendim që përmendëm më lart, numri i rekatëve të namazit të jacisë që e fal ky grup çifutësh në fjalë, nuk përputhet me numrin e rekatëve të namazit të jacisë që falim ne. Domethënë se paska një pikë për t'u korrigjuar edhe pse ka kaq shumë ngjashmëri. Domethënë, kemi nevojë për detajet që jep i Dërguari i Allahut (a.s.), në lidhje me namazin.

Krahas të gjitha këtyre pikave kritikuese që përmenda, mund ta pëlqej, madje mund ta përvetësoj këtë mendim me kusht që të shtohet edhe mënyra e përshkrimit që Pejgamberi i bënte namazit, sepse unë nuk kam asnjë mani. Domethënë, ajo që kundërshtoj dhe që e shoh të nevojshme për t'i kthyer përgjigje, nuk është nxjerrja në pah e një mendimi të tillë në lidhje me mësimin e formës së faljes së namazit, por shkaku që e nxjerr në pah këtë mendim! Domethënë, është mania e poseduesve të këtij mendimi për të cilin folëm. Nëse poseduesit e këtij mendimi deklarojnë se nuk kanë një mani të tillë dhe se këto që thashë janë tërësisht pohime boshe të miat, jam i gatshëm t'i tërheq mbrapsht me kënaqësi të gjitha ato që thashë!

Por përse po i kundërvihem kaq shumë kësaj manie? Këtë po e bëj ngaqë mendimi për “të nxjerrë çdo gjë nga Kurani”, i cili quhet Islami i Kuranit, është i



gabuar. Kjo është rruga e atyre që thonë: “Të nderuar! Ne jemi të zgjuar dhe e dimë mirë arabishten. Kështu që u gjejmë zgjidhje të gjitha problemeve duke i shtjelluar tekstet e Kuranit Fisnik!”

Po, është e vërtetë. Dikush që ecën në këtë rrugë mund të gjejë zgjidhje për çdo gjë nga Kurani. Domethënë, çdo gjë mund ta vërtetojë me Kuran, sepse tekstet që ka përpara mund të shtjellohen edhe në këtë mënyrë! Përveç të tjerash, nuk ka edhe ndonjë gjë tjetër që duhet të marrë parasysh. Pra, nuk ka as sunetin, as sijenin, as sebebu’n-nuzul dhe as ndonjë material të përpjekjes madhështore të dhënë përgjatë gjithë këtyre shekujve për ta shpjeguar atë (Kurantin)! Kështu që para vetes ka vetëm tekstet e Kuranit Fisnik që i komenton sipas kushteve që i ka vendosur vetë! Një person që mban një qëndrim të tillë, veçanërisht nëse e ka nxjerrë jashtë funksioni edhe sunetin, në të vërtetë pretendon ta vendosë veten në pozitën e profetësisë që akoma nuk e ka shpallur. Kur Aliu e dërgoi Ibn Abbasin për të debatuar me harixhitë, i tha:

“Mos debato me ata duke u nisur nga Kurani, por debato me sunet, sepse Kurani është dhu-vuxhuh / mbart kuptime të ndryshme.” Kjo fjalë e Aliut (r.a.), e shpjegon edhe më shumë këtë çështje.

Mirë, por a të mos bëjmë ndonjë koment dhe të mos nxjerrim në pah ndonjë mendim të ri?

Sigurisht! Në të vërtetë, edhe unë nuk them që t’i përmbahemi vetëm traditës profetike, por siç është e gabuar që ta bëjmë traditën profetike kurorë të kokës dhe t’ua imponojmë njerëzve ashtu siç është duke i neglizhuar gjurmët historike që mbart, po aq e gabuar është edhe neglizhimi total i saj. Mënyra më e saktë për të vepruar është përzgjedhja. Ne duhet ta rishikojmë edhe një herë traditën profetike duke i marrë si të vërteta të pandryshueshme Kurantin, sunetin mutevatir dhe parimet që dijetarët kanë rënë në konsensus për to. Pastaj të tjerat që mbeten, duhet t’i rishikojmë brenda kornizave të këtyre të vërtetave duke mos u shkëputur nga tradita profetike. Lidhja e verbër me traditën dhe shkëputja

totale nga ajo, janë burimi i shumë problemeve me të cilat po përballemi.

Sepse prej lidhjes së verbër me traditën profetike dalin Talibanët, ISIS-i etj. Në këtë mënyrë, na imponojnë traditat e mesjetës sikur të ishin fe. Ndërsa nga mendimi për t’u shkëputur totalisht nga suneti, dalin mendime të çuditshme –si mendimi për namazin që e përmendëm më lart- që nuk përputhen me njëri-tjetrin. Këto njerëz shprehen se mendimet e tyre i kanë mbështetur vetëm te Kurani.

Vallë, këta njerëz që mendojnë kështu, mos kanë gjetur ndonjë serë të Kuranit të cilën nuk e dimë ne? A prandaj nuk janë ndikuar nga asnjë rrymë, njeri apo mendim tjetër i ndryshëm? A ngaqë nuk ndikohen nga asgjë, qenkan të mbështetura në Kuran vetëm mendimet e tyre? Mos u sillni kështu zotërinj! Kjo është turp! Ata që e hedhin poshtë të gjithë traditën profetike –sigurisht nëse mund ta hedhin-, mendjen e tyre që e ka kapur era nga shumë anë, e vendosin në vend të traditës së të Dërguarit të Allahut (a.s.). Asnjë këndvështrim nuk mund të jetë i pa ndikuar nga ndonjë gjë. T’i përgjithësosh të gjithë është edhe e gabuar, edhe shkatërruese.

Lënia e traditës profetike është lënia e bazave të Islamit

U bënë një kohë e gjatë që e kemi shkatërruar sunetin e të Dërguarit të Allahut (a.s.), në çdo fushë. Në ditët e sotshme jemi të privuar në shumë fusha nga suneti. Për shembull: Përse nuk ka një dijetar që t’i dëgjohet fjala, të pranohet si autoritet dhe t’i ndalojë ata që shkojnë pas ISIS-it (meqë ra fjala)? Sepse dijetari nuk e ka sunetin që të edukohet! Nuk ka asnjë që ta njohë dhe ta vlerësojë sunetin me të cilin të edukohet dijetari! Ngaqë nuk ka asnjë që i di këto, nuk ka asnjë që të ketë respekt për autoritetin e dijetarit. Madje, nuk ka as prej atyre që e dinë se myslimanët kanë një traditë për të jetuar në paqe bashkë me ithtarët e feve dhe medhhebeve të tjera! S’ka, s’ka! Ja, kështu është lënia e traditës! Andaj, kemi edhe shumë punë për të bërë... Allahu na ndihmoftë!



SULMI I PABESË

— Adem Saraç —

Dielli i Islamit i ndriçoi zemrat e fatlumëve. Edhe fatlumët u përpoqën ditë e natë për të arritur te fatlumë të tjerë.

Ndërsa ata që ia kthyen kurrizin diellit të Islamit, vazhdimisht ishin pas kurtheve të reja. Siç filluan të silleshin më me agresivitet nga dita në ditë ndaj të Dërguarit të Allahut, (a.s.) dhe sahabëve të nderuar, gjithashtu e shtuan edhe dhunën.

Ndërkohë që duhet të bëheshin prej besimtarëve të parë, vazhdimisht e kundërshtonin Pejgamberin. Atë e torturonin me shpifje të ndryshme që nuk u besonin as vetë duke i thënë poet, magjistar, fallxhor dhe i çmendur.

Tradhtarët e mjerë nuk u mjaftuan vetëm me këtë, por i nxisnin të tjerët dhe e tepruan deri aty sa që filluan ta sulmonin të Dërguarin e Allahut, (a.s.). Ata e sulmuan derisa e plagosën Pejgamberin, (a.s.).¹

Politeistët mekas i kapnin ata që hynin në Islam, i zhvishnin, u vishnin rroba prej hekuri dhe i linin të shtrirë nën diellin e nxehtë. Edhe pse u bënë kaq shumë tortura çnjerëzore, asnjë prej myslimanëve nuk e la Islamin.

Mushrikët, në vend se t'ia vinin veshin mesazhit hyjnor dhe të shpëtonin, zhyteshin edhe më shumë në errësirë. Çdo fis, ata që bëheshin myslimanë prej tyre, u bënë tortura të ndryshme duke i shtypur me metoda të veçanta.

Në fillim i patën tallur.

Pastaj filluan t'i poshtëronin.

Më pas erdhën torturat.

Ndërsa ndalimi nga jeta sociale ishte metoda që e përdornin vazhdimisht.

Disa prej tyre i burgosnin në podrumet e shtëpive të tyre.

Disa prej tyre i rrahën në mënyrë çnjerëzore.

Disa të tjerë i impononin për ta braktisur fenë duke i lënë pa ngrënë e pa pirë.

Mbajtja e këtyre njerëzve nën diell në orët dhe në ditët më të nxehta të Mekës, tashmë ishte bërë prej punëve të përditshme.

Shumë prej sahabëve kishte që humbnin ndjenjat, që u binte të fikët dhe që nuk vinin në vete për ditë të tëra, por asnjëri prej tyre nuk e la fenë islame.

Çdo fis i kapte një nga një ata që hynin në Islam prej tyre dhe nuk linte tortura pa u bërë. Madje, ata e tepruan aq shumë sa që filluan të garonin me njëri-tjetrin në tortura dhe dhunë.

Kur Ebu Talibi vuri re se situata kishte arritur deri në këtë gjendje të rëndë, i mbledhi bijtë e Hashimit dhe Muttalibit dhe u bëri thirrje që ta mbronin të Dërguarin e Allahut, (a.s.), siç bënte edhe vetë. Këto dy fise e pranuan menjëherë propozimin e Ebu Talibit dhe u bashkuan me atë. Ndërsa Ebu Lehebi, i cili vazhdimisht qëndronte me mushrikët, e kundërshtoi ashpër këtë propozim.²

Një ditë, të parët e mushrikëve u mbledhën përsëri në një vend të quajtur Hixhr në Qabe dhe filluan të flisnin kundër të Dërguarit të Allahut, (a.s.):

-Si do të jetë fundi i kësaj pune kështu?

-Mjafton kjo që po heqim nga ky njeri!

-Po ashtu, mjafton edhe durimi që kemi shfaqur kundrejt tij!

-Ne asnjëherë nuk kemi duruar kundrejt ndokujt siç kemi bërë durim kundrejt atij!

1. Ibn Hisham, es-Siret'u'n-Nebevijje, vëll. 1, fq. 308-309.

2. Taberi, Tarihu'l-Umem ve'l-Muluk, vëll. 2, fq. 220

-Çfarë ka bërë ai?
 -Të mençurit tanë i konsideron injorantë.
 -Ka thënë se baballarët dhe gjyshërit tanë janë në humbje.
 -Ka ofenduar idhujt tanë.
 -E ka ndarë dhe e ka përçarë popullin tonë.
 -Çfarë kemi bërë ne?
 -Kemi duruar kundrejt të gjitha këtyre gjërave që ka bërë ai.
 -Tashmë mjafton.

Ndërkohë që ata po bisedonin, i Dërguari i Allahut, (a.s.), erdhi duke ecur në këmbë. Siç vepronte gjithmonë, së pari përshëndeti Haxheru'l-Esvedin. Pastaj filloi të bënte tavafin rreth Qabesë. Kur kaloi pranë tyre përgjatë tavafit, i hodhën fjalë. Ata i thanë fjalë shumë të rënda.³

Edhe pse i Dërguari i Allahut, (a.s.), bëri durim ndaj fjalëve të tyre të rënda, nga fytyra e tij e bekuar dallohej qartë se ishte nxehur shumë prej atyre fjalëve.

Krahas çdo gjëje, Pejgamberi, (a.s.), e vazhdoi tavafin në Qabe. Kur po kalonte pranë tyre në rrotullimin e dytë, ata përsëri i hodhën fjalë të rënda. Prapë se prapë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), e vazhdoi tavafin pa u thënë gjë edhe pse u nxeh shumë. Ngacimet dhe fjalët e rënda të cilat vazhduan përgjatë gjithë tavafit, tashmë u bënë të papërballueshme.

Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), e mbaroi tavafin, u ndal pikërisht para këtyre të mjerëve. Atyre u hodhi një shikim plot zemërim. Pastaj i paralajmëroi me një gjuhë të rëndë:

*-O populli Kurejsh! A më dëgjoni mua? Betohem në Allahun, i Cili ka në dorë jetën time, se kam ardhur me lajmin e shkatërrimit që kam pranuar për ju. A më dëgjuat?"*⁴

Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), ua tha këto fjalë, ata heshtën të gjithë për momentin. Ata ngrinë në vend dhe dukeshin sikur u ishte ndaluar frymëmarrja. Kokat e tyre mendjemadhe u ulën përpara. Andaj nuk guxonin as të lëviznin.

Secilin prej tyre e kaploi një frikë e tmerrshme. Madje, edhe Ebu Xhehli, i cili sillej më ashpër se të gjithë kundër të Dërguarit të Allahut, (a.s.), nuk erdhi dot në vete për pak kohë. Befasisht filloi të fliste me vështirësi dhe përdori fjalë mjaft të buta:

-O Ebu'l-Kasim! Kalo dhe largohu edhe pse je në rrugë të drejtë! Për Zotin, ti nuk je njeri injorant! Ne ishim ata që shfaqëm injorancë kundrejt teje!

Edhe i Dërguari i Allahut, (a.s.), u largua nga këta të mjerë pa u thënë asnjë gjë tjetër.⁵

Nga kjo ngjarje pati kaluar vetëm një ditë. Të parët e të mjerëve u mblodhën përsëri në Hixhr, por këtë herë ishin edhe më të tërbuar:

-Çfarë ndodhi dje ashtu?
 -A nuk do të bëjmë gjë për ato që tha?
 -Ai u ndal para nesh dhe na tha fjalët më të rënda.

-Gjërat që nuk na pëlqejnë na i tha sikur po na i gjuante kokës.

-Çfarë i bëmë ne atij?
 -Të gjithë heshtëm.

-Kjo nuk duhej të ndodhte.

Ndërkohë që ata flisnin sa lart-poshtë, erdhi i Dërguari i Allahut, (a.s.). Sapo e panë atë, të gjithë mushrikët u ngritën nga vendi dhe e rrethuan Pejgamberin (a.s.). Ata filluan t'i bërtisnin duke i kujtuar fjalët e djeshme:

-A ti ishe ai që na the dje kështu e ashtu?

I Dërguari i Allahut, (a.s.), iu përgjigj me një qetësi mjaft të madhe:

*-Po! Unë jam ai që i kam thënë këto fjalë!"*⁶

Njëri prej mushrikëve bëri një paturpësi që ta ngrin gjakun. Ai e kapi për fyti të Dërguarin e Allahut, (a.s.), filloi ta shtrëngonte dhe i bërtiste me të madhe.

Kur Ebu Bekri, radijallahu anhu, e pa këtë situatë çnjerëzore, u ngrit nga vendi si rrufe me sytë që i shpërthenin flakë dhe i doli përpara mushrikut!

-Turp të keni të gjithë! A do të vrisni një njëri i cili thotë: "Zoti im është Allahu!" A e kuptoni vallë se çfarë jeni duke bërë? Për Zotin, atë nuk mund ta prekni kurrë pa na vrarë të gjithë ne!"⁷

Përgjatë kësaj grindjeje, Ebu Bekri, (r.a.), e mbrojti me jetën e tij të Dërguarin e Allahut, (a.s.). Mushrikët e tërbuar atë ditë e plagosën edhe Ebu Bekrin duke e goditur. Krahas të gjitha goditjeve, ai nuk bëri qoftë edhe një hap prapa dhe rezistoi në mënyrë që të mos i ndodhte gjë të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Si mund ta hidhte hapin prapa? A mund të qëndrojnë në vend besimtari pa bërë asnjë gjë ndërkohë që sulmohet i Dërguari i Allahut, (a.s.)? Ata që e duan me të vërtetë të Dërguarin e Allahut (a.s.), ia kushtojnë atij jetën e tyre dhe gjithmonë pasojnë rrugën e tij.

Sal-lallahu alejhi ve sel-lem...

3. Bejhaki, Delailu'n-Nubuvve, vëll. 2, fq. 275-276.

4. Ebu'l-Ferexh Ibnu'l-Xhevzi, el-Vefa bi Ahvali'l-Mustafa, vëll. 1, fq. 187-188.

5. Dhehebi, Tarihu'l-Islam, fq. 164-165.

6. Ebu'l-Fida Ibn Kethir, el-Bidaje ve'n-Nihaje, vëll. 3, fq. 46.

7. Halebi, Insanu'l-Ujun fi Sireti'l-Emini'l-Me'mun, vëll. 1, fq. 423.



“Pasha kohën! Me të vërtetë, njeriu është në humbje, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin.” (Asr, 1-3)

Ne lindim në një fenomen të quajtur kohë, por jemi të paaftë edhe për ta përkufizuar atë. Secila prej përkufizimeve të bëra e kap këtë çështje nga një aspekt i saj. Koha është një enigmë që e jetojmë, e ndjejmë, por që nuk mund të themi dot se “është pikërisht kjo”. Ka edhe prej atyre që thonë se është një perceptim jo edhe aq i vërtetë në lidhje me lëvizjet që ndodhin në gjithësi. Gjithashtu, ka edhe prej atyre që thonë se është diçka e krijuar dhe e vërtetë. Cilado që të jetë e vërteta, i sigurt është fakti se njeriu ka një lidhje të detyrueshme me kohën. Si rezultat, edhe përgjegjësinë për ta sistemuar këtë lidhje e ka mbi supet e tij. Jeta e njeriut fiton kuptim në raport me suksesin e këtij të fundit në këtë çështje.

Kurani Fisnik, përveç theksimit që i bën kohës në mënyrë të përgjithshme duke e quajtur (asr), u jep një pozitë qendrore edhe proceseve që e kanë fillimin dhe fundin të caktuar, të cilave ne u themi “vakt”, me anë të emrave të përgjithshëm si vit, muaj, ditë dhe orë që përjetohe brenda saj. Koha, në përgjithësi tregon madhështinë hyjnore në gjithësi, fenomeni vakt që zë vend brenda në kohë luan rol themelor në sistemin që planifikohet t’i japë formë jetës së njeriut. Procesi që ne e quajmë jetë, përjetohe brenda kufijve të konceptit vakt i cili është produkt i kohës. Nga një aspekt, vakti është lënda e papërpunuar që fuqia hyjnore na e ka dhënë amanet për ta shndërruar në “produkt”.

Ndërsa theksi bazë i mesazhit është realizuar me fjalinë: **“Me të vërtetë, njeriu është në humbje.”**, që formon përmbajtjen e ajetit të dytë të sures Asr. Kjo dispozitë është aq shumë e rëndësishme për njeriun dhe e shpreh aq qartë të vërtetën saqë, nëse nuk merret seriozisht dhe nuk veprohet sipas urdhrat të saj, njeriu do të hyjë në një rrugë që nuk ka kthim prapa dhe do të bjerë në një humbje absolute.

Ndërkohë që kjo sure fillon me betim duke synuar që të na tërheqë vëmendjen, edhe fakti se ky betim bëhet mbi asrin/kohën, na tregon se humbja për të cilën njoftohemi ka të bëjë me kohën. Nisur nga shprehja e përgjithshme në fjalinë: **“Me të vërtetë, njeriu është në humbje.”**, kuptojmë se të gjithë do ta përjetojnë këtë fenomen të humbjes absolute, se kjo dispozitë i përfshin të gjitha kohët dhe se ky

është një rregull i pandryshueshëm përveçse për ata që përjashtohen në ajetin e tretë. Ndërsa nga ajo që na tregon ajeti i tretë në kuptimin: **“Përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin.”** (Ata nuk janë në humbje.), kuptohet se kjo humbje absolute do të ndodhë duke qëndruar larg besimit të tevhidit dhe duke mos bërë vepra të mira. Në të njëjtën kohë, ajeti fisnik na njofton se vlerësimi i segmentit kohor, i cili është lënë në amanetin tonë me emrin jetë, nëse e përjetojmë në një formë të përshtatshme me vullnetin hyjnor, është rruga e vetme e shpëtimit nga rënia në këtë humbje. Ndërsa veprat e mira, duke filluar që nga veprat e ibadeteve që na mundësojnë të jemi të përshtatshëm për adhurim, formojnë një rreth të gjerë që përfshin aktivitetet, qëndrimet dhe sjelljet konstruktive e produktive të cilat do të na bëjnë harmonikë me jetën, mjedisin dhe shoqërinë. Aftësia për ta administruar kohën është kushti themelor i arritjes së suksesit në rrugën e veprave të mira.

Koha e fiton të vërtetën e saj reale në lidhje me lëvizjet e krijesave në gjithësi. Ndërsa e vërteta e kohës nga aspekti i jetës së njeriut ka një bazë më praktike. Njeriu e sistemon jetën e tij dhe ngjarjet duke i dhënë një formë me ato që bën procesit të kohës në të cilën jeton. Ai do të thotë se e sundon kohën në vartësi me të qenët aktiv dhe influencues në këtë çështje. Këtu qëndron edhe ndryshimi ndërmjet të qenët objekt apo subjekt i kohës. Ngjyra, shija dhe aroma e jetës reflekton qëndrimin tuaj ndaj kësaj bote. Nëse arrini të gjeni një mjedis ku mund të merrni frymë rehat duke i mbrojtur vlerat tuaja, do të thotë që e keni kapur kohën nga thelbi i saj.

Rënia e njeriut në humbje del në pah kur njeriu vazhdon të administrohet nga koha në vend që ai ta administrojë kohën. Një njeri që administrohet nga koha është i privuar nga të kuptuarit e një jete të planifikuar dhe për këtë arsye, bën një jetë jashtë kohës. Ai nuk mund të prodhojë dot. Si rezultat, shndërrohet në kapital të mosprodhimit. Ndërkohë që minutat dhe sekondat konsumohen me shpejtësi në këtë proces, konsumohet edhe vetë njeriu. Për këtë arsye, i konsumohet edhe koha para



se t'i mbarojë afati i jetës. Si rezultat, njeriu kthehet në një të vdekur të gjallë.

Mesazhi themelor në suren Asr jepet nëpërmjet atyre njerëzve që nuk bien në humbje për sa i përket çështjes së marrëdhënieve me kohën. Cilësia themelore e këtyre njerëzve është vlerësimi i proceseve të jetës duke bërë vepra të mira, duke e këshilluar njëri-tjetrin për të drejtën dhe duke i sugjeruar njëri-tjetrit durimin krahas kushtit për të qenë besimtarë. Ndërsa të jetuarit e gjithë jetës pa pasur dijeni për parimet që e bëjnë njeriun rob ndaj Allahut Teala, do të thotë që ta çosh dëm krejt jetën. Në çdo vend ku prishet ekuilibri dynja-ahiret, patjetër që fenomeni humbje është i pranishëm në një lloj dimension. Kjo situatë përjetohet kur përpjekja “për ta futur këtë botë në sistem” e bën njeriun t'i harrojë përgatitjet për botën tjetër. Thirrja që Kurani Fisnik i bën njeriut dhe në veçanti besimtarit është që ai të mos bjerë në një kurth të tillë. (Shik. Nur, 36-37.) Lumturinë përfundimtare do ta përjetojnë ata që e kalojnë me bindje ndaj Zotit (xh.sh.), udhëtimin e jetës duke i marrë parasysh parimet hyjnore dhe duke mos rënë në këtë kurth. Në Kuranin Fisnik dhe Sunetin e të Dërguarit të Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, janë dhënë të gjitha detajet se si duhet të përparojmë në këtë udhëtim për të cilin po flasim. Krahas sures Asr, edhe i Dërguari i Allahut, alejhi's-salam, e ka shpjeguar me shprehje mjaft të qarta e të kuptueshme dobësinë e përgjithshme që përjeton njeriu në çështjen e çuarjes dëm të kohës. Ai (s.a.s.), na ka treguar se shumica e njerëzve janë të mashtruar për sa i përket çështjes së kohës. (Shik. Tirmidhi, Zuhd, 1.)

Jeta që bën një mysliman i mirë shpreh një proces të pashkëputshëm që të shpie te i Gjithëmëshirshmi. Ndërsa ata që do të humbin, përballë do të gjejnë “ato që kanë bërë me duart e tyre”. (Shik. Inshikak, 6.) Në shoqërinë islame ku përjetohet kjo ndjeshmëri, koha është perceptuar si një vlerë që nuk mund të blihet apo shitet, që nuk mund të kursehet dhe që nuk mund t'i jepet dikujt. Pra, koha është perceptuar si vetë jeta. Koha si kapitali i jetës është konsideruar më e rëndësishme se “dirhemët dhe dinarët”. Ndërmjet tipit të njeriut perëndimor që nxiton e shqetësohet për çdo gjë dhe njeriut të Islamit që i mbështetet Zotit (xh.sh.), ka dy ndryshime: Ndërkohë që i pari është kurhani i kohës, i dyti e merr kohën nën administrimin

e tij. Ndërkohë që i pari ka hyrë në një mjedis jetese i shqetësuar me telashin për t'u bërë ballë të gjitha problemeve duke e harruar kohën, i dyti ka shpikur orën si simbol të kursimit të kohës. (Rasim Ezenëren, Nga cila anë duhet ta thyejmë vezën? Botimet Iz, botimi i 4-t, Stamboll 1999, fq. 189.) Megjithëkëtë, kjo tablo për të cilën folëm, në lidhje me myslimanin e ditëve të sotme nuk reflekton gjë tjetër përveçse një gjendje që është burim përmasllimi (myslimani i ditëve të sotme nuk e posedon këtë tablo). Myslimani i ditëve të sotme nuk është i aftë për ta mbartur shpirtin e atyre kohëve shembullore që kanë ngelur në të kaluarën. Myslimani i ditëve të sotme po e përjeton në një formë të rëndë dobësinë e administrimit të kohës. Të administrosh kohën dhe të bëhesh subjekt i vullnetit, planit dhe aktiviteteve që do t'u japin drejtim ngjarjeve në vend se të kaplohesh nga rryma e ngjarjeve që ndodhin në kohë, duhet ta nxjerrësh në pah shpirtin e saj me anë të moralit, kulturës, artit dhe ekonomisë. Erozioni i humbjes dhe dëmit që myslimanët po e përjetojnë në këta tre shekujt e fundit, është shenjë e qartë e paaftësisë dhe dobësisë së tyre që kanë ndikuar deri në palcë.

Shembulli më i qartë i dorëzimit ndaj kohës është të pranuarit e saj për zot. Për shkak të kësaj, veten do ta ndjeni të dëshpëruar në dorën e kohës të cilën e shikoni si subjektin e çdo gjëje, çdo gjë do t'ia lini kohës dhe kjo do t'ju pëlqejë. Në të vërtetë, kjo është një arratisje. Pra, është një arratisje e njeriut nga vullneti dhe prestigji i tij. Fakti që arabët e injorancës ia hidhnin kohës fajin për ngjarjet negative që u ndodhnin, mbart damkën e kësaj arratisjeje. (Shik. Muslim, Kitabu'l-elfaz mineddehri ve gajriha, 1.) Ndërsa sahabët e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), sikundër kësaj, përpiqeshin për ta vlerësuar kohën me vetëdijen që u jepte surja Asr. Ndërsa kur ndahehin nga njëri-tjetri, këndonin sures Asr më qëllim për t'ia kujtuar njëri-tjetrit këto parime. (Taberani, Evsat, Nr: 5124.)

Edhe ne duhet ta sundojmë rrjedhën e jetës duke prodhuar vlera nën prijësinë e Kuranit Fisnik e të Sunetit të të Dërguarit të Allahut dhe nën udhëheqjen e shëmbëlltyrës së sahabëve të nderuar. Ajo që synojmë me vlerën, në kuptimin më të gjerë të saj, është çdo lloj pune e dobishme, materiale apo shpirtërore qoftë ajo, që do ta mbrojë njeriun për të mos rënë në regres dhe kthim prapa.



Ebu Hurejra (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Kush i beson Allahut dhe Ditës së Gjykimit,
të flasë mirë, ose të heshtë!” (Buhari, Rikak, 23; Muslim, Iman, 74.)

Fjalët kanë shpirt. Fjalët jetojnë ndërmjet nesh. Disa japin jetë, ndërsa disa të tjera marrin...

Njeriu u fryn fjalëve prej shpirtit të tij. Për këtë arsye, fjalët janë sublimë aq sa shpirti që i përkasin. Disa janë sublimë dhe disa janë të ulëta. Për këtë arsye, fjalët e Allahut Teala janë të pashoqe dhe fjalët e Pejgamberit (a.s.), janë kaq kuptimplota. Fjalët janë zëri i shpirtit. Për këtë arsye, fjalët sublimë dëgjohen vetëm prej shpirttrave të lartë.

Si mund të lartësohet fjala? Si mund të zbukurohet zëri i shpirtit? Duke bërë titur? Jo! Duke folur vazhdimisht? Jo! Mos vallë zbukurohet zëri i shpirtit duke i shtuar fjalës gënjeshtëri, apo duke folur vazhdimisht për të tjerët, apo duke ua treguar të gjithëve ato që dëgjon?

Ah sikur të heshtë! Në këtë mënyrë do të dëgjosh. Vërua veshin fjalëve të larta! Shiko çfarë thotë pejgamberi!

Cili?

Pejgamberi i fundit të cilit i është dhënë esenca e fjalës dhe i cili ishte xhevami’ul-kelim (Muslim, Mesaxhit, 5.): “Kushdo që i beson Allahut dhe Ditës së Gjykimit, ose të flasë mirë, ose të heshtë!” (Buhari, Rikak, 23; Muslim, Iman, 74.)

Profeti (a.s.), thotë se edhe të folurit e ka një ritëm. Ai flet për ekuilibrin ndërmjet fjalës dhe heshtjes. Kur ky ekuilibër të formohet siç duhet, notat në fjalë dalin të plota dhe gjejnë ritmin e tyre melodik. Atëherë, bisedat tona nuk përbëhen nga zhurma të thata që shkaktohen prej fjalëve të shumta. Atëherë, në qiell ngelet një zë i këndshëm. Atëherë, sublimiteti i shpirtit tonë reflekton në fjalën tonë. Fjalët tona thellohen aq sa thellësia e shpirtit tonë. Ato janë të plota aq sa është i plotë edhe ai. Gjithashtu janë edhe delikate aq sa është delikat edhe ai.

Kjo ka të bëjë aq shumë, sa që kur flet i Dërguari i Allahut (a.s.), të cilit i është dhënë esenca e fjalës dhe i cili mund t’i transmetojë me hijeshi edhe gjendjet më esenciale të fjalës, gjithësia hesht. Kur sahabët e nderuar e dëgjonin atë (a.s.), magjepse-

shin. Kur fliste ai (a.s.), mbusheshin zbrazëtirat. Kur fliste ai (a.s.), vargjet e poetëve dukeshin pavlerë...

Kur fliste i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, të gjithë përfitonin nga fisnikëria e tij sipas kapacitetit të tyre. Të gjithë merrnin nga ndonjë gjë sipas kapacitetit të tyre. Me çdo fjalë të tij, ndriçohej një anë e errësirës. Fjalët e tij, në çdo periudhë, linin një aromë të këndshme të dëgjuesit. Ata që e dëgjonin i magjepste me modestinë e tij. Krahës urtësisë, ai ndikonte të dëgjuesit edhe me hijeshinë që kishte. Në fjalët e atij (a.s.), ndjehej madhështia e modestisë. Nganjëherë thoshte fjalët më ndikuese duke heshtur. Vetëm një heshtje e tij jepte mesazhe të shumta që nuk i nxinin dot fjalët. Siç ishte i dobishëm të folurit e tij, ashtu ishte e dobishme edhe heshtja. Siç nuk ishin boshe fjalët e tij, edhe heshtja e tij shprehte shumë. Sa shumë gjëra patën mësuar sahabët e nderuar nga heshtja e tij! Sa shumë gjëra që i tha dhe ia mësoi Kaab b. Malikut (r.a.), duke heshtur! Ekuilibri madhështor i fjalës dhe heshtjes ishte bashkuar në personalitetin e tij. I Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, na pati mësuar se jo vetëm fjala, porse edhe heshtja ka një vlerë. Gjithashtu na pati mësuar se edhe fjala, edhe heshtja duhet të përdoren në vendet e tyre.

Nisur nga këto që thamë më lart, çdo heshtje e vlefshme në të vërtetë është një këshillë profetike. Nëse nga goja jonë do të dalë ligësi, nëse fjalët tona do ta lëndojnë, plagosin dhe përçmojnë bashkëbiseduesin, atëherë heshtja është më e mirë. Nëse nga buzët tona nuk do të dalin fjalë në lidhje me mirësinë, nëse pas një kohe zemra jonë do të bëhet shumë e ngurtë vetëm për shkak të këtyre, atëherë heshtja është më e mirë. Nëse fjalët tona do të lënë një shije të hidhur në gojë, nëse çdo fjalë e jona do të bëhet një shkallë për të na afruar një hap më shumë drejt Xhehenemit dhe nëse thonjtë tanë do të shndërrohen në kthetra sa më shumë që të flasim, atëherë heshtja është më e mirë. Nëse do të ndërtojmë ura shpifjesh dhe mashtrimesh me çdo



fjalë që del nga goja jonë, nëse fjalët tona do të ushqejnë urrejtjen, atëherë heshtja është më e mirë. Nëse çdo fjalë e jona do të shndërrohet në mish e kocka në tubimin e madh Ditën e Gjykimit dhe ne nuk do të kemi guximin për ta parë asnjërin prej tyre kur të na dalin përballë nesh, nëse sytë do t'i largojmë prej këtyre fjalëve dhe nëse këto fjalë do të na detyrojnë të themi: “Ah sikur të ishim dhe!”, atëherë heshtja është më e mirë.

Përse të themi gjithë ato fjalë kur pastaj do të dëshirojmë të ikim prej tyre? Për çfarë po flasim? Mos vallë kemi për qëllim që t'i hapim gropën vetes me fjalët tona? Me sa duket, veten po e robërojmë me fjalët tona, por nuk jemi të vetëdijshëm për këtë. Atëherë ne duhet t'i thyejmë këta zinxhirë dhe duhet të shpëtojmë nga robëria e fjalës. Ajo që neve na takon të bëjmë është një heshtje e vlefshme apo një fjalë e mirë. Vetëm se kjo nuk është e lehtë aq sa pandehet, sepse njeriu nuk mund të flasë dot drejt pa qenë vetë i drejtë dhe nuk mund të flasë dot me modesti pa qenë vetë modest. Ndërkohë që vetë është i lig, kurrë nuk mund të nxjerrë fjalë të mira prej gojës së tij. Atëherë, si mund të flasë fjalë të mira gjuha jonë ndërkohë që largësia ndërmjet nesh dhe mirësisë është shtuar kaq shumë? Si mund të jenë përgëzuese fjalët tona ndërkohë që gjendja jonë i bën të tjerët të na urrejnë? Njeriu duhet të bëjë shumë mirësi, në mënyrë që të flasë për mirësinë. Siç thonë të urtët, prej qypit rrjedh ajo që ka brenda.

Çdo fjalë që na përket neve, madje çdo shkronjë, fillon të ndërtojë një “ne” që nga momenti kur të dalë nga goja jonë. Në të vërtetë, si të jemi ne, të asaj natyre dalin edhe fjalët nga goja jonë. Pra, fjalët tona dalin prej nesh sipas thellësisë, dijenisë dhe besimit që kemi. Pra, fjalët tona dalin prej nesh sipas lidhjes që kemi me përshpirtshmërinë,

Zotin dhe të vërtetën. Për këtë arsye, çdo fjalë që e ka humbur përshpirtshmërinë, na largon neve nga vetja jonë. Humbja e të vërtetës dhe privimi nga përshpirtshmëria, na e zbraz brendësinë tonë po aq sa edhe atë të fjalëve tona. Gënjeshtrat, thashethemet dhe shpifjet na e prishin brendësinë tonë. Për këtë arsye, plagoset rëndë personaliteti, humanizmi dhe besimi ynë.

Prej një personaliteti të tillë nuk vjen mirësi. Pastaj rreth nesh mbliidhen grumbuj fjalësh si grumbujt e plehrave. Kur njerëzit të na e vënë veshin, nuk do të gjejmë dot qoftë edhe një fjalë me bazë për ta thënë në lidhje me mirësinë. Atëherë, kur të na vijë radha për të folur, nuk do të themi dot fjalë të cilat priten nga besimtarët.

Për këtë arsye, nuk do të themi dot qoftë edhe një fjalë të vetme rreth të vërtetës përderisa nuk i shembim muret që kemi ndërtuar në perceptimin tonë. Edhe ne si besimtarë jemi kapluar nga ajo rrëkeja prej të cilës janë kapluar të gjithë. Prandaj nuk e ngremë dot zërin tonë në gjithë këtë zhurmë të madhe. Për shkak se merremi vetëm me problemet e përditshme, nuk po themi dot asnjë fjalë të vlefshme për ne që të jetë shërim për zemrat tona, madje, as nuk po heshtim dot.

Sa e dhimbshme është për njeriun që e kaplon veten pas zhurmës së të tjerëve dhe që nuk e thotë dot këngën e tij! Sa e dhimbshme është që njeriu të flasë siç jeton ngaqë nuk jeton dot siç beson! Sa e dhimbshme është kur të mos gjejë fjalë të vlefshme për veshët e të tjerëve ngaqë veshët e tij gjithmonë kanë qenë të pushtuar (nga kotësitë)! Dhe sa e dhimbshme është kur të shohë se fjalët e tij nuk zënë dot vend në anën e duhur të peshores! Këtë nuk mund ta themi vetëm për fjalët, por edhe për heshtjen!



UDHËTIMI I PËRJETËSISË

- P J E S A X V -

RINGJALLJA DHE MAHSHERI

Pasi t'i ringjallë të gjitha krijesat, Allahu i Madhëruar do t'i mbledhë ato në sheshin e Mahsherit, ku do të vërë peshoren dhe do të fillojë llogarinë. Lidhur me këtë fakt, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“O Zoti ynë! Ti do t'i mbledhësh njerëzit në një Ditë për të cilën nuk ka dyshim. Me të vërtetë, Allahu nuk e shkel premtimin.” (Al-i Imran, 9.)

“Ditën, kur do të fryhet në Sur, pikërisht atë Ditë do t'i tubojmë të ligjtë me sy të zgurdulluar.” (TaHa, 102.)

“Për Zotin tënd! Ne do t'i tubojmë ata dhe djajtë, pastaj do t'i sjellim ata të gjunjëzuar rreth Xhehenemit!” (Merjem, 68.)

“Atë Ditë njerëzit do të paraqiten grupe-grupe, që t'u tregohen veprat e tyre.” (Zelzele, 6.)

Në një hadith fisnik, i Dërguari i Allahut, (a.s.), e ka përshkruar kështu sheshin e Mahsherit ku do të mblidhen njerëzit:

“Ditën e Kiametit njerëzit do të mblidhen në një fushë që ngjan me një kulaç prej mielli të bardhë, të situr e të pastruar prej krundeve.”

Një prej transmetuesve të hadithit ka bërë këtë shpjegim:

“Në atë fushë, nuk gjendet asnjë shenjë (si mal, gur, etj.) që tregon diçka për dikë apo që orienton ndonjë rrugë!” (Buhari, Rikak, 44.)

Në Kuranin Fisnik thuhet se kur t'i fryhet Surit për herë të parë, malet do të shkërmoqen e do të bëhen pluhur, toka do të bëhet e rrafshët dhe e shkretë dhe nuk do të gjendet asnjë e përpjetë apo e tatëpjetë.¹

Njerëzit, kur të mblidhen në sheshin e Mahsherit, do të kenë forma të ndryshme, sipas gjendjes shpirtërore që ata kanë pasur në jetën e dynjasë. Lidhur me këtë çështje, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Ditën e Kiametit, ju do të vini në sheshin e Mahsherit në këmbë, hipur (në mjet apo kafshë), ose duke u zvarritur me fytyrë përtokë.” (Tirmidhi, Kiamet, 3/2424. Shih. Muslim, Xhennet, 57.)

Ndërsa në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Ai, që Allahu e udhëzon në rrugën e drejtë, është i udhëzuari; ndërsa për atë që Ai e çon në humbje, me siguri që nuk do të gesh mbrojtës tjetër, përveç Atij. Ne do t'i tubojmë ata në Ditën e Kiametit, me fytyrat përtokë, të verbër, shurdhë e memecë. Vendbanimi i tyre është Xhehenemi. Kurdo që të zbehet zjarri, Ne do t'ia shtojmë flakën.” (Isra, 97.)

“Ata që do të tubohen me fytyrat përmbys në Xhehenem, do të jenë në vendin më të keq dhe më të larguarit prej rrugës së vërtetë.” (Furkan, 34.)

Enes ibn Malik (r.a.) tregon:

“Erdhi një person dhe pyeti:

«O i Dërguar i Allahut! Si do të ringjallet mohuesi me fytyrë përtokë në ditën e Kiametit?»

I Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

«A nuk ka fuqi Allahu, i Cili atë që e bën të ecë mbi këmbë në dynja, ta bëjë të ecë mbi fytyrë ditën e Kiametit?»

Katade, i cili e transmeton këtë hadith, në fund thotë:

“Po, betohem në madhështinë e Zotit tonë se Ai është i plotfuqishëm për këtë!” (Buhari, Rikak, 45; Muslim, Munafikin, 54.)

Një nga ngjarjet që do të zhvillohet në sheshin e Mahsherit, është edhe afrimi i Diellit mbi njerëzit. Lidhur me këtë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka shpjeguar:

“Ditën e Kiametit, Dielli do t'u afrohet njerëzve deri në distancën një milje². Njerëzit do të zhyten në

1. shih. TaHa, 105-107.

2. Një nga transmetuesit e hadithit, Sulejm ibn Amir, ka thënë: “Betohem në Allahun se, nuk e di nëse Profeti (a.s.), me (fjalën) “mil” ka pasur për synim një njësi matëse në tokë, apo “milin” që përdoret për të lyer sytë!”.



djersë në masën e veprave të këqija të tyre. Dikush do të zhytet deri në thembra, dikush deri në gjunjë, e dikush deri në brez. Ndërsa disa të tjerë do të zhyten deri në fyt.” (Muslim, Xhennet, 62; Tirmidhi, Kiamet, 2/2421.)

“Ditën e Kiametit, njerëzit do të djersitin në she-shin e Mahsherit (për shkak të ngjeshjes, tmerrit dhe afrimit të Diellit). Aq sa djersa e derdhur do të futet në tokë deri në thellësinë shtatëdhjetë parakrahë (dhira). Më pas do të ngrihet (niveli i djersës) derisa t’ua mbyllë gojën, e madje do të arrijë deri në veshët e tyre.” (Buhari, Rikak, 47.)

“Ditën, kur të gjithë njerëzit do të ngrihen (të dalin para) Zotit të botëve!”³ Njëri prej tyre, do të ngrihet në këmbë i zhytur në djersën e tij, që i arrin deri në gjysmë të veshëve.” (Buhari, Rikak, 47; Muslim, Xhennet, 60.)

Me këtë rast, duhet të theksojmë edhe njëherë se jeta e berzahut dhe e Ahiretit, kanë kushtet dhe cilësitë e tyre të veçanta, të cilat do të jenë shumë të ndryshme nga ato të jetës së dynjasë. Për shembull, nëse Dielli do të afrohej në këtë botë, çdo gjë do të digjej e do të shkrumbohej. Po ashtu, nëse një tufan do të shkaktonte përmbytjen e gjithë botës, të gjithë njerëzit do të vdisnin. Mirëpo, në Ahiret, gjëra të tilla do të manifestohen sipas gjendjes së veçantë të gjithsecilit. Për rrjedhojë, me afrimin e Diellit në ditën e Kiametit, gjynahqarët do të vuajnë shumë, por nuk do të vdesin, sepse atje nuk do të ketë më vdekje.

Gjithashtu, kur njerëzit në Mahsher të djersitin për shkak të nxehtësisë së Diellit, gjithsecili do të mbytet vetëm në djersën e vet. Në analogji me këtë fenomen, na është sqaruar edhe fakti se në ditën e Kiametit gjithkush do të ecë në dritën e vet. Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik shpjegohet:

“Ditën që do të shohësh besimtarët dhe besimtarët, me dritën e tyre që shkëlqen para dhe në të djathtë të tyre (e do t’u thuhet):

«Lajm i mirë sot për ju: kopshtet e Xhenetit nëpër të cilat rrjedhin lumenjtë e ku do të bano-ni përgjithmonë. Kjo është fitorja më e madhe!» Atë Ditë, hipokritët dhe hipokritet do t’u thonë besimtarëve:

«Na prisni edhe ne që të marrim nga drita juaj!» Por atyre do t’u thuhet:

«Kthehuni prapa e kërkon tjetër dritë!» Dhe, ndërmjet tyre, do të vendoset një mur me portë: brenda saj ka mëshirë, kurse jashtë saj ka dënim.» (Hadid, 12-13.)


Në atë ditë të tmerrshme, drita e çdo njeriu do të mjaftojë vetëm për të dhe nuk do t’i bëjë dobi askujt tjetri. Kjo është një nga gjendjet më të jashtëzakonshme dhe më të mrekullueshme të ditës së Kiametit.

Si paralelizëm i kësaj gjendje në këtë botë, shpjegohet ky shembull:

Një besimtar ecën nën dritën e besimit të vet, ndërkohë që një mohues pranë tij mbetet gjithmonë në errësirën e mohimit dhe nuk përfiton aspak prej dritës së besimit. Në të njëjtën mënyrë, edhe një i verbër që ecën përkrah me një njeri që sheh, nuk përfiton aspak prej dritës së syrit të tjetrit.

I nderuari Imam Sharani, lidhur me djersën e jashtëzakonshme që do të derdhin njerëzit në ditën e Mahsherit shpreh:

“Është e sigurt se njerëzit që do të djersitin atë ditë, kur kanë qenë në dynja nuk kanë djersitur duke bërë punë të mira si: lufta në rrugën e Allahut të Madhëruar, shkuarja në haxh, agjërimi, falja e namazit, ndihma e myslimanëve në punët e tyre dhe hapja e puseve me qëllim që njerëzit të pinë prej tyre. (Kanë qëndruar larg këtyre punëve.) Për



*“Ai, që Allahu
e udhëzon në rrugën
e drejtë, është i udhëzuari;
ndërsa për atë që Ai e çon
në humbje, me siguri që
nuk do të gjejsh mbrojtës
tjetër, përveç Atij. Ne do
t’i tubojmë ata në Ditën e
Kiametit, me fytyrat pertokë,
të verbër, shurdhë e memecë.
Vendbanimi i tyre është
Xhehenemi. Kurdo që të
zbehet zjarri, Ne do t’ia
shtojmë flakën.”*

(Isra, 97.)

3. Mutaffin, 6.

këtë arsye, ata do të mbyten në djersë në sheshin e Mahsherit. Përveç kësaj, kur të jenë duke pritur në sheshin e Mahsherit, ata do të djersitin edhe prej turpit, frikës dhe shqetësimit të madh.” (Imam Sharani, “Vdekja, Kiameti, Ahireti”, fq. 159.)

Shkurtimisht, është bërë e ditur se ditën e Mahsherit do të ketë ngjarje aq të frikshme, saqë edhe njerëzit, të cilët në varr janë përgëzuar me Xhenet, do ta harrojnë këtë mëshirë dhe falje hyjnore.⁴ Strehohemi tek Allahu i Madhëruar prej të gjitha këtyre tmerreve...

NDËRMJETËSIMI I PROFETIT TONË (A.S.).

Ebu Hurejre (r.a.) transmeton:

Një ditë ishim së bashku me të Dërguarin e Allahut, (a.s.), në një gosti. Profetit (a.s.) iu ofrua një copë shpatull, të cilën e pëlqente shumë. Pasi këputi një kafshatë prej saj me majat e dhëmbëve, tha:

“Unë do të jem zotëria i njerëzve në ditën e Kiametit! Dhe a e dini pse? Allahu do t’i grumbullojë njerëzit në ditën e Kiametit, nga të parët tek të fundmit, në një vend të rrafshët. Aty, nëse u hedh shikimin, është e mundur t’i shohësh të gjithë, e nëse dikush thërrret, mund t’ia dëgjojnë zërin të gjithë. Dielli afrohet dhe njerëzit ndiejnë vështirësi dhe vuajtje, aq sa nuk i rezistojnë dot. (Në një transmetim thuhet se kjo pritje do të zgjasë shtatëdhjetë vjet.)⁵ Disa njerëz u thonë të tjerëve:

«A nuk e shikoni se në çfarë gjendje jemi? A nuk e shikoni se çfarë na ka gjetur? Pse nuk kërkon dikë që mund të ndërmjetësojë për ju tek Zoti juaj?» Disa të tjerë thonë:

«Shkoni tek babai juaj Ademi!»

Njerëzit shkojnë tek Ademi (a.s.) dhe i thonë:

«O Adem! Ti je babai i njerëzimit. Allahu të ka krijuar me duart e Tij dhe ka fryrë tek ti nga shpirti i krijuar prej Tij. Po ashtu, Ai ka urdhëruar melekët, e ata të ranë ty në sexhde, dhe pastaj të vendosi në

Xhenet. Ndërmjetëso për ne tek Zoti yt! A nuk e sheh se deri ku ka arritur çështja?»

Ai iu thotë:

«Zoti im është zemëruar sot! Ai nuk është zemëruar as më parë, e as nuk do të zemërohet ndonjëherë si tani. Ai më ndaloi që të haja nga “pema”, por unë nuk e dëgjova. Vetja ime! Vetja ime! Shkoni te ndonjë tjetër, shkoni tek Nuhu!»

Ata shkojnë tek Nuhu (a.s.) dhe i thonë:

«O Nuh! Ti je i pari i të Dërguarve dhe Allahu të ka cilësuar si **“rob shumë falënderues”**⁶! Ndërmjetëso për ne tek Zoti yt! A nuk e sheh se në ç’gjendje jemi? A nuk e shikon se deri ku ka arritur çështja?»

Ai iu thotë:

«Zoti im është zemëruar sot! Ai nuk është zemëruar as më parë, e as nuk do të zemërohet ndonjëherë si tani. Një lutje (të pranuar) që e kam pasur, e bëra kundër popullit tim. Vetja ime! Vetja ime! Shkoni tek Ibrahim-i!»

Ata shkojnë tek ai dhe i thonë:

«Ti je i Dërguar i Allahut dhe mik i Tij ndër banorët e tokës! Ndërmjetëso për ne tek Zoti yt! A nuk e sheh se në ç’gjendje jemi? A nuk e shikon se deri ku ka arritur çështja?»

Ai iu thotë:

«Zoti im është zemëruar sot! Ai nuk është zemëruar as më parë, e as nuk do të zemërohet ndonjëherë si tani. Pastaj, ai iu kujton atyre “(tre) gënjeshttrat e tij”. Vetja ime! Vetja ime! Shkoni te dikush tjetër, shkoni tek Musai!»

Ata shkojnë tek Musai (a.s.) dhe i thonë:

«O Musa! Ti je i Dërguar, Allahu të ka përzgjedhur duke të dhënë Shpallje (Risaleh) dhe duke të të folur drejtpërdrejt! Ndërmjetëso për ne tek Zoti yt, a nuk e sheh se në ç’gjendje jemi? A nuk e shikon se deri ku ka arritur çështja?»

Ai iu thotë:

«Zoti im është zemëruar sot! Ai nuk është zemëruar as më parë, e as nuk do të zemërohet ndonjëherë si tani. Unë kam vrarë një njeri, të cilin nuk isha urdhëruar ta vrisja. Vetja ime! Vetja ime! Shkoni tek Isai!»

4. shih. Ibnu’l-Xheuzi, Bustanu’l-Uaizin ue Rijadu’s-Samiin, Bejrut 1419, fq. 36.

5. shih. Is’hak ibn Rahuje, Musned, I, 84/10; Bejhaki, el-Ba’th ue’n-Nushur, I, 336/609.

6. shih. Isra, 3.

Ata shkojnë tek Isai (a.s.) dhe i thonë:

«O Isa! Ti je i Dërguar i Allahut, u ke folur njerëzve kur ishe në djep, ti je Fjalë prej Tij (Allahut), të cilën Ai e vendosi tek Merjemja, si shpirt i krijuar prej Tij! Ndërmjetëso për ne tek Zoti yt! A nuk e sheh se në ç'gjendje jemi? A nuk e shikon se deri ku ka arritur çështja?»

Isai iu thotë:

«Zoti im është zemëruar sot! Ai nuk është zemëruar as më parë, e as nuk do të zemërohet ndonjëherë si tani. Por ai nuk iu përmend ndonjë gabim. (E megjithatë thotë)-Vetja ime! Vetja ime! Shkoni tek dikush tjetër! Shkoni tek Muhammedi (a.s.)!»

Profeti ynë (a.s.), vazhdimin e kësaj ngjarjeje e përcjell kështu në një hadith tjetër:

«Ata vijnë tek unë dhe më thonë:

«O Muhammed! Ti je i Dërguar i Allahut dhe vula e Profetëve. Allahu të ka falur gabimet e kaluara dhe të mëvonshme!»⁷ Ndërmjetëso për ne tek Zoti yt! A

7. Këtu aludohet në ajetin 2, të sures Fet'h, ku urdhërohet: *“Për të t'i falur ty Allahu gabimet e mëparshme dhe të ardhshme!”* dhe kjo shprehje është një kallëp që përdoret për të përforcuar kuptimin. Domethënë, me këtë shprehje, Allahu i Madhëruar dëshiron të tregojë se Profeti ynë (a.s.) është i pafajshëm dhe i ruajtur prej gjynaheve. Përveç kësaj, në lidhje me fjalën “gynah” që përdoret në ajet, janë bërë këto shpjegime:

- Me këtë gjynah, nënkuptohen rastet kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), nuk ka bërë zgjedhjet më të mira dhe më primare, por ato më pak të drejta. Në fakt, cilësimi i këtyre veprimeve si “gynah”, ndërkohë që normalisht nuk është gjynah, është për shkak se Allahu i Madhëruar e sheh Profetin (a.s.) në pozitë të lartë. Prandaj edhe është thënë: “Disa vepra të mira dhe të pranueshme të njerëzve të mirë e të devotshëm, mund të konsiderohen si të meta për ata që janë në një nivel të lartë në afërsinë me Allahun e Madhëruar, sepse niveli i afërsisë që kanë ata me Allahun, e bën të domosdoshme që ata të shfaqin virtyte edhe më të larta.

- Disa dijetarë kanë thënë se këtu nuk bëhet fjalë për ndonjë gjynah të vepruar, por për ndonjë veprim që të mos kritikohet. Ndërsa me shprehjen “gynahet e ardhshme”, nënkuptohen disa gjynahe të ummetit të tij, të cilat do të falen në sajë të ndërmjetësimit të Profetit (a.s.).

- Me këtë shprehje janë aluduar gabimet apo gjynahet e vogla, të cilat mund të jenë të pavullnetshme. Gjithsesi, qofshin të vullnetshme apo jo, këto gabime janë të pranueshme për profetët, sepse ato i ruajnë ata nga pëlqimi i vetvetes. Përveç kësaj, fakti që edhe profetët janë qenie njerëzore, i bën ata të gabueshëm, gjë e cila i pengon ummetit e tyre që t'i ngrenë ata apo t'u atribuojnë atyre cilësi të larta në mënyrë të tepruar.

- Kjo shprehje mund të jetë përdorur me qëllim që të nxisë ummetin e Muhammedit (a.s.), drejt kerkimit të faljes (istigfarit).

- Nëse merret parasysh koha, vendi dhe gjendja në të cilën është zbritur ky ajat, bëhet e qartë se, qëllimi i kësaj shprehjeje, janë disa gabime që myslimanët kanë vepruar gjatë luftës dhe përpjekjeve në përhapjen e Islamit nën udhëheqjen e Profetit (a.s.), në ato 19 vite. Këto gabime nuk i di askush. Madje, mendja e njeriut nuk arrin të gjejë ndonjë të metë në këto përpjekje të singqerta. Mirëpo, në syrin e Allahut të Madhëruar, i Cili vlerëson me kriteret e më të mirës dhe më të bukurës, ishin gabime të tilla, saqë për shkak të tyre, myslimanët nuk kishin gëzuar asnjë fitore të padiskutueshme ndaj idhujtarëve. Për rrjedhojë, Allahu i Madhëruar, me këtë urdhër dëshiron të thotë: “Nëse do të kishit vazhduar përpjekjet dhe luftën tuaj me këto gabime, do të duhej edhe shumë kohë që t'i mundnit e t'i mposhtnit idhujtarët arabë. Mirëpo, Ne jua falëm të gjitha këto të meta e gabime dhe duke i eliminuar ato vetëm me mirësinë dhe mëshirën tonë, ju hapëm derën e çlirimit dhe fitores në Hudejbije. Përndryshe, ju nuk do ta kishit arritur dot këtë fitore me forcat tuaja!”

Këtu, duhet kuptuar mirë edhe çështja se, për çfarëdo qëllimi të përpiktet dhe të luftojë një grup apo bashkësi, të gjitha mangësitë, të metat dhe gabimet e asaj përpjekjeje, i ngarkohen liderit të atij grupi. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se këto janë mangësi dhe gabime personale të liderit. Në

nuk e sheh se në ç'gjendje jemi? A nuk e shikon se deri ku ka arritur çështja?»

Unë nisem dhe shkoj nën Arshin (e Allahut) dhe bie në sexhde për Zotin tim. (Kjo sexhde do të zgjasë një javë)⁸ Pastaj Allahu më frymëzon disa lavde dhe falënderime për Të, të cilat nuk ia kishte frymëzuar tjetërkujt para meje. (Pasi thura lavde dhe falënderime me to) Allahu i Madhëruar më thotë:

«O Muhammed! Ngrije kokën (nga sexhdja)! Kërko e do të të jepet, ndërmjetëso dhe do të të lejohet!»

Unë e ngre kokën dhe them:

«O Zot! Ummeti im, ummeti im!»

Atëherë më thuhet:

«O Muhammed! Ata që nuk do të merren në llogari prej ummetit tënd, futi në Xhenet nga porta e djathtë. (Babu'l-Ejmen)! E ata do të hyjnë bashkë me njerëzit edhe nga portat e tjera veç kësaj!»

Betohem në Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, se distanca ndërmjet dy anëve të një dere prej dyerve të Xhenetit, është sa distanca ndërmjet Mekës dhe Hexherit (Në Bahrejn), ose sa distanca ndërmjet Mekës dhe Busras (qytet në jug të Sirisë)” (Buhari, Enbija 3, 9, Tefsir 17/5; Muslim, Iman, 327, 328; Tirmidhi, Kiamet, 10.)

Në një transmetim tjetër, i Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë:

“...Unë kërkoj leje tek Allahu (për ndërmjetësim) dhe ajo më jepet. Ai më frymëzon dhe unë e falënderoj Atë me fjalë që ende nuk i di.. E falënderoj me to dhe bie në sexhde për Të. Pastaj më thuhet:

«O Muhammed! Ngrije kokën! Fol e do të dëgjohesh, kërko e do të të jepet, ndërmjetëso e do të të lejohet të ndërmjetësosh!» Them:

«O Zot! Ummeti im, ummeti im!»

Thuhet:

fakt, ato gabime janë bërë nga e gjithë ajo bashkësi, pra, janë rezultat i veprimeve të asaj bashkësie. Por, për shkak se përgjegjësia bie mbi liderin, edhe akuzat bien mbi të.

Përveç kësaj, duhet theksuar edhe se surja Nasr, është zbritur në ditët e fundit të Profetit tonë (a.s.), si lajmërim për vdekjen e tij. Në këtë sure, Allahu i Madhëruar e fton të gjithë ummetin Islam në emër të Profetit tonë (a.s.), të falënderojnë Allahun me tesbih për çdo fitore dhe të kërkojnë faljen e Tij për çdo gabim që e bëjnë në mënyrë të pavullnetshme. Për rrjedhojë, edhe Profeti ynë (a.s.), kohët e fundit të jetës së tij, i përsëriste shpesh këto fjalë:

“Larg të metave është Allahu dhe falënderimet i takojnë Atij. Kërko faljen e Tij dhe pendohem tek Ai!”

Kur nëna jonë Aisha (r.a.), e pyeti për shkakun e përsëritjes së shpeshtë të këtyre fjalëve, Profeti ynë (a.s.), tha: “Zoti im më lajmëroi se do të shoh një shenjë brenda ummetit tim. Që kur e kam parë atë shenjë, i përsëris shpesh këto tesbih. Atë shenjë e kam parë në suren Nasr, e cila lajmëron për çlirimin e Mekës: “Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi (i Mekës) dhe t'i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e Allahut grupe-grupe, atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai; se Ai është vërtet Pranues i madh i pendimeve!” (Nasr, 1-3.)” (Muslim, Salat, 220.)

8. shih. Ahmed ibn Hanbel, Musned, I, 4; Ibn-i Hibban, Sahih, XIV, 394; Hejthemi, X, 374.

«Shko dhe nxirr prej tij (Xhehenemit) atë që në zemrën e tij ka besim sa kokrra e elbit (ose e grurit)!» Nisem dhe ashtu vepro. Pastaj kthehem dhe e falënderoj (Allahun) me këto falënderime...”

Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), shkon për herë të dytë, i thuhet: “nxirr prej tij (Xhehenemit) atë që në zemrën e tij ka besim sa një grimcë apo sa një kokërr sinapi!”. Ndërsa kur shkon për herë të tretë, i thuhet: “nxirr prej tij (Xhehenemit) atë që në zemrën e tij ka besim sa kokrra më e vogël e sinapit!” (shih. Muslim, Iman, 326, 322.)

Siç shihet edhe në hadithet fisnike, ditën e Kiametit, të gjithë njerëzit do të kërkojnë një shpëtimtar për t'i shmangur prej vuajtjeve dhe tmerreve të asaj dite. Mirëpo, ata do të vërejnë të tmerruar se të gjitha degët, ku zgjaten për t'u kapur, do t'u ngelen në dorë një e nga një. Më në fund, në një moment kur shpresat e tyre do të fillojnë të veniten, ata do të kuptojnë se i vetmi person, të cilit i ecën fjala në atë shesh të tmerrshëm, është Profeti ynë i dashur (a.s.), dhe do të shkojnë menjëherë tek ai. Pas kësaj, Profeti ynë (a.s.), do të ndërmjetësojë për ta dhe do t'i shpëtojë prej tmerreve e vuajtjeve.

Në një kohë kur të gjithë profetët do të qajnë hallin e vet, Profeti ynë (a.s.) do të jetë i vetmi që do të mendojë për ummetin e tij dhe i vetmi të cilit do t'i dëgjohet kërkesa e do t'i pranohet lutja.

Gjithashtu, Profeti ynë (a.s.) do të ketë edhe të drejtën e ndërmjetësimeve më të veçanta për ummetin e tij. Lidhur me këtë, ai ka thënë:

“Shefaati (ndërmjetësimi) im, (pikësëpari) do të jetë për ata që kanë bërë gjynahe të mëdha prej ummetit tim!” (Ebu Daud, Sunnet, 20-21/4739; Tirmidhi, Kiamet, 11/2435-6; Ibn-i Maxhe, Zuhd, 37; Ahmed, III, 213.)

Fakti që i Dërguari i Allahut në këtë hadith shprehhet se do të ndërmjetësojë për ata që kanë kryer gjynahe të mëdha prej ummetit të tij, nuk do të thotë se shefaati i tij do të jetë vetëm për ta. Sigurisht që ata që kanë kryer gjynahe të mëdha kanë më tepër nevojë për shefaatin e tij. Por shefaati i tij do të jetë në disa lloje. Për këtë arsye, çdokush që dëshiron Allahu, do të përfitojë prej shefaatit të Profetit (a.s.), në përputhje me gjendjen e tij.

Nga ana tjetër, ky hadith fisnik nuk duhet të na bëjë pasivë dhe as të bëhet shkak që ne të neglizhojmë detyrat tona të devotshmërisë. Sjelljet që ne i konsiderojmë të parëndësishme, ose për të cilat mendojmë se gjithsesi do të na falen, tek Allahu mund të jenë gjynahe të mëdha. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Ju përcillnit me gjuhët tuaja dhe flisnit me gojë tuaja diçka, për të cilën nuk kishit dijeni. Ju këtë

e merrnit për gjë të lehtë, por para Allahut kjo ishte një shkelje e madhe.” (Nur, 15.)

Ndërsa në një hadith fisnik, na bëhet e ditur se një grua ka merituar dënimin e Xhehenemit për shkak se ka lënë të ngordhë urie një mace.⁹ Sigurisht që edhe e kundërta e kësaj është e mundur. Pra, një mirësi që ne e konsiderojmë të vogël, mund të bëhet shkak që ne të fitojmë kënaqësinë dhe mëshirën e Allahut. Lidhur me këtë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), tregon:

“Kohë më parë, një njeri kishte pasur etje gjatë udhëtimit. Ai kishte gjetur një pus, kishte zbritur poshtë, kishte pirë ujë dhe kishte dalë. Por ç'të shih-te! Një qen po merrte frymë me gjuhën e nxjerrë një pëllëmbë jashtë, dhe prej etjes së madhe po lëpinte dheun e lagësht. Njeriun e kishte brejtur ndërgjegjia dhe kishte thënë me vete:

«Këtë qen e paska marrë etja njësoj si mua!» Pastaj, kishte zbritur menjëherë në pus, kishte mbushur këpucën me ujë dhe duke e mbajtur me gojë, ishte ngjitur lart dhe i kishte shuar etjen qenit. Allahu i Madhëruar, ishte kënaqur prej veprimit të tij dhe ia kishte falur gjynahet.”

Sahabët, me habi të madhe pyetën:

«O i Dërguar i Allahut! A do të kemi sevape edhe prej kafshëve?»

Profeti (a.s.), iu tha:

“Për çdo gjallesë ka sevape.” - (Buhari, Shurb, 9; Muslim, Selam, 153.)

Ndërsa në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë:

“Një person, pa një degë peme në rrugë dhe tha: «Betohem në Allahun se do ta largoj këtë degë peme që të mos i pengojë myslimanët!»

E largoi dhe për këtë fitoi Xhenetin.” (Muslim, Birr, 128.)

Nisur nga kjo, ne duhet të ruhem i prej të gjitha gjynaheve dhe të kryejmë sa më shumë vepra të mira, pa peshuar madhësinë e tyre!

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“...Është e vërtetë se Zoti yt do të të vendosë ty në një vend të lavdëruar.” (Isra, 79.)

Shprehja “makamen mahmuden / vend-pozitë e lavdëruar”, që përmendet në këtë ajet fisnik, aludon pikërisht në pozitën e shefaatit/mundësisë së ndërmjetësimit, që do të gëzojë Profeti ynë (a.s.).

Siç përmendet edhe në hadithin e mësipërm, ajo pozitë do të jetë e posaçme vetëm për Profetin tonë (a.s.), i cili është mëshirë për botët. Në atë kohë,

9. shih. Buhari, Enbija, 54.

Profeti ynë (a.s.), do të mbajë në dorë Flamurin e Falënderimit (Livau'l-Hamd) dhe të gjithë profetët, përfshirë edhe Ademin (a.s.), do të mbledhen nën këtë flamur.¹⁰

Është me vend të theksojmë edhe faktin se profetët, tek të cilët njerëzit do të shkojnë për të kërkuar ndërmjetësim para se të shkojnë tek Profeti ynë (a.s.), nuk e konsiderojnë veten të denjë për të ndërmjetësuar për shkak të gabimeve që kanë bërë. Kjo sjellje na flet për përlësinë dhe modestinë e tyre të lartë, por shpreh edhe faktin se pozita e ndërmjetësimit ka disa gradë dhe më të lartën e zotëron Profeti ynë (a.s.). Më vonë, me lejen e Allahut, edhe profetët e tjerë do të ndërmjetësojnë për njerëzit.

Në një hadith fisnik, i Dërguari i Allahut, (a.s.), është shprehur se Allahu i Madhëruar i ka dhënë të drejtën e tre lutjeve të pranuar. Më pas vazhdon:

“...Pas kësaj unë u luta:

«O Allah! Fale ummetin tim! O Allah! Fale ummetin tim!»

Ndërsa lutjen time të tretë e kam ruajtur për ditën kur të gjitha krijesat, madje edhe Ibrahim (a.s.), do të kenë nevojë për mua dhe do të më kërkojnë të ndërmjetësoj.” (Muslim, Musafirin, 273.)

E pavarësisht gjithë këtyre fakteve, disa persona thonë se askush nuk mund të bëjë ndërmjetësim tek Allahu, sado i devotshëm qoftë. Ata i anashkalojnë këto hadithe në lidhje me shefatin dhe nuk duan t'i pranojnë këto të vërteta. Mirëpo, në shumë ajete fisnike, shprehet qartë se ata që lejon Allahu, do të mund të bëjnë ndërmjetësim në botën tjetër. Për shembull:

“...Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd pa lejen e Tij?..” (Bekare, 255.)

“...S'ka ndërmjetës tek Ai, përveçse me lejen e Tij!..” (Junus, 3.)

“Askush nuk do të mund të ndërhyjë, përveç atij që ka marrë lejen dhe premtimin e të Gjithëmëshirshmit.” (Merjem, 87.)

“Asnjë ndërmjetësim tek Ai nuk bën dobi, përveçse për atë që Ai jep leje...” (Sebe', 23.)

E në mënyrë të veçantë, ky ajet fisnik është she-

mbull i qartë që tregon se shefaati është një e vërtetë që do të realizohet vetëm me lejen e Allahut:

“Atë ditë nuk do të bëjë dobi ndërmjetësimi i askujt, përveç ndërmjetësimit të atij, që i jep leje i Gjithëmëshirshmi dhe që i është pranuar fjala.” (TaHa, 109.)

ZBRITJA E BANORËVE TË QIELLIT NË TOKË

Në sajë të ndërmjetësimit të Profetit tonë (a.s.), tashmë i vjen fundi edhe pritjes së frikshme e të tmerrshme në sheshin e Mahsherit, dhe fillon dhënia e llogarisë. Për rrjedhojë, banorët e qiellit zbresin në tokë, dhe sipas një transmetimi, ata bartin librat e punëve të robërve¹¹ dhe i rrethojnë ata.

Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Ditën, kur qielli me re do të hapet e engjëjt do të lëshohen në zbritjen e madhe.” (Furkan, 25.)

“Atë ditë pushteti i vërtetë do t'i përkasë vetëm të Gjithëmëshirshmit. Kjo do të jetë ditë e vështirë për jobesimtarët.” (Furkan, 26.)

Ibn-i Abbasi (r.a.), pasi i komenton këto ajete fisnike, tregon se si do të ndodhë kjo ngjarje e madhe:

“Qielli i dynjasë hapet dhe të gjithë melekët që ndodhen në çdo kat të qiellit zbresin në tokë. Në fillim zbresin banorët e katit të parë, të cilët janë më shumë se xhinët dhe njerëzit në tokë. Banorët e tokës i pyesin:

«Midis jush është Zoti juaj?»

«Jo!» - thonë ata.

Më pas zbresin banorët e katit të dytë, të cilët janë edhe më shumë se banorët e katit të parë dhe atyre të tokës të marrë së bashku. Banorët e tokës i pyesin:

«Midis jush është Zoti juaj?»

«Jo!» - thonë edhe ata...

Në këtë mënyrë zbresin me radhë të gjithë melekët, që prej katit të shtatë, dhe rreshtohen radhë-radhë.¹² Melekët e çdo kati, janë më tepër se ata të një kati më parë dhe të gjithë banorët e tokës të marrë së bashku.” (Hakim, IV, 613/8699.)

«Shko dhe
nxirr prej tij
(Xhehenemit) atë
që në zemrën e tij
ka besim sa kokrra e elbit
(ose e grurit)!» Nisem
dhe ashtu veproj.
Pastaj kthehem dhe
e falënderoj (Allahun)
me këto
falënderime...”



10. shih. Tirmidhi, Menakib, 1/3615, Tefsir, 18; Ibn-i Maxhe, Zuhd, 37; Ahmed, I, 281, 295, III, 2, 144.

11. Shih. Ruhu'l-Bejan, V. 13, fq. 531.

12. shih. Nebe', 38; Fexhr, 22; Zumer, 75.



SHQYRTOJENI MIRË LAJMIN PARA SE TË JETË VONË

— H. Kybra Ergin —

Në shkencat e komunikimit ka një rregull: Qëllimi i palës që vepron duke iu shpërndarë njerëzve një të dhënë, në shumicën e rasteve është “t’i bindë” ata. Të bindësh do të thotë të influencosh te mendimi i palës tjetër. Çdo mesazh, qoftë për t’i bërë njerëzit të besojnë te diçka, qoftë për t’i hedhur ata në dyshime në lidhje me besimin e tyre apo qoftë me qëllim për t’ua forcuar besimin, synon ta kapërcejë tendencën e palës tjetër për ta refuzuar apo për të reaguar kundrejt orientimit të atij mendimi që shpreh mesazhi. Për këtë arsye, bëhen përpjekje serioze që mesazhi të ndikojë te mendja, ose t’i vendosë ndjenjat në lëvizje, ose të provokojë dëshirat themelore dhe frikën.

Përpjekjen e parë për ta bindur mendjen mund ta shohim kur njeriu i parë bëri gabimin i cili ishte shkaku që u nxor nga xheneti. Ndërkohë që Ademi dhe Havaja banonin të qetë në xhenet, Iblisi u bëri vesvese duke ua provokuar “dëshirën e qëndrimit të përhershëm në xhenet”. Në këtë mënyrë, arriti t’i mashtronte në lidhje me urdhrin e Allahut Teala. Nga kjo kuptohet qartë se njerëzit mund të mashtrohen sado të mëdhenj që mund të jenë.

Madje, sa më i mençur të jetë njeriu, aq më shumë rritet mundësia për ta bindur. Në një studim shkencor, një grupi ushtarësh u kishin dhënë për të ndjekur një film që tregonte shkakun e shpërthimit të luftës. Në studimin që u bë ndërmjet ushtarëve, u vu re se ushtarët që kishin zgjuarsin më të lartë u bindën edhe më shumë prej mendimit që shprehte filmi. Shkaku i kësaj është aftësia e lartë e njerëzve të zgjuar për të kushtuar vëmendje,

për t'u përpjekur të kuptojnë, për të menduar mbi argumentet që i drejtohen mendjes dhe për të dhënë të drejtë. Veçanërisht diçka që ndikon te mendja, ndërgjegjja dhe ndjenjat e pastra, që përputhet me të vërtetat e pranueshme, që nuk mbart ndonjë kundërtënie të qartë dhe që është koherente, i bind të mençurit. Edhe një urtësi e Kuranit Fisnik, i Cili vazhdimisht i thekson "të mençurit" në mesazhet e tij, kuptohet nga kjo që thamë më lart.

Domethënë se të bindesh si rezultat i asaj që dëgjon dhe pranon, në të vërtetë nuk është një mangësi. Ndërsa mundësia për të mashtruar, të gjithëve na ka futur në telashe të mëdha që nga koha kur nëna dhe babai ynë zbritën në sipërfaqen e tokës. Kjo na shpjegon qartazi se ndaj cilat mesazh duhet ta hapim apo ta mbyllim veten tonë.

Nga paraardhësit tanë transmetohet një lutje e tillë:

"O Zot! Udhëzoje nxitësin dhe të nxiturin!" (el-Amiri, el-Xhiddu'l-hasis) Dijetarët thotë se nxitësi këtu është zemra, ndërsa i nxituri janë të gjitha organet." Zemra e njeriut i është përngjasur bariut të gjymtyrëve.

Dijetarët e mistikës islame e kanë përngjasur zemrën me një hauz që mbushet me mesazhet të cilat i vijnë nga organet e shqisave me në krye sytë dhe veshët. Qëndrimin te dera e zemrës për të bërë rojë e kanë përshkruar si një virtyt të madh, sepse, kur në zemrën e njeriut shkon një mesazh që e hedh atë në fitne, ndikohet kontrolli i të gjitha organeve.

Fitneja është një gjendje e vështirë e cila i shkakton njeriut humbjen e gjykimit të shëndosh. Nganjëherë janë ndjenjat dhe dëshirat individuale që e hedhin njeriun në fitne si pasuria dhe fëmijët, por nganjëherë janë debatet intelektuale që shkaktojnë anarki shoqërore.

Kohë të tilla me anarki ka pasur edhe në epokën e lumturisë, domethënë, edhe në kohën kur i Dërguari i Allahut (s.a.s.), ka jetuar ndërmjet njerëzve. Kur njerëzit, të cilëve besimi akoma nuk u kishte hedhur rrënjë në zemrat e tyre, vazhduan të qëndronin me hipokritët, politeistët dhe çifutët, ngelën nën ndikimin e tyre. Allahu Teala na paralajmëron kështu në Kuranin Fisnik për njerëzit që familjarizohen edhe me besimtarët, edhe me jomyslimanët dhe hipokritët për shkak të frikës apo të interesave

personale të tyre:

"Ju do të hasni në njerëz të tjerë, të cilët dëshirojnë të sigurohen nga ju dhe nga kombi i vet. Sa herë që thirren në idhujtari, menjëherë bien në të. Nëse nuk shmangen prej jush, nëse nuk ju ofrojnë pagën dhe nëse nuk heqin dorë nga luftimi kundër jush, atëherë i kapni e i vrisni kudo që t'i gjeni! Kundër tyre ju kemi dhënë të drejtë të qartë." (Nisa, 91)

Ja pra, njerëzit e tillë që ngelin ndërmjet dy palëve, ua vështirësojnë punën besimtarëve kur të dalë ndonjë fitne / përçarje, ngaqë e pranojnë menjëherë atë. Për shembull, në Luftën e Uhudit një grup njerëzish prej treqind vetash të ushtrisë së myslimanëve, u ndanë nga ushtria për shkak të

këtyre mendimeve përçarëse dhe ua prishën moralin myslimanëve. Përveç këtyre, ka edhe shumë fitne të tjera që kanë ndodhur. Për këtë arsye, kur Allahu i Lartësuar i paralajmëron besimtarët kundrejt fitneve, së pari ua tërheq vëmendjen në lidhje me fjalët që duhet t'ua vënë veshin dhe t'i dëgjojnë:

"Ai jua ka shpallur në Libër: Kur të dëgjoni se mohohen fjalët e Allahut dhe bëhet tallje me to, atëherë mos rrinë me ata (njerëz që veprojnë kështu), derisa të ndërrojnë bisedë, përndryshe do të ishit si ata. Allahu do t'i tubojë në Xhehenem të gjithë hipokritët dhe mohuesit." (Nisa, 140)

Allahu Teala i ka urdhëruar besimtarët që të jenë tepër të kujdesshëm kur të zgjedhin miqtë dhe shokët e tyre duke thënë:

"Miq të dhe mbrojtësit tuaj janë vetëm Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët që falin namazin dhe japin zekatin, duke qenë të përlur (në adhurim) ndaj Allahut." (Maide, 55)

"Nuk gjen njerëz, që besojnë në Allahun dhe në Ditën e Fundit, që të ushqejnë dashuri ndaj atyre, të cilët kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e tij, edhe në qofshin ata etërit e tyre ose bijtë e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose faresti i tyre. Allahu ka skalitur besimin në zemrat e tyre dhe i ka fuqizuar ata me shpalljen e Vet. Ai do t'i shpjerë ata në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Allahu është i kënaqur me ata, por edhe ata do të jenë të kënaqur me Të. Ata janë Pala e Allahut dhe, vërtet që Pala e

Kur besimtari të dëgjojë ndonjë lajm, nuk duhet të gjykojë duke u nxituar dhe nuk duhet ta përhapë menjëherë atë, por përkundrazi, duhet të kërkojë për vërtetësinë e tij dhe të presë derisa njerëzit kompetentë dhe largpamës të umetit të gjykojnë, në mënyrë që të marrë masat e duhura.

Allahut do të jetë fituese.” (Muxhadile, 22)

Madje, këshillohet që edhe ndërmjet besimtarëve të zgjidhen ata të cilët i qëndrojnë besnikë besës që ia kanë dhënë Allahut Teala dhe ata të cilët kanë qëndrim të fortë prej besimtari:

“O ju që keni besuar! Frikësojuni Allahut dhe qëndroni me ata që janë të singertë (në fjalë dhe në vepra)!” (Teube, 119)

Me të vërtetë, kur e lexojmë me kujdes Kuranin Fisnik, shohim se na ka dhënë informacione shumë të rëndësishme rreth natyrës së njeriut dhe na ka udhëzuar në mënyrën më të shkëlqyer për të gjitha ngjarjet që do të ndodhin deri në kiamet. Për shembull, ky ajet fisnik i cili është burim udhëzimi për myslimanët në të gjithë shekujt, e vendos shumë bukur në pah qëndrimin që duhet të mbajë besimtari kundrejt dezinformimit në kohën e sotshme:

“O ju që keni besuar! Nëse ndonjë njeri i pandershëm ju sjell ndonjë lajm, sigurohuni mirë (në është i vërtetë), **për të mos i bërë dëm ndokujt pa dashje, e të pendoheni pastaj për atë që keni bërë.”** (Huxhurat, 6)

Me të vërtetë, në këtë kohë media dhe rrjetet sociale janë bashkuar me njëri-tjetrin dhe po nxjerrin në shoqëri përçarje të jashtëzakonshme. Teknologjia ka mundësuar llojet e ndryshme të prodhimit të thashethemeve e shpifjeve dhe ka hedhur në treg një larmi lajmesh me video, audio dhe mbështetje të jashtme. Çështja ndaj të cilës duhet të kemi më shumë kujdes në këtë kohë është moskaplimi i menjëhershëm ndaj një informacioni që nuk ia dimë fytyrën e brendshme të tij. Veçanërisht duhet të kemi kujdes të madh ndaj informacioneve që i shpërndajmë apo ua dërgojmë të tjerëve.

Allahu Teala na paralajmëron që të mos e marrim në konsideratë çdo gjë që e dëgjojmë dhe të mos kaplohem nga çdo rrymë që rastisim:

“Mos shko pas diçkaje për të cilën nuk ke dijeni. Vërtet, dëgjimi, shikimi dhe zemra, të gjithë këta do të merren në përgjegjësi.” (Isra, 36)

Njeriu shpesh herë nuk u jep rëndësi atyre që dëgjon dhe që flet. Fjalët i nxjerr lehtë nga goja, madje, i kopjon dhe i shpërndan me një klikim dhe këtë nuk e konsideron si vepër. Ndërkohë edhe fjala konsiderohet ndër veprat më të rëndësishme të njeriut:

“Për çdo fjalë që ai (njeriu) thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë).” (Kaf, 18)

Fitnet që përhapen në shoqëri nganjëherë janë aq të ngatërruara saqë nuk është aspak e lehtë ta ndash të vërtetën nga e pavërteta. Madje, ata që i përhapin

këto fitne, e konsiderojnë veten si shpëtimtarë që e bëjnë këtë për hir të interesave të përbashkëta të shoqërisë.

“Kur u thuhet: “Mos bëni çrregullime në tokë!” - ata thonë: “Ne bëjmë vetëm përmirësime në tokë!” (Bakara, 11)

Kjo vazhdon të jetë kështu që nga e kaluara. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) dhe sahabët nuk janë sprovuar me çështje të vogla dhe të zakonata si ne, por me luftëra dhe rrethime shumë të rrezikshme që mund t'i shfarosnin. Njerëzit e dobët nga aspekti i besimit në atë kohë, u bënë shkak për përhapjen e frikës dhe anarkisë duke i mbartur nga veshi në vesh thashethemet e përhapura. Allahu Teala përmes atyre e këshillon umetin dhe ia mëson se si duhet të veprojnë në situata të tilla:

“Kur atyre u vjen ndonjë lajm i rëndësishëm që ka të bëjë me sigurinë ose frikën, ata e përhapin (pa e vërtetuar mirë). **Por, në qoftë se këtë lajm do t'ia përcillnin** (për shqyrtim) **të Dërguarit dhe parisë, hulumtuesit do ta merrnin vesh prej tyre** (se çfarë lajmi duhet përhapur e çfarë jo). **Sikur të mos ishte mirësia e Allahut dhe mëshira e Tij, ju të gjithë do të ndiqnit djallin, përveç një numri të vogël.”** (Nisa, 83)

Domethënë se besimtari, kur të dëgjojë ndonjë lajm, nuk duhet të gjykojë duke u nxituar dhe nuk duhet ta përhapë menjëherë atë, por përkundrazi, duhet të kërkojë për vërtetësinë e tij dhe të presë derisa njerëzit kompetentë dhe largpamës të umetit të gjykojnë, në mënyrë që të marrë masat e duhura, sepse përhapjet e tilla me nxitim të lajmeve apo ngjarjeve i bëjnë besimtarët një shoqëri që lëkundet nga dezinformime të momentit dhe që i prishet lehtë bashkimi e uniteti.

Mesa duket jemi në një kohë në të cilën na kanë rrethuar fitnet / përçarjet për të cilat na ka paralajmëruar i Dërguari i Allahut (s.a.s.):

“Në kohën afër kiametit do të ketë përçarje si pjesët e netëve të errëta. Përgjatë këtyre fitneve njeriu zgjohet si besimtar dhe e arrin mbrëmjen si qafir, ose e arrin mbrëmjen si besimtar dhe zgjohet si qafir...” (Ebu Davud, Fiten, 2.)

I Dërguari i Allahut (s.a.s.), na paralajmëron që të mos veprojmë me nxitim në kohë të tilla me kaq shumë anarki. Gjithashtu na urdhëron t'i përmbahemi xhematit të myslimanëve, t'i largohemi anarkinë dhe ta lëmë shterpë fitnen duke e shpërfillur. (Buhari, Fiten, 11; Muslim, Imaret, 51.)

I Dërguari i Allahut (s.a.s.), thotë: **“Ibadeti në kohën e fitnes dhe anarkisë më duket si hixhret nga aspekti i sevapit.”** (Muslim, Fiten, 130; Tirmidhi, Fiten, 31; Ibn Maxhe, Fiten, 14; Musned, 525.)

Historia e larvës së fluturës

— Ferudun Ozdemir —

Një ditë, ndërsa po shëtiste në pyll, një burrë pa një larvë fluturë që po mendohej të zhvishte ekzoskeletin e saj. Ai e shikoi për orë të tëra teksa ajo përpiquej të dilte nga ajo mbështjellë e hollë. Atëherë burri mendoi se larva nuk kishte më fuqi dhe ishte dorëzuar. U mundua të çante mbështjellën për ta ndihmuar atë të dilte pa u munduar.

Kështu larva arriti të dilte lehtësisht nga mbështjella, por ajo nuk ishte gati të largohej, trupi i saj ishte ende i thatë dhe krahët e saj të rrudhur. Burri mendoi se fluturë do të mblidhte fuqitë e saj, do t'i hapte krahët dhe do të fluturonte, por ajo kishte dalë para kohe nga foleja. Pavarësisht sa shumë u përpoq, ajo nuk arriti të fluturonte dhe vazhdoi të zvarritej në tokë me krahët e saj të rrudhur.

Burri ishte munduar ta ndihmonte me një qëllim të mirë, por nuk e kishte kuptuar që ndërsa fluturë luftonte për të dalë nga mbështjella, një lëng i përhapur nga trupi ishte vendimtar për të fuqizuar krahët e saj të dobët. Kështu ai, në vend që ta ndihmonte atë, kishte penguar një proces tejet të natyrshëm të metamorfozës...

Teksa jeta rrjedh natyrshëm, përpjekjet, mundimet, këmbënguljet nuk janë gjë tjetër veçse një përgatitje për të hedhur një hap tjetër në jetën tonë dhe për të siguruar fuqinë e nevojshme për të ecur përpara. Nëse dëshironi të fluturoni me krahët tuaj, duhet të përpiqeni fort që me forcën tuaj të mposhtni vështirësitë e jetës. Nëse i përmbushni të gjitha dëshirat e fëmijës suaj dhe nuk lejoni që ai të përballet me sfidat e jetës, do ta pengoni që të fluturojë me krahët e tij atëherë kur ai të ketë vertetë nevojë.

Përktheu dhe përshtati: Elona SYTARI



ISLAMI ËSHTË

dashuri, paqe dhe qetësi



— Dr. Halis Demirxhan —

Në periudhën e injorancës shihet se padrejtësia kishte arritur kulmin. Gjithashtu vihet re se këto sulme dhe dhunime u janë bërë edhe ithtarëve të parë të fesë islame.

Edhe pse ishin ballë për ballë me këto padrejtësi, Allahu Teala i urdhëroi besimtarët:

“O ju që keni besuar! Bëhuni të durueshëm dhe nxiteni njëri-tjetrin të jeni të tillë; bëhuni të vendosur dhe vigilentë (në vepra të mira dhe në ruajtjen e kufijve) ***dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që të shpëtoni!***” (Al Imran, 200) Gjithashtu na bën edhe këtë paralajmërim:

“Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë.” (Fussilet, 34)

Në të vërtetë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), lëreni derdhjen e gjakut të myslimanit, por e shikonte të

papranueshme edhe vrasjen e grave, fëmijëve dhe të moshuarve jomyslimanë që nuk luftonin kundër myslimanëve, vrasjen e klerikëve që preokupoheshin me ibadetet e tyre, madje nuk pranonte që të shkatërroheshin faltoret, të priteshin pemët dhe të vriteshin kafshët edhe në kohë lufte.

Krahas gjithë kësaj tolerance, i Dërguari i Allahut, (a.s.), bënte paralajmërim, sikur po njoftonte për ngjarjet që do të ndodhnin në të ardhmen, duke treguar padrejtësitë e kohës së injorancës:

“O njerëz! Jeta juaj, pasuria juaj dhe nderi juaj janë të shenjtë dhe të mbrojtur nga çdo lloj sulmi siç janë të shenjta këto ditët tuaja, muajt tuaj dhe qyteti juaj.”

Shokët e mi! Nesër do të dilni në audiencën e Zotit tuaj dhe do të pyeteni për gjendjen dhe veprat tuaja të sotshme. Kini kujdes dhe mos e vrisni



njëri-tjetrit pas meje duke u kthyer në devijimet e kaluara.” (Shpjegimi i Sahihu’l-Buhari, Përkthimi i Tedrixhu’s-Sarih, vëll. X, nr: 396.)

Në ditët e sotshme, në të gjithë botën dhe veçanërisht në vendet islame që ndodhen në lindjen e mesme, po përjetohen luftëra që të kujtojnë periudhën e injorancës në të cilën përdorej dhuna, imponimi dhe shkelja e të drejtave të njeriut. Të moshuarit, gratë dhe fëmijët që janë viktimë të këtyre luftërave, po nxirren nga vendet e tyre dhe po detyrohen të emigrojnë.

Sa shumë të bën të mendosh ky ajet fisnik i cili sikur është zbritur për ta shpjeguar këtë gjendje:

“Mirëpo ja tek jeni, duke vrarë farefisn tuaj, duke i dëbuar disa syresh nga shtëpitë e veta dhe duke ndihmuar njëri-tjetrit kundër tyre, fajësisht dhe armiqësisht. Dhe, kur ju vijnë të robëruar, ju

i shpëtoni nga robëria me të holla, ndërkohë që me marrëveshje e keni të ndaluar t’i dëboni. Mos vallë, një pjesë të Librit (Teuratit) e besoni, kurse pjesën tjetër e mohoni?! Cilido prej jush që vepron kështu, do të ndëshkohet me poshtërim në këtë jetë, ndërsa në Ditën e Kiametit do të dërgohet në dënimin më të ashpër. Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj veprimeve tuaja.” (Bakara, 85)

Për këtë arsye, terrori dhe dhuna, sido që të quhen, nuk kanë asnjë lidhje të afërt apo të largët me Islamin. Andaj, t’ia veshësh Islamit këto veprime barbare është krejtësisht e pamundur.

Përkundrazi, feja jonë shprehet se të gjithë besimtarët janë vëllezër dhe ua ka ndaluar atyre në formë të prerë çdo lloj anarkie, prishjeje, shkatërrimi, dhunimi apo torture, shkurtimisht çdo lloj terrori dhe tiranie siç thuhet edhe në ajetin fisnik: ***“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni.”*** (Huxhurat, 10) Gjithashtu, feja islame e konsideron vrasjen e një njeriu si vrasjen e të gjithë njerëzimit. Në të njëjtën mënyrë, edhe shpëtimin e një jete e pranon si shpëtimin e të gjithë njerëzimit.

Me një shprehje tjetër, feja islame dhe morali i Kuranit nuk janë mbështetës të terrorizmit dhe të terroristëve, por janë zgjidhja e vetme që mund ta shpëtojë tokën nga fatkeqësia e terrorizmit.

Së fundi, nëse sot ka veprime dhe mendime si dhuna, imponimi dhe shkelje e të drejtave të njeriut në shoqërinë islame, këta nuk janë gabimi dhe mangësia e Islamit, por të myslimanëve.

Ndërsa mënyra më e favorshme për të shpëtuar nga ky gabim është marrja për referencë e fetarëve të ndërgjegjshëm dhe e literaturave të sakta fetare.

Në të kundërt, do të shkaktohet një situatë që e mërzit shumë të Dërguarin e Allahut (a.s.).

Pejgamberi thotë:

“Besimtarët janë si një trup i vetëm në dhembshuri ndaj njëri-tjetrit, në dashuri ndaj njëri-tjetrit dhe në mëshirë ndaj njëri-tjetrit. Kur ndonjë organ i këtij trupi të ndjejë dhimbje, edhe organeve të tjera u ikën gjumi dhe e ndjejnë fort të njëjtën dhimbje.” (Buhari, Edeb, 27; Muslim, Birr, 66.)

Lus Allahun e Lartësuar që të gjithë besimtarët të bëhen si një trup duke ndjerë dhembshuri për njëri-tjetrit, duke e dashur njëri-tjetrit dhe duke e mëshiruar njëri-tjetrit!

LUFTA

midis udhëzimit

dhe injorancës

— M. Ali Eshmeli —

Historia përsëritet. Lufta ndërmjet injorancës dhe udhëzimit vazhdon. Udhëzimi po përpëlitet që në çdo mundësi t'i japë njerëzimit drejtësinë, mëshirën, dhembshurinë dhe qetësinë në të dyja botët. Ndërsa injoranca kurdo që i jepet mundësia e zvarrit njerëzimin në padrejtësi, armiqësi, errësirë, fatkeqësi dhe humbje në të dyja botët.

Përgjatë gjithë rrjedhës së historisë, kjo luftë ka qenë prezente. Nga njëra anë tiranët e pacipë, të

pamëshirshëm dhe të pandërgjegjshëm, nga ana tjetër të pafajshëm të dobët e të mjerë, të dhunuar, viktima dhe klithma. Sigurisht se në fund të këtyre ka sunduar shfaqja e drejtësisë hyjnore. Historia e njerëzimit nga njëri aspekt është historia e sprovës së njeriut. Pyetjet janë të qarta, përgjigjet janë të qarta. Edhe pse situata është kjo, pasuesit e injorancës gjithmonë janë të hutuar. Ata jetojnë me mashtrimet, gënjeshttrat, gabimet, poshtërsitë, mosbindjet, tragjeditë, zullumet dhe fatkeqësitë. Për këtë arsye, bota e tyre është e huaj ndaj udhëzimit.

Edhe nëse mposhten nga e vërteta, largpamësia e tyre nuk mjafton për t'ju drejtuar asaj. Prandaj gjithmonë zgjedhin padrejtësinë. Veçanërisht, nëse kanë në dorë edhe fuqinë, faqet e historisë së sprovës së tyre mbushen me humbjet shpirtërore më të mëdha. Për këtë arsye, progresi i hekurit prandaj u pandeh si marifeti i vetëm në këtë botë që po globalizohet. Përparimi në shkallë të lartë i objekteve prandaj u konsiderua si peshorja e vlerave të njerëzimit. Zhvillimet materiale që u quajtën teknikë, prandaj u konsideruan si më të vërtetshme, më të vlefshme dhe më të dobishme se shpirti dhe zemra e njeriut. Përveç të tjerash, këto na u quajtën edhe civilizim. Fjalori



i inorancës e duartrokiti këtë. Madje, e mbështeti, e inkurajoi dhe e bëri kurorë në kokë. Por nëse i shohim nga dritarja e udhëzimit ngjarjet e përjetuara dhe gjendjet në të cilat ka arritur njerëzimi, tabloja e quajtur civilizim që është vendosur para njerëzve gjithmonë ka qenë një barbarizëm, tmerr dhe brutalitet. Rezultatet tragjike që po i shohim me dhimbje në botën islame që prej dy shekujsh, për këtë arsye po ndodhin. Ato që ndodhën dje në Bosnje, për këtë arsye ndodhën. Po ashtu, për këtë arsye po ndodhin edhe ato që po përjetohej akoma në Palestinë, Afganistan dhe në Irak. Poshtërsitë, vrasjet dhe barbarizmat që po përjetohej në Siri, për këtë arsye po ndodhin. Edhe padrejtësitë që ta bëjnë zemrën copë e çikë, të cilat po përjetohej në Egjipt, prandaj po ndodhin.

Të gjitha këto po ndodhin ngaqë civilizimi i inorancës është larg udhëzimit, larg mëshirës, larg butësisë dhe larg ndërgjegjes. Përfundimisht, larg humanizmit.

Civilizimi i inorancës e ka flijuar shpirtin e njeriut për objektet. Edhe mendjen e ka ngrirë në ngjyrën e ftohtë të hekurit. Ndërsa zemrën e ka bërë një qendër ndjesie të thatë robotike që merr kënaqësi nga zjarri i bombave. Sepse ai është një civilizim që ushqehet vetëm nga zullumi. Për këtë arsye, çdo zgjidhje që ky civilizim mund t'ua japë të dhunuarve është vetëm një ndihmë e ambalazhuar që duket si e tillë, por në të vërtetë është një formë e re dhune. Për këtë arsye, në ditët e sotme në të gjithë botën po përjetohej një periudhë e dytë e inorancës. Për hir të kënaqësisë së zullumqarëve, po bombardohet natyrshmëria e njerëzimit. Klima shpirtërore po shkatërrohet te të gjithë duke filluar nga të vegjlit e deri te të moshuarit. Përshtirja te njerëzimi po tronditet, po dërmohet, po shkelet, po copëtohet dhe po prishet me dorën që adhuron materien helmuese.

Dje njeriu ishte robi primitiv i njeriut. Edhe sot njeriu është rob i njeriut. Por për shkak se çështjet shtjellohen nga aspekti modern, çdo gjë tregohet sikur të ishte mjaft normale. Në të vërtetë, ndërmjet periudhës së inorancës para 1400 vjetësh dhe periudhës së sotme nuk ka asnjë ndryshim nga aspekti i natyrës së tyre. Ndryshim ka vetëm te gardëroba. Periudha e inorancës e kishte primitiv botëkuptimin e robërisë, ndërsa periudha e sotme e ka modern. Çfarë ndryshimi ka ndërmjet këtyre të dyjave? A nuk janë të dyja periudha robërie? Mbi të gjitha, robëria moderne, ngaqë është e pajisur me më shumë dije dhe mundësi padrejtësie, është shumë herë më zullumqare dhe më e egër se robëria primitive. Për fat të keq, shpesh herë atë e quajnë liri!

Krahas kësaj, bukuria e këtij emri është e përsosur vetëm në sektorin e vitrinës së sistemeve të ndryshme ideologjike dhe modeleve të udhëheqjes gjoja humane. Kur kalojmë në pjesën e kuzhinës, veshët mund të shpërthejnë prej klithmave të jehonshme dhe të heshtura. Krimet, tragjeditë dhe vrasjet masive po e tmerrojnë shpirtin e njerëzimit. Barbarizmat po i copëtojnë zemrat, sepse në sektorin e kuzhinës civilizimi i inorancës heq dorë nga çdo lloj virtyti. Ai heq dorë nga çdo gjë që ua servir njerëzve duke i joshur dhe vepron vetëm sipas urdhrit të virusit që ka përbrenda tij. Veçanërisht nëse bëhet fjalë për ndonjë pozitë që përfitojnë myslimanët, atëherë ai heq dorë edhe nga demokracia që gjoja është përpjekur ta injektojë. Gjithashtu heq dorë edhe nga të drejtat e njeriut, të drejtat e fëmijëve dhe pëshpëritjet e civilizimit. Domethënë, nuk lë virtyt pa hequr dorë prej tij, nuk lë moral pa hequr dorë prej tij, nuk lë të vërtetë dhe humanizëm pa hequr dorë prej tyre.

Ja, për këtë arsye, rrugëzgjidhja e vetme e njerëzimit është vetëm civilizimi i udhëzimit. Domethënë, një civilizim i mëshirës që e ka edhe thelbin, edhe fjalën, edhe fytyrën të qeshur dhe si ilaç. Pra, civilizimi i butësisë. Civilizimi i një ndërgjegjeje të vërtetë. Apo me një shprehje tjetër më të plotë, civilizimi Islam. Civilizimi i virtyteve që është përjetuar në epokën e lumturisë (kohën e Pejgamberit) në formën më të përsosur dhe madhështore të tij.

Ky civilizim është dermani, shpëtimi dhe receta e vetme e lumturisë për njerëzimin. Ja pra, kjo botë gjithmonë ka nevojë për këtë civilizim. Rrugëzgjidhja e vetme për të marrë frymë Egjipti, Siria, Iraku, Palestina dhe të gjitha vendet e tjera islame është civilizimi i udhëzimit. Rrugëzgjidhjet hipokrite në vitrinën e civilizimit të inorancës që e ka kuzhinën të mbushur plot me tmerr, kurrë nuk mund të jenë ilaç për zgjidhjen e problemeve, sepse këto hipokrizi janë si sjelljet false të kasapit që e ledhaton delen që do të therë.

Nisur nga një aspekt, ato janë një lloj tjetër i padrejtësisë. Apo më saktë, janë një kurth padrejtësie e zbukuruar me stoli që e joshin syrin. Hidhuni një sy këtyre kurtheve dhe mendoni: Në çfarë gjendjeje është njerëzimi? Në çfarë gjendjeje është ndërgjegjja? Në çfarë gjendjeje janë fëmijët e vegjël? Në çfarë gjendjeje janë nënat? Në çfarë gjendjeje janë ndërtesat, bibliotekat, faltoret, shtëpitë dhe rrugët? Në çfarë gjendjeje janë kafshët dhe insektet? Në çfarë gjendjeje janë sytë? Në çfarë gjendjeje janë buzëqeshjet? I gjithë marifeti i civilizimit të inorancës në çdo vend të botës është vetëm lamtumirë humanizmit dhe vetëm padrejtësi. Edhe zgjidhjet



“Një pjesë e atyre që më duan më së shumti prej umetit tim, do të dalë ndërmjet atyre që do të vijnë pas meje. Ata i flijojnë me gjithë dëshirë pasuritë dhe familjet e tyre për të më parë mua.”

(Muslim, Xhenet, 12; Hakim, IV, 95/6991.)

Nëse do të kërkojnë ndihmë, do t’u jepet një ujë si xehja e shkri-rë, që do t’ua përcëllojë fytyrat. Sa pije e tmerrshme është ajo e sa strehim i keq është ai (zjarri)!” (Kehf, 29)

E gjithë çështja është që t’i perceptojmë dhe t’i shikojmë ato ditë që në ditët e sotme. Pra, të jemi të vetëdijshëm për atë që na pret në përjetësi. Përndryshe njeriu edhe zullumin më të madh mund ta shikojë si një civilizim dhe e drejtë e tij personale. Njeriu mashtrohet nga gjelbërimi rreth e rrotull Xhehenemit duke e konsideruar atë si mirësi. Ndërsa vështirësitë rreth e rrotull Xhenetit i pandeh ndëshkim. Në këtë mënyrë, zva-

rritet krejt pa vetëdije drejt injorancës. Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik:

“Atë Ditë keqbërësi do të hajë gishtat e duarve të veta, duke thënë: “Ah, sikur ta kisha marrë rrugën (e drejtë) me të Dërguarin! Ah, sikur të mos e kisha bërë filanin mik! Ai më ka larguar nga Këshilla (Kurani) që më kishte ardhur!” Në të vërtetë, djalli e braktis gjithmonë njeriun në çastin e nevojës.” (Furkan, 27-29)

“A e ke parë ti (o i Dërguar) atë që epshin e vet e ka marrë për zot? A do t’i bëhesh mbrojtës atij? A mendon ti se shumica e tyre dëgjojnë dhe kup-tojnë? Ata nuk janë tjetër, veçse si bagëti. Madje, ata janë edhe më të shmangur nga rruga e drejtë.” (Furkan, 43-44)

Nisur nga këto ajete, gjendja në të cilën bien ata që i binden nefsit dhe zhyten në padrejtësi është shumë e qartë. Gjithashtu, edhe ato që bëjnë ata janë krejt të qarta. Por asnjëherë nuk duhet të harrohet se të dhunuarve dhe të pafajshmëve u del për zot vetë Allahu i Lartësuar. Për një kohë të shkurtër ndoshta mund të përjetohen sprova të dhimbshme. Vullneti hyjnorë në këtë çështje është i mbushur me një miqësi e një urtësi. Por për një kohë afatgjatë, domethënë, në fund çdo e vërtetë gjithmonë del në pah sipas vullnetit dhe sundimit të Zotit (xh.xh.). Rezultati përfundimtar gjithmonë është poshtërim për zullumqarin dhe mëshirë për të dhunuarin. Allahu Teala e shpreh këtë të vërtetë me këto fjalë në ajetet fisnike, në mënyrë që të vetëdijesohen të gjithë të dhunuarit, të dobët dhe të vobektët. Gjithashtu, në mënyrë që të pendohen dhe të pastrohen edhe zullumqarët:

“Mos mendo kurrësi që Allahu nuk e vëren atë

që i parashtrojnë, nuk janë gjë tjetër përveç një lloj padrejtësie tjetër. Sepse civilizimi i injorancës gjithmonë është i pasionuar dhe i dashuruar pas padrejtësisë. Nëse kjo padrejtësi bie në sy, bën ndryshim të ambalazhit dhe përsëri mban anën e padrejtësisë.

Ngaqë gjendja është e tillë, edhe njerëzit e civilizuar të injorancës jetojnë në të njëjtën mani, shkujdesje dhe injorancë. Në të njëjtin kurth, ka edhe prej myslimanëve që kanë rënë, për fat të keq. Ndërkohë paralajmërimi i Allahut të Madhëruar është shumë i qartë dhe kuptimplotë:

“A mos kërkojnë ata gjykimin (me ligjin) e (kohës së) injorancës (paganizmit paraislamik)?! E kush është gjykatës më i mirë se Allahu për njerëzit që besojnë bindshëm? O besimtarë! Mos i bëni miq e mbrojtës hebrenjtë dhe të krishterët! Ata janë mbrojtës të njëri-tjetrit. Kushdo prej jush që i bën ata miq, është me ata. Vërtet, Allahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë keqbërësit. Ti i sheh ata me zemra të sëmura, sesi vrapojnë për t’u lidhur me ata (hebrejtë) duke thënë: “Druajmë se mos po na godet ndonjë fatkeqësi”. Mbase Allahu do të sjellë fitore ose diçka tjetër nga ana e Tij, kështu që ata do të pendohen për atë që kanë fshehur në veten e tyre.” (Maide, 50-52)

Për këtë arsye, Allahu Teala i shpreh në shumë vende të Kuranit Fisnik gjendjet e dhimbshme të zullumqarëve, në mënyrë që njeriu të bëhet pishman në kohën e duhur dhe të shpëtojë nga ndëshkimi i përhershëm: **“...E vërteta është nga Zoti juaj. Kush të dojë, le të besojë e kush të dojë, le të mohojë”** Ne kemi përgatitur për mohuesit keqbërës një zjarr, që do t’i rrethojë nga të gjitha anët (si çadra).

që bëjnë keqbërësit! Ai vetëm ua shtyn (dënimin) deri në Ditën, kur sytë e tyre do të zgurdullohen (nga tmerret që do të shohin), dhe, duke vrapuar me kokë lart, nuk do të mund t'i lëvizin sytë, ndërsa zemrat e tyre do të jenë të zbrazëta (nga tmerri)." (Ibrahim, 42-43)

"...Prandaj shiko si kanë përfunduar keqbërësit!" (Junus, 39)

"Popullin e Nuhut, kur i quajti gënjeshtarë të dërguarit, Ne e fundosëm dhe e bëmë mësim për njerëzit. Për keqbërësit kemi përgatitur një dënim të dhembshëm. Ne i dënuam fiset Ad dhe Themud, popullin e Ras-sit, si dhe shumë popuj të tjerë ndërmjet tyre. Të gjithëve u sollëm shembuj dhe, më pas, të gjithë i shkatërruam krejtësisht. Ata me kohë kanë kaluar pranë vendbanimit që e shkatërroi shiu i tmerrshëm, e vallë, a nuk e kanë parë atë? Jo, ata nuk prisnin të ringjalleshin." (Furkan, 37-40)

"Ne të kemi shpallur Librin, i cili është përkujtesë për ju. Vallë, a nuk po kuptoni? Sa e sa vendbanime, banorët e të cilëve kanë qenë mohues, i kemi shkatërruar; e pas tyre kemi ngritur popuj të tjerë! Kur e ndienin dënimin Tonë, ata iknin me të shpejtë. Mos ikni! Kthehuni atje, në luksin tuaj dhe në pallatet tuaja, se ju do të pyeteni." Ata do të thonë: "Mjerë ne, me të vërtetë, kemi qenë keqbërës!" Këto rënkime të tyre nuk pushuan, derisa Ne i palosëm si drithë i korrur." (Enbija, 10-15)

"Eh, sikur t'i shihje keqbërësit duke dalë para Zotit të tyre dhe duke shkëmbyer akuza me njëri-tjetrin." (Sebe', 31)

"...Ne do t'u themi keqbërësve: "Shijoni dënimin e zjarrit të cilin e keni mohuar!" (Sebe', 42)

Që nga njeriu i parë e deri më sot, përgjatë gjithë historisë njerëzit e tillë janë ndëshkuar. Allahu Teala thotë: *"Prandaj ata i goditi dënimi i të këqijave që kishin punuar. Por, edhe keqbërësve prej këtyre do t'u bjerë dënimi për të këqijat, që kanë bërë e nuk do të mund t'i ikin atij."* (Zumer, 51)

"Atë Ditë ti do t'i shohësh keqbërësit se si tmerrrohen për atë që kanë fituar, ndërkohë që ndëshkimi Ynë do t'i godasë me siguri..." (Shura, 22)

"Për atë që Allahu e shpie në humbje, nuk ka mbrojtës tjetër përveç Tij. Ti do të shohësh se si keqbërësit, kur ta shohin dënimin, do të thonë: "A ka ndonjë rrugë për t'u kthyer?" Ti do t'i shohësh se si do të përballen me zjarrin të përulur nga poshtërimi dhe duke parë tinëzisht me bisht të syrit. Ata që kanë besuar do të thonë: "Me të vërtetë që humbësit janë ata që kanë humbur

vetveten dhe familjen e tyre në Ditën e Kiametit". Me të vërtetë, keqbërësit do të vuajnë një dënim të përhershëm!" (Shura, 44-45)

Allahu Teala i drejtohet Pejgamberit (a.s.), në mënyrë që njerëzit ta kuptojnë sa më mirë ndëshkimin e përhershëm që do të marrin zullumqarët dhe të qëndrojnë larg çdo lloj padrejtësie, duke i thënë:

"Paralajmëroji ata për Ditën e afërt të Gjykimit, kur zemrat do t'u vijnë deri në fyt prej pikëllimit. Për njerëzit e këqij nuk ka asnjë mik të afërt dhe as ndërmjetësues të pranueshëm." (Gafir, 18)

"Atë Ditë, keqbërësve nuk do t'u bëjë dobi shfaqësimi i tyre. Ata i pret mallkimi dhe një vendbanim i shëmtuar." (Gafir, 52)

I padrejti nuk do të ndëshkohet vetëm në Ahiret. Edhe në këtë botë janë përjetuar shumë shfaqje të hakmarrjes hyjnore. Allahu i Lartësuar na e kujton se kjo gjë është shumë e lehtë për fuqinë e Tij duke u shprehur si më poshtë:

"...Ne nuk i dërguam kurrfarë ushtrie nga qielli (si dënim) popullit të tij dhe as që kishte nevojë për të dërguar. (Mjaftoi për t'i dënuar ata) vetëm një zë i tmerrshëm, pas të cilit u shuan përnjëherësh." (Jasin, 28-29) Kjo e vërtetë i shpreh në formën më të qartë pasojat që do të kenë të gjitha padrejtësitë dhe ligësitë. Pas të gjitha këtyre, thuhet: "O Zullumqarë! Shikoni, ku është Faraoni? Ku është Nemrudi? Ku është Hulagu? Ku është Ebu Xhehli?

A nuk na bën Allahu Teala ta pohojmë këtë të vërtetë edhe me këtë ajet fisnik që na është mësuar në formën e lutjes: *"O Zoti Ynë, cilindo që Ti e fut në zjarr, Ti e ke poshtëruar atë. Dhe për mohuesit nuk do të ketë kurrfarë ndihmuesi."* (Al Imran, 192) Për këtë arsye, gjëja që na takon të bëjmë është të vepruarit me drejtësi, me mëshirë dhe butësi. Të kapurit pas civilizimit të udhëzimit. Të qëndruarit përballë zullumqarit dhe të ndihmuarit e të dhunuarve. Të qëndruarit përballë barbarëve dhe të mbrojturit e të pafajshmëve. Përndryshe, edhe ky paralajmërim hyjnor është shumë i qartë:

"Për dëshmitarin dhe për atë që dëshmohet! Mallkuar qofshin njerëzit e Hendekut, zjarrit (të ushqyer) me lëndë djegëse, kur rrinin ulur rreth tij duke dëshmuar atë që po i bënin besimtarëve!" (Buruxh, 3-7)

Në hadithet fisnike thuhet: *"Nëse njerëzit i shohin të këqijat dhe nuk përpigën t'i ndryshojnë, pa kaluar shumë Allahu Teala u çon një fatkeqësi të përgjithshme."* (Ibn Maxhe, Fiten, 20.)

"Betohem në Allahun, i Cili, me fuqinë e Tij, e ka në dorë jetën time, nëse nuk do të urdhëroni të mirën dhe nuk do të ndaloni nga e keqja, Allahu

do t'ju dërgojë në një kohë të afërt një ndëshkim për ju. Pastaj do t'i përgjëroheni dhe do t'i luteni Allahut, por lutja juaj nuk do të pranohet.” (Tirmidhi, Fiten, 9/2169.)

“Allahu Teala nuk i ndëshkon të pafajshmit për shkak të mëkateve që bëjnë njerëzit në përgjithësi, përveç nëse e shohin kryerjen e mëkatit dhe nuk e ndalojnë edhe pse kanë mundësi.” (Ahmed, V, 192.)

Detyra që na takon ne si umeti i Muhamedit (a.s.), është që të bëhemi si një shi i begatshëm në çdo periudhë, në çdo çështje dhe në çdo mjedis. Ne duhet ta gjallërojmë njerëzimin me shirat e udhëzimit, mëshirës, drejtësisë dhe butësisë. Ne duhet ta pastrojmë nga fytyra e njeriut bal-tën e padrejtësisë me ujë të pastër. Ne duhet t'u japim ujë zemzemi apo keutheri dhe plot ndihma të tjera të dhunuarve të etur. Vetëm atëherë do ta arrijmë mirësinë në kuptimin që na ka lavdëruar i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të. Çfarë ka thënë Pejgamberi ynë i nderuar:

“Umeti im i përngjan një shiu (të begatshëm). Atij nuk i dihet nëse është më i mirë në fillim apo në fund.” (Tirmidhi, Edeb, 81.)

Ata që ishin në fillim, e morën sihariqin e tyre: U bënë sahabë të të Dërguarit të Allahut (a.s.). Ndërsa sihariqi për të mirët në fund, domethënë, për të mirët në këtë kohë të fundit është vëllazëria me të Dërguarin e Allahut (a.s.). Ebu Hurejra (r.a.), transmeton se një ditë i Dërguari i Allahut, (a.s.), shkoi te varrezat bashkë me sahabët dhe tha:

“Paqja e Allahut qoftë mbi ju, o banorët e vendeve të besimtarëve! Inshallah një ditë edhe ne do të vijmë te ju. Do desha shumë t'i shikoja vëllezërit e mi. Sa më ka marrë malli për ata!” Sahabët e nderuar i thanë: “A nuk jemi ne vëllezërit e tu, o i Dërguari i Allahut?” Pejgamberi ynë i nderuar (a.s.), ua ktheu: “Ju jeni sahabët e mi. Ndërsa vëllezërit e mi janë ata që nuk kanë ardhur akoma.” Nisur nga këto fjalë, sahabët i thanë: “Si do t'i njohësh ata që nuk kanë ardhur akoma prej umetit tënd, o i Dërguari i Allahut?” Pejgamberi, (a.s.), i pyeti:

“Mendoni një burrë që ka një kalë me këmbë dhe

ballë të bardhë. A nuk mund ta gjej ky burrë kalin e tij në një kope kuajsh të gjithë të zinj?” Sahabët iu përgjigjën: “Po, e gjen, o i Dërguari i Allahut!” Pastaj, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha: “Ja, edhe ata do të vijnë me fytyra, duar dhe këmbë të ndritura për shkak të abdestit. Unë do të shkoj para dhe do t'i pres ata në krye të burimit tim për t'i nderuar. Kini kujdes! Disa njerëz do të dëbohen nga burimi im siç dëbohet dhe largohet deveja e huaj nga kopeja. Unë do t'u thërras: ‘Ejani këtu!’ Por pastaj do të më thuhet: ‘Ata e kanë ndryshuar gjendjen e tyre pas teje (nuk e kanë ndjekur Sunetin tënd dhe kanë devijuar në rrugë të tjera. Prandaj kanë bërë mëkate të mëdha).’ Për shkak të kësaj, unë do të them: ‘Le të dëbohen, le të dëbohen!’” (Muslim, Taharet, 39.)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), e deklaroi kështu në hadithin fisnik se të dashurit e tij do të vazhdojnë të ekzistojnë deri në Kiamet:

“Një pjesë e atyre që më duan më së shumti prej umetit tim, do të dalë ndërmjet atyre që do të vijnë pas meje. Ata i flijojnë me gjithë dëshirë pasuritë dhe familjet e tyre për të më parë mua.” (Muslim, Xhenet, 12; Hakim, IV, 95/6991.)

Përderisa zemrat të jetojnë nën dritën e këtyre rregullave, do ta meritojnë ndihmën hyjnore. Së fundi do të shfaqet kjo e vërtetë:

Fuqia hyjnore një ditë do t'i bëjë zullumqarët të thonë:


“Tall-llahi lekad aserakall-llahu aleja...”

“...Betohemi për Allahun, vërtet që Allahu të ka ngritur ty mbi ne...” (Jusuf, 91)

Esenca e të gjitha kushteve për këtë epërsi dhe fitore është shndërrimi i lamtumirës ndaj hu-

manizmit në shërbim ndaj tij. Shndërrimi i lamtumirës ndaj mëshirës dhe butësisë në një shërbim madhështor. Shndërrimi i lamtumirës ndaj ndërgjegjes dhe moralit në një shërbim fisnik. Shndërrimi i lamtumirës ndaj besimit dhe Islamit në një shërbim të bekuar. Apo me një shprehje tjetër, ne duhet t'i japim lamtumirën civilizimit të injorancës dhe t'i shërbejmë civilizimit të udhëzimit. Atëherë, edhe gjembat më të mprehtë të padrejtësisë do të shndërrohen në trëndafila të Xhenetit...

Zoti na e mundësoftë këtë! Amin!..



**Esenca
e të gjitha kushteve
për këtë epërsi dhe
fitore është shndërrimi
i lamtumirës ndaj
humanizmit në
shërbim ndaj
tij. Shndërrimi i
lamtumirës ndaj
mëshirës dhe
butësisë në një
shërbim madhështor.
Shndërrimi i
lamtumirës ndaj
ndërgjegjes dhe
moralit në një
shërbim fisnik.**

Gjëja që e kapi majmunin...



Në disa vende të botës përdoreshin kurthe të tilla për të kapur majmunë: Merrej arra e kokosit, i hiqej ajo që kishte brenda dhe lidhej në pemë me një litar.

Në pjesën e poshtme të arrës së kokosit bëhej një plasë e hollë. Nëpërmjet asaj plase futej ushqim i ëmbël brenda. Kjo plasë ishte aq e madhe sa që majmuni mund ta fuste dorën kur e kishte të hapur. Ndërsa kur e bënte dorën grusht, e kishte të pamundur ta nxirrte prej aty.

Në këtë mënyrë, majmuni e merrte ushqimin që gjendej brenda në arrën e kokosit dhe kur vinin gjuetarët përpiquej e përpëlitej për ta nxjerrë dorën, por prapë se prapë nuk e nxirrte dot. Si rrjedhojë, nuk mund të ikte. Por nëse do ta hapte dorën dhe ta linte ushqimin, mund të ikte dhe të shpëtonte!

Mesazhi që marrim nga ky tregim është: Gjëja që e kapi majmunin ishte vetëm pangopësia e tij. Gjëja që na hedh edhe neve në kurth, në të vërtetë është lidhja me pasion ndaj dëshirave dhe prirjeve tona.

Pra, përpjekja jonë për t'i arritur ato apo për t'i mbajtur krahas çdo gjëje që mund të ndodhë.

NJË LUTJE

"Zoti ynë! Ne besojmë atë që na ke shpallur dhe pasojmë të Dërguarin. Na shkruaj pra, bashkë me dëshmitarët!"

(Al Imran, 53.)

NJË THËNIE

"Shpesh herë ka më pak rrezik në gjërat prej të cilave frikësohemi sesa në gjërat që i duam."

(John C. Collins)

Vlera E XHUMASË

— Ferit Piku —

Zoti ynë thotë në Kuranin famëlartë: **“O ju që keni besuar, kur të thirret ezani i ditës së xhuma, nxitoni atje ku përmendet emri i Zotit, lëreni shitblerjen, se kjo është më mirë për ju, nëse me të vërtetë e kuptoni diçka të tillë”.** (Xhuma, 9)

Zoti i gjithësisë dalloj njeriun nga të gjitha krijesat e Tij, dalloj peygamberët e Tij prej njerëzve të tjerë dhe prej peygamberëve dalloj Muhamedin (a.s). Dalloi tokën nga të gjithë planetet, dalloj vendet e shenjta nga të gjitha vendet e tokës, dalloj Qaben e ndritshme nga të gjithë vendet e shenjta, dalloj Ramazanin nga 11 muajt e tjerë, dalloj natën e Kadrit brenda Ramazanit dhe dalloj ditën e xhuma nga ditët e kësaj jete.

Do flasim dy – tre fjalë për vlerën e ditës së xhuma, vlerën e së cilës nuk e di pjesa më e madhe e njerëzve. Do flas për vlerën e kësaj dite, që është e madhe tek Allahu (xh.sh), është e madhe tek melekët e Zotit, është e madhe në zemrën e profetit (a.s).

Profeti (a.s) ka thënë: *“Dita më e mirë, në të cilën lind dielli, është dita e xhuma. Në atë ditë u krijua Ademi (a.s), në atë ditë hyri në xhenet, ditën e xhuma doli nga xheneti, në atë ditë vdiq, në atë ditë do të bëhet edhe Kijameti. Kur të vijë dita e xhuma, shtoni salavatet mbi mua”.*¹

Dita e xhuma është dita, që Allahu (xh.sh) ua dha myslimanëve. Çifutëve u dha ditën e shtunë, ndërsa të krishterëve të dielën. Profeti (a.s) ka thënë: *“Neve na drejtoi Allahu tek dita e xhuma. Kemi ardhur të fundit në këtë botë, por do të jemi të parët në botën tjetër”*, sepse muslimanët do të merren të parët në llogari.²

Dita e xhuma është ditë e madhe për melekët e Zotit. Profeti (a.s) ka thënë: *“Kur vjen dita e xhuma,*

*melekët vijnë në dyert e xhamive dhe regjistrojnë besimtarët në regjistrat e tyre njërin pas tjetrit. Kush hyn i pari në xhami ditën e xhuma, regjistrohet me emrin e tij dhe i shkruhet për sevap, sikur ka bërë kurban një deve. Kush vjen pak më vonë, shkruhet emri i tij sikur të ketë bërë kurban një lopë. Kush vjen pas tij, llogaritet sikur ka bërë kurban një dash. Atij që vjen më pas, i shkruhet sikur ka bërë kurban një pulë. Kush vjen pas tij i shkruhet sikur ka dhënë sadaka një vezë. Pastaj në momentet që hatibi ngjit shkallët e minberit, ata i mbyllin regjistrat e tyre, ulen dhe dëgjojnë hutben bashkë me besimtarët e tjerë, që janë në xhami”.*³

Dita e xhuma është dita më e bukur në Ditën e Kijametit, pasi Muhamedi (a.s) ka thënë: *“Ditën e Kijametit do të vijnë ditët e javës me pamje. Më e bukura ndër to është dita e xhuma. Do të jetë e bukur dhe e ndritshme, si nusja kur shkon te dhëndrri i saj. Pas saj shkojnë ata, që kanë falur xhumatë. Ata ecin pas dritës së ditës së xhuma. Fytyrat e këtyre njerëzve janë më të bardha se bora dhe nga trupi i tyre del aromë parfumi misk. Të gjithë çuditen nga bukuria e këtyre njerëzve, të cilët hyjnë së bashku në xhenet dhe atyre ua kalojnë vetëm muezinët, që kanë qenë të rregullt në ezanet e tyre”.*⁴

Ajo që vlen të theksohet është, se edhe në xhenet dita më e mirë është dita e xhuma. Allahu (xh.sh) thotë: **“Aty do të kenë çfarë të duan, ndërsa tek Ne ka edhe më shumë”.** (Kaf, 35) E pyetën profetin (a.s): “O profet i Zotit, çfarë është ajo, që është më tepër”? Profeti (a.s) tha: *“Është dita e xhuma, sepse në atë ditë del Madhështia dhe Bukuria e Allahut (xh.sh) dhe banorët e xhenetit shohin Zotin”.*⁵

Prandaj ju këshilloj që të kemi kujdes, kur falim xhumanë e ndoshta kurrë nuk ia kemi ditur vlerën

kësaj dite. Ndërsa ata që humbin xhumatë, ta dinë se po humbin thesarin më të madh të kësaj bote dhe të botës tjetër. Prandaj Allahu (xh.sh) e bëri detyrë faljen e xhumasë për të gjithë ata që kanë mundësi. Profeti (a.s) paralajmëroi dhe tha: *“Ata që lenë namazin e xhumasë, Allahu do t’ua vulosë zemrat”*.⁶ Ata që i kanë zemrat e vulosura, ata bëhen të shkujdesur dhe xhehenemi është i mbushur plot me njerëz të shkujdesur. Profeti (a.s) tha gjithashtu: *“Kush nuk i fal tre xhuma rresht pa arsye, Zoti ia vulos zemrën atij personi”*.⁷

Mes nesh ka besimtarë, që po t’i numërosh xhumatë e tyre ndoshta janë me mijëra. Ka të tjerë që i kanë me qindra, e të tjerë i kanë me dhjetëra. Kjo është sipas kohës që e kemi njohur këtë fe dhe e kemi praktikuar atë. Por jam i sigurt, se shumica prej nesh nuk e kanë vlerësuar siç duhet ditën e xhuma. Kjo ditë meriton respekt dhe edukatë të veçantë ndryshe nga të gjithë ditët e tjera. Le të njihet muslimani ditën e xhuma. Muhamedi (a.s) na mësoi si të sillemi ndaj kësaj dite. Ai ka thënë: *“Kush lahet ditën e xhuma, vesh rrobat më të mira që ka në shtëpi, parfumuset, vjen në xhami me qetësi, futet brenda dhe nuk i prish rreshtat e besimtarëve, falet sa të ketë mundësi, ulet dhe dëgjon hatibin me vëmendje, betohet në Allah se Ai do t’ia falë gjynahet e javës së kaluar dhe tre ditë më tepër”*.⁸

Dijeni se nëse na pranohet një xhuma, fshihen gjynahet e dhjetë ditëve. Na bëftë Zoti nga ata njerëz që u fshihen gjynahet. Fjala më e mirë që thuhet në këtë ditë, nuk janë muhabetet “Si je ti e si jam unë”, por është salavati mbi më të mirin e njerëzve, salavati mbi profetin (a.s). Kush e shton salavatit mbi të, e meriton ndërmjetësimin e profetit (a.s).

Gjëja më e mirë që mund të këndojnë gjuhët tona është Kurani fisnik. Nëse nuk di arabisht lexoje

shqip. Leximi i sures **“Kehf”** është specifik për ditën e xhuma. Profeti (a.s) ka thënë: *“Kush lexon suren Kehf ditën e xhuma, ajo do t’i bëhet dritë deri në xhumanë tjetër”*.⁹ Gjithashtu profeti (a.s) ka thënë: *“Në ditën e xhuma është një orë. Kush lutet në atë orë, Allahu ia pranon lutjen”*.¹⁰ Kur foli për këtë gjë, i afroi gishtat me njëri-tjetrin për të treguar se ajo kohë është shumë e shkurtër, koha kur pranohet lutja. Dijetarët thonë në lidhje me këtë kohë: *“Ajo kohë mund të jetë nga koha kur thirret ezani i xhumasë deri në kohën kur flet hatibi, ose koha që nga namazi i ikindisë deri në namazin e akshamit”*. Prandaj mos harroni të bëni dua' (lutje) në këto kohë.

Në këtë ditë shtohet sadakaja. Vlera e sadakasë që jepet për xhuma, ndaj sadakasë që jepet në ditët e tjera, është si sadakaja që japim në Ramazan, krahasuar me sadakanë që jepet në muajt e tjerë.

Kjo është dita më e bukur, me të cilën mund të jetohet jeta, por mund të jetë edhe dita më e bukur, me të cilën mund të mbyllet jeta, pasi Muhamedi (a.s) ka thënë: *“Kush vdes ditën e xhuma, ose natën e xhuma, Allahu do ta ruajë nga sprovat e varrit”*.¹¹

E lus Zotin e gjithësisë ta bëjë ditën e xhuma, ditën më të bukur të jetës tonë dhe ditën më të bukur me të cilën mbyllem jetën tonë.

O Allah pranoji xhumatë tona, hapat tanë, lodhjet dhe sakrificat tona. Pranoje prej atyre që nuk kanë punë dhe vijnë më herët dhe pranoje prej atyre që me gjithë hallet dhe problemet që kanë, nuk e lenë xhumanë pa e falur. O Zot jepi të gjithë njerëzve nga mirësitë e tua.

O Zot bëji këto xhuma, këto namaze, këtë Kuran, këto salavate dhe çdo adhurim tjetër dëshmitar për ne në këtë botë dhe në botën tjetër.

Amin!..

**“Neve
na drejtoi Allahu
tek dita e xhuma.
Kemi ardhur të fundit
në këtë botë, por do të
jemi të parët
në botën
tjetër.”**

■ **REFERENCAT:** **1) Hadith i vërtetë.** Ebu Daudi (1047), Nesaiu (3/91,92), Ibn Maxheh (1636) dhe Ibn Hibani (910). Shejh Albani dhe tre verifikuesit e vlerësojnë hadithin të vërtetë, ndërsa shejh Shuajbi e vlerëson hadithin të vërtetë për shkak të dëshmiave përforcuese. **2) Hadith i vërtetë.** Muslimi (856) dhe Ibn Maxheh (1083). Teksti në fjalë është i Ibn Maxhes. **3) Hadith i vërtetë.** Maliku (1/101), Buhariu (881) dhe Muslimi (850). **4) Hadith i pranuar.** Taberaniu në Kebir dhe Ibn Khuhezejme (1730). Hejthemiu në Mexhmauz'zeuaid (2/165) thotë: “E shënon Taberaniu në Kebir nëpërmjet Hejthem ibn Humejdi nga Hafs ibn Gejlani, të cilët janë vlerësuar të besueshëm nga disa dhe të dobët nga disa të tjerë, por lejohet argumentimi me ta”. Shejh Albani e vlerëson hadithin të pranuar. **5) Hadith i dobët.** Dejlami (7180) dhe Bezari (2258). Hejthemiu në Mexhmauz'zeuaid (7/112) thotë: “E shënon Bezari dhe në vargun e përcjellësve është Uthman ibn Umejri, i cili vlerësohet i dobët”. **6) Hadith i vërtetë.** Muslimi (865) dhe Ibn Maxheh (794). **7) Hadith i vërtetë për shkak të dëshmiave përforcuese.** Ibn Maxheh (1126). Shejh Albani dhe shejh Shuajbi e vlerësojnë hadithin të vërtetë për shkak të dëshmiave përforcuese. **8) Hadith i vërtetë.** Muslimi (857) dhe Ebu Daudi (1050). **9) Hadith i vërtetë.** Nesaiu në Amelul jeumi uel'lejl (952, 954) dhe Bejhakui në Shuab (2220). Shejh Albani e vlerëson hadithin të vërtetë. **10) Hadith i vërtetë për shkak të dëshmiave përforcuese.** Ahmed (3/430). Shejh Shuajbi e vlerëson hadithin të vërtetë për shkak të dëshmiave përforcuese. Hadithet për orën që pranohen lutjet janë më se të vërteta. Shiko hadithet tek Muslimi (853), Ebu Daudi (1049), Tirmidhiu (489) etj. **11) Hadith i pranuar.** Tirmidhiu (1074). Shejh Albani e vlerëson hadithin të pranuar, ndërsa shejh Shuajbi e vlerëson hadithin të dobët.



Veçoritë E GRAVE BESIMTARE

— Fatma Nur Xhihan —

Islami nuk bën dallim mes gruas dhe burrit kur bëhet fjala për çështjet e besimit dhe të moralit. Kushtet e besimit: “Besimi në Allah, melekë , librat e shenjtë, pejgamber , ditën e ahiretit, kazanë dhe kaderin”, janë të njëjta për të dyja gjinitë. Të gjithë ne e dimë që këto janë themelet e besimit dhe që nuk do të ndryshojnë asnjëherë. Njeriu që i beson të gjitha këto, quhet besimtar.

Duke marrë parasysh këtë gjë mund të themi që një grua besimtare , në fillim duhet të plotësojë kushtet e besimit; të cilat janë të njëjta për të gjithë njerëzimin. Kushti i tyre është pranimi me zemër dhe thënia me fjalë. Të gjitha dyshimet që mund të ekzistojnë në lidhje me këto kushte duhet të zhduken sa më shpejt. Një grua besimtare duhet të jetë ndjekëse e synetit të Resulullahut.

Të jesh ndjekëse e synetit do të thotë të jesh besimtare në mënyrën më të pastër të mundshme; të jetosh jetën e Resulullahut dhe sahabëve të tij, të cilët mbështeteshin vetëm në Kuran. Rruga e një besimtareje duhet të kalojë me radhë në këto burime: Kurani, syneti, ixhmaja (mendimi i dijetarëve) dhe kijasi fukaha (analogjia). Mënyrat e tjera të besimit quhen: “Ehli Bidat”. Bidatet janë fjalët dhe veprimet që nuk janë në fe por janë nxjerr nga mendimet personale të njerëzve.

Në qoftë se do të kthehemi në krye; mund të themi që Kurani dhe Syneti i kanë vizatuar shumë qartë kufijtë e besimit prandaj është e domosdoshme ndjekja e këtyre rregullave.

Kushtet e besimit janë thelbi i fesë. Në qoftë se ka probleme në besim, adhurimet mund të jenë të pavlera. Një njeri që ka dyshime për ekzistencën e Allahut apo që nuk e beson Resulullahun si pejgamber, edhe nëse fal namaz ditë e natë dhe agjëron çdo ditë, nuk do të ketë shpërblim për këto adhurime. Detyra e parë e çdo myslimani është eliminimi i dyshimeve dhe besimi i fortë dhe i sigurt. Pas kalimit të kësaj shkalle do të vijë detyrat e tjera të Islamit.

ADHURIMET

Adhurimi është çdo punë (veprim) që bëhet për hir të Allahut. Adhurimet që nuk bëhen me këtë qëllim nuk pranohen. Edhe veprimet që bëhen për hir të Allahut por që në të vërtetë janë gjëra të ndaluara, nuk quhen adhurime. Le të flasim pak më gjerë për këtë temë.

Pejgamberi ynë i nderuar ka treguar për fatkeqësinë që do të pësojnë njerëzit që marrin pjesë në xhihad (luftë fetare), dhurojnë dhe bëjnë bamirësi, mësojnë vetë dhe u mësojnë edhe të tjerë.

ve; vetëm për t'u dukur para njerëzve. Gjithashtu nuk duhet të harrojmë që në shumë hadithe është theksuar sinjeriteti i adhurimeve, si një kusht i domosdoshëm.

Nga ana tjetër nuk mund të afroresh me Allahun duke bërë gjëra që Ai i ka ndaluar, edhe në qoftë se këto i bën për hir të Tij. për shembull, në qoftë se një njeri luan kumar, merr pjesë në llotari ose bën diçka të ngjashme (një veprim haram) për të bërë një xhami; pavarësisht nijetit të tij të mirë ai nuk fiton sevape. Ai veprim mund t'i shkruhet si gjynah duke qenë se ka bërë gjëra të ndaluara nga feja jonë.

Nga të gjitha këto që thamë më sipër, kuptojmë që adhurimi është veprimi që bëhet për hir të Allahut dhe që realizohet duke përdorur rrugët e lejuara nga feja jonë.

Adhurimet janë të shumëllojshme. Çdo njeri mund t'i afrohet Allahut dhe mund të fitojë dashurinë e Tij, sipas mënyrës dhe karakterit të vet. Pejgamberi ynë i nderuar i ka theksuar gjithmonë pesë bazat e Islamit: *"Shehadeti (fjala e dëshmisë), falja e namazit pesë herë në ditë, agjërimi i Ramazanit, dhënia e zekatit dhe vajtja në Haxh për atë që ka mundësi."* (Buhari, Iman, 1,2; Myslim, Iman, 19-22). Këto adhurime bazë është e mirë të pasurohen me namazet dhe agjërimet nafile, sadaka, mirësi të ndryshme dhe me vizita shtesë të haxhit dhe umresë.

Adhurime të tjera të rëndësishme janë: bindja ndaj prindërve dhe respektimi i tyre, mbajtja e lidhjeve familjare, dhikri (përkujtimi i Allahut), leximi i Kuranit Kerim dhe dërgimi i salavatëve, përpjekja për ta mësuar sa më mirë Islamin, këshillimi për mirë dhe ndalimi i së keqes, marrja pjesë në aktivitete që kanë për qëllim thirrjen në Islam, lënia pas e atyre që quhen: sadaka xharije (sadakaja sevapet e së cilës vazhdojnë edhe pas vdekjes), edukimi i brezave të mirë dhe të drejtë, fitimi i zemrave të njerëzve me fjalë të mira dhe me buzëqeshje, dhënia ndihmë të gjithë gjallesave që kanë nevojë, dhe largimi nga çdo veprim apo sjellje e ndaluar.

Pejgamberi ynë i dashur na ka dhënë lajmin e faljes së një gruaje mëkatore vetëm sepse ka nxjerrë ujë nga pusi për t'i shuar etjen një qeni të mjerë; në të njëjtën kohë ai na ka dhënë lajmin e hedhjes në xhehenem të një gruaje besimtare vetëm sepse po torturonte një mace që mbante në shtëpi. Nuk ka një mënyrë të sigurt për të matur të mirën dhe të keqen. Nganjëherë një veprim i mirë, në dukje i vogël dhe i parëndësishëm; mund të bëhet shkak që njeriu të fitoj xhenetin. E njëjta gjë



ndodh edhe me një gjynah, në dukje të vogël por që mund të bëhet shkak që njeriu të ketë vuajtje të përjetshme.

Dijetarët tanë kanë thënë: "Nuk ka gjynah të madh pas pendimit dhe as gjynah të vogël as përsëritjes." Një njeri mund të ketë kryer një gjynah të madh, por në momentin që ai pendohet sinjerisht, gjynahi i falet. Nga ana tjetër; një gjynah i vogël i cili përsëritet disa herë nuk mund të jetë më aq i vogël. Duhet të kemi kujdes me gjynahet e vogla dhe në veçanti me personin ndaj të cilit bëhet ky gjynah.

Një pikë tjetër e rëndësishme e adhurimeve është: sinjeriteti dhe vazhdimësia e tyre; të dyja këto vijnë para numrit apo sasisë së adhurimeve.

Pejgamberi ynë i nderuar ka thënë: *"vepra më e virtutshme dhe që pranohet më shumë nga Allahu është vepra që edhe pse është e vogël në sasi, është e vazhdueshme."* (Buhari, Rikak, 18)

Në një hadith tjetër thuhet: *"Feja është lehtësim. Njeriu që nuk mjaftohet me ligjet e fesë dhe me ndalesat e saj, do të lodhet shpejt. Prandaj, bëni përpjekje për të ndjekur rrugën e mesme dhe mundohuni që të jepni më të mirën tuaj. Ju jap lajmin e mirë që është e pëlqyeshme të përfitonit nga fillimi dhe fundi i ditës, edhe nga një pjesë e natës."* (Buhari, Iman, 29; Nesai, Iman, 28)

"Mos nxitoni, mos u ngutni; në mënyrë që të arrini qëllimin tuaj." (Buhari, Rikak, 18)

"Veprat të cilat nuk janë farz bëni aq sa keni mundësi sepse më e mira e veprave është ajo që bëhet vazhdimisht edhe pse në sasi të vogël." (Ibni Maxhe, Zyhd, 28)

“Mjafton që të kryeni adhurimet aq sa keni mundësi. Betohe në Allah që për sa kohë që ju nuk mërzhiteni dhe nuk i braktisni adhurimet tuaja, as Allahu nuk do t’ju braktis juve.” (Buhari, Iman, 32)

Këto hadithe na tregojnë qartë rrugën që duhet ndjekur. Resulullahu ka dhënë si shembull njerëzit që kanë kërkuar leje për të agjëruar çdo ditë, për të kryer adhurime që nga mbrëmja deri në mëngjes dhe për të braktisur çdo punë të kësaj bote në mënyrë që të jenë të lirë për të kryer adhurimet e tyre. Kësaj kërkesë Resulullahu i është përgjigjur në këtë mënyrë:

“Betohe në Allah që unë e kam frikë Allahun më shumë se të gjithë ju dhe unë jam ai që kam më shumë respekt për Të. Por edhe unë, disa ditë agjëroj e ditë të tjera nuk agjëroj. Natën edhe falem edhe fle. Martohem me gra. Ai që i kthen shpinën synetit tim nuk është prej ymetit tim.” (Buhari, Nikah, 1 ; Muslim, Nikah, 5; Nesai, Nikah, 4)

Besimtari dhe besimtarja duhet të jenë të matur në fenë e tyre, duhet të ruajnë ekuilibrin. Qëndrueshmëria duhet të jetë prezent edhe në mendime dhe në të gjitha sjelljet tona, jo vetëm në adhurime. Pejgamberi ynë i nderuar ka thënë:

“Dua je mikun me masë sepse një ditë ai mund të bëhet armiku yt. Edhe armikun urreje me masë sepse një ditë ai mund të bëhet miku yt.” (Tirmidhiu, Birr, 60).

MORALI I BUKUR

Një nga gjërat më kryesore që i ka sjell Islami shoqërisë njerëzore është morali i bukur. Pejgamberi ynë i nderuar na ka thënë: *“jam dërguar për të plotësuar moralin e lartë”* (Muvatta, Hysnyl Hulk, 8, Bejhaki, es- Synenyl-Kybra, X, 192). Myslimanët duhet të bëjnë përpjekje për të ndjekur shembullin e Pejgamberit dhe të sahabëve. Ja se çfarë na ka thënë Pejgamberi ynë i nderuar në lidhje me moralin e lartë: *“Një njeri që ka moral të lartë arrin gradën e atij që i kalon të gjitha ditët e veta me agjërim dhe që ngihet natën për të fal namaz.”* (Ebu Davud, Edeb, 7)

Le të shohim se si i ka radhitur ajeti Kuranor cilësitë që duhet të kenë besimtarët dhe besimtarët:

“Me të vërtetë që për myslimanët dhe myslimanet, besimtarët dhe besimtarët, të bindurit ndaj Allahut dhe të bindurat ndaj Allahut, të drejtët (të singertët) dhe të drejtat (të singertat), duruesit dhe durueset, të përlulurit dhe të përlulurat, mirëbërësit dhe mirëbërëset, agjëruesit dhe agjërueset, ruajtësit e nderit dhe ruajtëset e nderit, përkujtuesit e Allahut vazhdimisht dhe përkujtueset, pra, për të gjithë këta Allahu ka përgatitur falje dhe shpërblim të madh.” (El- Ahzab, 35)

“Turpi është nga imani.” (Buhari, Iman, 3; Myslim, Iman, 58) Ky hadith na tregon qartë që morali i lartë është burim i besimit dhe që mes atyre të dyjave ekziston një lidhje e pandarë. Në qoftë se një njeri nuk ka mëshirë në zemër, është e pamundur që të tregohet i mirë me kafshët dhe me njerëzit që e rrethojnë. Besimi është fillimi i një morali të lartë, kurse mungesa e besimit sjell me vete mosmirënjohje dhe plot ndjenja të tjera negative.

Në qoftë se një njeri që pretendon të jetë besimtar nuk është i besueshëm në mesin e njerëzve, ai duhet ta shqyrtojë mirë këtë çështje sepse: *“Mysliman është ai nga dora dhe gjuha e të cilit janë të mbrojtur vëllezërit e vet.”* (Buhari, Iman, 4-5) *“Besimtari do për vëllanë mysliman atë që do për vete.”* (Buhari, Iman, 7; Myslim, Iman, 71-72) Besimi i tij nuk është diçka e thatë

dhe pa shpirt. Çdo sjellje dhe fjalë e tij e shpalos besimin që ka.

Duhet të bëjmë shumë kujdes që mos t'i bëjmë të padrejtë njerëzve të tjerë sepse në ahiret vetëm sevapet tona do të na ndihmojnë. Në qoftë se do të shkojmë në ahiret duke mbajtur në shpinë hakun e njerëzve të tjerëve, do të duhet që të japim nga sevapet tona për të larë borxhet me to. Në qoftë se sevapet na mbarojnë, atëherë Zoti na ruajt por do të jemi të humbur.

Myslimani shqetësohet kur vëllai i tij është i shqetësuar dhe lumturohet kur ai është i lumtur. Myslimanët duhet të jenë si organet e një trupi të cilat bashkëpunojnë dhe që e ndihmojnë gjithmonë njëri-tjetrin.

Pejgamberi ynë i nderuar na ka treguar që të keqen duhet ta përbuzim në fillim me vepra pastaj me gojë, në fund, në qoftë se nuk kemi mundësi tjetër duhet ta përbuzim me zemër por kjo është shkalla më e ultë e besimit. Në lidhje me këtë temë një hadith na ka thënë:

“Në qoftë se një burrë vritet në perëndim dhe një burrë në lindje është dakord me këtë gjë, ai bëhet ortak në këtë vrasje.” (Iraki, Muni, IV, 241)

Myslimani është i pari për të bërë mirë dhe është ai që frenohet më shumë para të këqijave. Besimtari mysliman mundohet që t'i afrojë njerëzit me të mirën dhe t'i largoj prej të keqes. Pejgamberi ynë i dashur ka thënë:

“Ka njerëz që janë çelës për të mirën dhe bravë e mbyllur për të keqen. Ka njerëz që janë çelës për të keqen dhe bravë e mbyllur për të mirën. Sa të lutur janë ato njerëz të cilëve Allahu u ka dhënë çelësin e veprave të mira! Sa keq për njerëzit që Allahu u ka dhënë bravat e mbyllura të së keqes!” (Ibni Maxhe, Mukaddime, 19)

Të gjitha këto që thamë, tregojnë që besimtarët janë njerëz të zgjedhur; njerëz që zotërojnë moral të lartë. Ja se çfarë lajmi u ka dhënë Allahu, njerëzve që jetojnë nën dritën e Islamit:

“Dhe Zoti iu përgjigj lutjes së tyre: “Unë nuk do t'ia humb mundin askujt nga ju që ka bërë vepra, qoftë mashkull apo femër. Ju jeni një-lloj (në shpërblim). Atyre që u shpërngulën, u dëbuan nga vatrat e tyre, u munduan në rrugën Time, luftuan dhe u vranë, Unë do t'ua mbuloj veprat e këqija dhe do t'i shpie në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, si shpërblim nga Allahu. Shpërblimi më i mirë është tek Allahu.” (Ali- Imran, 195)

“Allahu u ka premtuar besimtarëve dhe besimtareve kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përgjithmonë, si dhe pallate të mrekullueshme në Xhenetin e Adnit. Por kënaqësia prej Allahut është shpërblimi më i madh. Kjo është fitorja madhështore.” (Et- Teube, 72)

Për sa i përket kënaqësisë prej Allahut dhe fitores së premtuar në Kuran, Pejgamberi ynë i nderuar ka bërë këtë shpjegim:

“Allahu Teala i pyet banorët e xhenetit:

“- A jeni të kënaqur?”. Ato i përgjigjen:

“- Si mund të mos jemi të kënaqur! Na ke dhënë neve gjëra që nuk i ke dhënë askujt tjetër prej krijesave të Tua”. Pas këtyre fjalëve Allahu Teala thotë:

“- Do t'ju jap juve diçka më të lartë se këto.” Ato pyesin:

“- Çfarë është më e lartë se këto?”. Allahu përgjigjet:

“- Do t'ju jap juve kënaqësinë dhe pëlqimin Tim dhe nuk do të zemërohem më me ju.” (Buhari, Rikak, 51; Myslim, Xhennet, 9; Tirmidhiu, Xhennet, 18; Ahmed bin Hanbel, Mysned, III, 88)

Allahu na bëftë prej njerëzve që do të fitojnë kënaqësinë e Tij. Amin.

VEZËT E ZIERA

Vlerat dhe çfarë i ndodh organizmit

Veza është padyshim përbërësi kryesor i një mëngjes të shëndetshëm.

Një nga mënyrat më të zakonshme të konsumimit të vezës është sigurisht përgatitja e saj në formën e zier.

Por cilat janë vlerat e vezës së zier dhe çfarë i ndodh organizmit kur ajo konsumohet e zier.

Veza përmban 210 miligramë kolesterol. Zierja konsiderohet mënyra më e sigurt për gatim sepse yndyrnat që përdorni në skuqje rrisin kolesterolin në organizëm.

Ekspertët thonë se vezët janë të mira për shëndetin dhe një i rritur mund të hajë një vezë në ditë pa u shqetësuar shumë për kolesterolin.

Ngrënia e vezës në mëngjes si pjesë e një regjimi të kujdesshëm shëndetësor mund t'ju ndihmojë të humbisni në peshë.

YNDYRNAT E MIRA

Vezët e ziera nxisin krijimin e yndyrnave të mira të cilat ndihmojnë në ruajtjen e nivelit të kolesterolit në gjak ndërsa ulin rrezikun e problemeve dhe sëmundjeve në zemër.

Këto yndyrna të shëndetshme për shëndetin e zemrës ndikojnë gjithashtu në rregullimin e nivelit të insulinës në gjak, e për rrjedhojë nivelin e sheqerit në gjak.

PROTEINAT

Vezët e ziera natyrisht përmbajnë një nivel të lartë proteinash.

Organizmi ka nevojë për proteina për forcimin e muskujve. Por mbi të gjitha proteinat ndihmojnë gjithë organet e trupit dhe mundësojnë një strukturë të posaçme mbrojtëse në muret e qelizave.

SHËNDETI I SYVE

Një nga vitaminat më të rëndësishme tek veza është vitamina A.

Kjo vitaminë është thelbësore në ndihmën që i ofron retinës së syve për thithjen e dritës, mbron membranat dhe ul riskun e prekjes nga dobësimi i shikimit apo verbëria.

KOCKA TË FORTA

Vezët e ziera janë të pasura me vitaminën D, vitaminë e cila është e rëndësishme për kocka dhe dhëmbë të fortë gjithashtu.

Vitamina D u mundëson kockave përthithjen e kalçiumit dhe rregullon nivelin e kalçiumit në gjak.

Ky proces garanton që skeleti i trupit të marrë sasinë e duhur të kalçiumit për të qenë i fortë.

KËSHILLA PËR VEZËT E ZIERA

Vezën e zier mund ta kombinonin në sallatat me spinaq, patate, pulë apo peshk si një element i domosdoshëm i ushqyerjes së shëndetshme.



Vaji i Rigonit

VLERAT DHE PËRFITIMET E ARMIKUT TË INFEKSIONEVE

Vaji esencial i rigonit është i larmishëm në vlera shëndetsore.

Ai është efikas kundër virozave, baktereve, mykut dhe parazitëve.

Vaji është i pasur me antioksidantë dhe lufton inflamacionin, përmirëson tretjen dhe zbut alergjitë.

Ky vaj shërben si disinfektant. Vlerat e tij u zbuluan për herë të parë në Greqinë e lashtë, banorët e të cilës e përdornin për të trajtuar infeksionet e plagëve ose lëkurës në përgjithësi apo edhe mbrojtur ushqimet nga bakteret.

Rigoni është një bimë që rritet nëpër shpatet e larta dhe emri i saj njihet ndryshe si Kënaqësia e Malit.

Vaji i rigonit përdoret në tre mënyra: në terapitë aromatike, në aplikimet në lëkurë ose nëpërmjet një vaji tjetër bartësi siç është vaji i arrës së kokosit dhe së fundmi si një suplement ushqimor duke e tretur në mjaltë ose një pije tjetër jo me bazë qumështi.

VLERAT DHE PËRFITIMET

Vaji esencial i rigonit ndihmon në eliminimin e mukusit të padëshiruar në rrugët e frymëmarrjes dhe sinozitit.

Ai është një balsam qetësues për mushkëritë dhe fytyrën dhe stimulon kollën pastruese.

Si rrjedhojë, ky vaj parandalon dhe trajton simptomat e problemeve në rrugët e frymëmarrjes.

LUFTON INFLAMACIONIN

Ky vaj bën mirë dhe ndihmon në trajtimin e inflamacionit të brendshëm dhe të jashtëm që shkaktohet për arsye të ndryshme.

Nëse e aplikoni në lëkurë, ky vaj pakëson skuqjet dhe irritimet, si dhe largon dhimbjet që shoqërojnë artritin ose të shkaktuara nga lëndime të ndryshme.

KUNDËR BAKTEREVE

Ky vaj ju mbron kundër virozave por edhe baktereve.

Ai ju pajis me një mburojë të mirëfilltë kundër disa baktereve që shkaktojnë sëmundje si infeksionet në zorrën e trashë dhe në traktin urinar, por edhe tiroidet, kolera, infeksionet në lëkurë dhe helmimi nga ushqimi.

KUNDËR MYKUT

Viruset, bakteret, myku janë përgjegjës për sëmundjet infektive dhe të transmetueshme.

Myku është përgjegjës për disa sëmundje fatale që shkatërrojnë organizmin nga jashtë dhe brenda.

KUNDËR VIROZAVE

Vaji esencial i rigonit ofron mbrojtje kundër virozave, duke forcuar sistemin imunitar dhe kundërpërgjigjet e tij ndaj të ftohtit, shytave, fruthit dhe lisë.

KUNDËR ALERGJIVE

Ky është një aspekt tjetër i dobishëm i vajit esencial të rigonit.

Alergjitë janë një reagim i ndezur i organizmit ndaj stimuljeve të jashtëm.

Ky vaj që ka rol qetësues, zbut ndjeshmërinë e lartë dhe pakëson simptomat alergjike.



DIFERENCA E MADHE MES 4G DHE 5G, RRJETIT TË SË ARDHMES!

Zhvillimi i aplikacioneve si Uber dhe Lyft, u mundësua nga 4G. Me 5G, makinat mund që një ditë të ecin vetë, pa shofer.

Makinat që ecin vetë janë vetëm një nga shumë se çfarë mund të ofrojë 5G, rrjeti që është duke u rrotulluar në mënyrë të qëndrueshme në të gjithë Shtetet e Bashkuara, dhe në vendet e tjera të botës.

Kompanitë po garojnë të kenë rrjetet më të shpejta ose më të mëdha 5G. Dhe vendet po konkurrojnë të jenë të parat që të vendosin plotësisht në mënyrë funksionale, në shkallë vendi 5G, për shkak të shumë risive revolucionare që ekspertët parashikojnë se do të ndërtohen falë saj.

Por klientët do të duhet të presin një kohë më të gjatë për të parë ndonjë nga përfitimet kryesore që 5G mund të sjellë një ditë.

Kjo për shkak se shumëçka hyn në rrjet për të mundësuar teknologji të reja, përfshirë qytete të zgjuara, operacione të largëta dhe fabrika të automatizuara.

Tri ndryshimet kryesore midis 4G dhe 5G janë shpejtësia më e lartë, pasi 5G pritët të jetë 100 herë më e shpejtë se 4G, sasia e të dhënave të jetë më e lartë, koha e vonës në komunikimet ndërmjet pajisjeve dhe serverëve. Por, këto aftësi do të kërkojnë ndërtimin e shumë infrastrukturave të reja dhe miliarda dollarë në investime vjetore.

GOOGLE EARTH MBULON AFRO 98% TË HAPËSIRËS TOKËSORE

Duket se Google, tani i sheh gati të gjitha zonat e planetit tonë.

Në postimin e bërë në një blog, Google Earth ka bërë të ditur se mbulon 98 për qind të hapësirës tokësore, derisa ka të regjistruara rreth 17 milionë kilometra rrugë në Street View.

Sikur të vendosen këto në perspektivë, me këto regjistrime rrugësh mund të mbështillet bota për 400 herë, ndërsa përdoruesve iu mundësohet të hulumtojnë në mbi 57 milionë kilometra katrorë të imazheve satelitore, që do të thotë vërtetë shumë.

“Derisa këto pamje, na tregojnë për pjesë të botës që vështirë mund t'i vizitojmë ndonjëherë, Google Earth ofron mundësin e regjistrimit të pamjeve të

ndryshme të kësaj bote, që gjithnjë po ndryshon”, thuhet në blog.

Megjithëse duke e thjeshtë, procesi i regjistrimit të këtyre pamjeve është mjaftë i vështirë dhe ato realizohen me makinat e Street View, por në disa terrene duhet të shfrytëzohen makinat që lëvizin me shirita si tanket.

Kur edhe këto makina janë të padobishme, kamerrat vendosen në biçikleta, në helmata ushtarësh, mbi dele, apo edhe deve.

Që të marrin sa më shumë pamje për Google Earth, hulumtuesit kanë punuar edhe në zona ku nuk ka harta, që e kanë bërë të pamundur që të regjistrohet e gjithë sipërfaqja e këtij planeti.

MICROSOFT ËSHTË DUKE PUNUAR NË MBI 100 DIZAJNE TË REJA IKONASH

Microsoft po vazhdon të modernizojë dizajnin e produkteve të tij. Tani janë njoftuar mbi 100 ikona të reja.

Microsoft planifikon të modernizojë gjerësisht produktet e tij softuerike. Jon Friedman, zëvendës-president i Microsoft, prezantoi modelet në një postim në blogun e tij.

Ai shkruan: “Ne duhet të sinjalizojmë inovacionin dhe ndryshimin dhe në të njëjtën kohë të mbetemi

të njohur për klientët tanë”.

Si ikonat e Office, dizajnet e reja kombinojnë thellësinë, llojet e ngjyrave dhe skajet e buta ndryshe nga dizajni i vjetër i Microsoft i aplikuar që prej Windows 8.

Por kompania nuk dha një datë specifike se kur këto logo dhe ikona të reja do të shfaqen tek aplikacionet dhe shërbimet e Windows.

YOUTUBE KIDS LANSOHET SË SHPEJTI SI NJË UEB-FAQE E NDARË

Mundësinë shfaqjes së materialeve vetëm për fëmijë, YouTube do ta sjellë së shpejti edhe si ueb-faqe, derisa për momentin në dispozicion është vetëm ai aplikacion për telefona.

Derisa më herët është bërë e ditur, se po punohet që të ketë një platformë të ndarë për fëmijë, dedikuar kërkimeve në kompjuter, mësohet se lansohet së shpejti, mbase brenda kësaj jave.

“Ne e dimë se çfarë iu pëlqen atyre që kanë nga katër vjet, e që nuk iu pëlqen atyre që i kanë dhjetë. Do të ndajmë videot, varësisht nga mosha që ka fëmija” thuhet në raportin e kompanisë.

Ndarja në bazë të moshës, mund të bëhet në dy forma, prej tetë e më të reja, apo tetë deri në 12-vjeç. Tani është më e lehtë për prindër, që të zgjedhin në YouTube Kids, pikërisht atë që do iu interesonte fëmijëve.

Në fillim, ndarja e një platforme të vetme për fëmijë, ishte që të mos ekspozohen ndaj materialeve të papërshtatshme dhe të ndjeshme, si dhe të mbrohen nga ngacmimet e pedofilëve.

Por, formati i ndarë, sjell shumë përparësi, sepse mund të ketë më shumë kontrollë mbi kualitetin dhe përmbajtjen e gjërave që shfaqen aty.

You Tube
KIDS





“Në të Dërguarin
e Allahut
ka një shembull
të mrekullueshëm për atë,
që shpreson tek Allahu
dhe Dita e Fundit
dhe e përmend
shumë Allahun.”

(Ahzab, 21)